

**MANUAL PËR MENAXHIMIN  
E PROBLEMEVE MJEDISORE  
NË NIVEL VENDOR**

# SHKURTIME

---

2000/60/EC -	Direktiva Kuadër e BE-së për Ujërat
91/271/EEC -	Direktiva e BE-së për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane
ACER -	Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike
ARM -	Agjencia Rajonale e Mjedisit
BE -	Bashkimi Evropian
EM -	Edukimi Mjedor
IHM -	Instituti i Hidrometeorologjisë
IM -	Instituti i Mjedisit
ISHP -	Instituti i Shëndetit Publik
ISO 14020 -	Standarti Eco - labeling
ISO 14040 -	Standarti për Vlerësimin e Ciklit të Jetës
KMZM -	Komiteti i Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura
KQM -	Komisioni Qytetar i Mjedisit
KRM -	Këshilli Rajonal të Mjedisit
KRRT -	Komisioni i Regullimit të Territorit
LAMMNG -	Ligji për Administrimin Mjedor të Mbeturave të Ngurta
LAMR -	Ligji për Administrimin e Mbetjeve të Rrezikshme
LMAN -	Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja
LMM -	Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit
LMMDND -	Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Detar nga Ndotja dhe Dëmtimet
LOFOV -	Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore
LPM -	Ligji për Largimin Publik të Mbeturave
LPSHP -	Ligji për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor
LSPK -	Ligji për Substancat dhe Preparatet Kimike
LTMUN -	Ligji për Trajtimin Mjedor të Ujërave të Ndotura
LVNM -	Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
MB -	Ministria e Brendshme
METE -	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës
MMPAU -	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
MPPTT -	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
NBO -	Kërkesë biologjike për oksigjen
NKO -	Kërkesë e lartë kimike për oksigjen
OJF -	Organizatë Jo-Fitimprurëse
OSBE -	Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin Evropian
OZHM -	Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit

PKAMNGU -	Plani Kombëtar i Administrimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane
PLVM -	Plan Lokal i Veprimit për Mjedisin
RKEAV -	Ratifikimi i Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore
RSH -	Republika e Shqipërisë
SHGJSH -	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
SKIJU -	Strategjia Kombëtare të Industrisë Jo-Ushqimore
SKTO -	Strategjia Kombëtare për Transportin e Qëndrueshëm
SKZHES -	Strategjia Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social
SMQV -	Strukturat Mjedisore të Qeverisjes Vendore
VKM -	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZVM -	Zona Veçanërisht të Mbrojtura
UNEP -	Programi Mjedisor i Kombeve të Bashkuara

# 1

## FALËNDERIME

---

Manuali “Menaxhimi i Problemeve Mjedisore në Nivel Vendor” u përgatit nga Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (QShKE), si pjesë e veprimtarisë së këtij institucioni për vitin 2006, në zbatim të projektit me të njëjtin emër, të financuar nga Departamenti i Mirëqeverisjes së Çështjeve Ekonomike dhe Mjedisore i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Materialet që përbëjnë manualin u hartuan, u rishikuan dhe u redaktuan nga specialistë me përvojë të gjatë në këtë fushë. Ekipi shkencor përbëhej nga M.Sc. Mirela Kamberi Koordinatore Projekti në kuadër të Programit të Ndryshimeve Klimatike, UNDP (Tiranë), Enis Tela, Jurist, Inspektor në Inspektoratin e Mjedisit të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, dhe MBA Agron Hetoja, Expert i Pavarur dhe bashkepunetor i QShKE si konsulent i ekipit shkencor për dizejnimin e përmbajtjes së manualit dhe mbikqyrjen dhe redaktimin e përgatitjes së tij.

Në hartimin e manualit janë marrë në konsideratë dhe sugjerimet dhe kontributi i ekspertëve të tjerë me të cilët është bashkëpunuar për realizimin e tij dhe përfitoj nga rasti t’i falënderoj, veçanërisht Znj. Ledia Muço, koordinatore e projektit dhe eksperte në fushën e Ekonomisë dhe Mjedisit pranë Prezencës së OSBE, për sugjerimet mjaft të vlefshme gjatë procesit të strukturimit dhe përgatitjes të manualit.

Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike siguroi mbështetjen teknike për grumbullimin e materialeve bazë dokumentare, raporteve kërkimore dhe punimeve të ndryshme rreth

përvojës së vendeve të tjera dhe mbikëqyri zbatimin e projektit në përputhje me qëllimin e tij.

Vlerësimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të QShKE-së dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Raporti është i pranishëm në faqen Web të OSBE-së:

[www.osce.org/publications/enviromentaltoolkit](http://www.osce.org/publications/enviromentaltoolkit)).

**Dr. Zef PREÇI, Drejtor Ekzekutiv i QShKE**

**Tiranë, shtator 2006**

# 1 PARATHËNIE

---

Manuali i menaxhimit të çështjeve mjedisore për specialistët/inspektorët e mjedisit në Organet e Qeverisjes Vendore është përgatitur nga Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike, me mbështetjen financiare të dhënë nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

Projekti është vazhdimësi e përpjekjeve të përbashkëta të Prezencës së OSBE në bashkëpunim me REC, zyra në Shqipëri, për të ngritur kapacitetet e punonjësve të pushtetit vendor për trajtimin e problemeve mjedisore në nivel lokal, nëpërmjet projektit: “Njohja e Legjislacionit Mjedisor - parakusht për zbatimin e tij”, i realizuar gjatë vitit 2004-2005”.

Zhvillimi urban, konsumi jo i qëndrueshëm, mungesa e stimulave ekonomikë për ruajtjen, zhvillimin dhe përdorimin e burimeve natyrore, ndotja historike e trashëguar, lëvizja e pakontrolluar e popullsisë, praktikat jo të efektshme të menaxhimit në fushën e shkarkimeve në mjedis dhe mungesa e një sistemi të fortë për kontrollin e tyre, janë disa nga faktorët kryesorë që kanë rënduar gjendjen e mjedisit duke përkeqësuar treguesit mjedisorë në vend.

Si kundërpërgjigje dhe reagim për mbrojtjen e elementëve përbërës të mjedisit, duke kuptuar edhe pasojat e rënda në mjedis nga zhvillimi ekonomik i centralizuar i para viteve 90’ të shekullit të kaluar, gjatë periudhës së tranzicionit në Shqipëri, vëmendja politike ndaj mjedisit dhe mbrojtjes së tij ka qenë e konsiderueshme. Në këto vite u tregua kujdes më shumë në krijimin dhe forcimin e strukturave për mbrojtjen e mjedisit në nivel qendror dhe vendor, në krijimin e një kuadri ligjor të ri, të përshtatshëm në hartimin e politikave të

qëndrueshme, aderimin në një varg marrëveshjesh dhe në bashkëpunimin në programe ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit.

Gjatë viteve të fundit janë zbatuar një sërë projektesh me financim të huaj dhe nga buxheti i shtetit për studime të ndryshme fizibiliteti, për hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit, hartimin e dokumenteve strategjike për menaxhimin e burimeve natyrore, të zonës bregdetare e të tjera. Megjithatë, mbështetja financiare nga buxheti i shtetit për sektorin e mjedisit është akoma e kufizuar.

Shkalla e ndërgjegjësimit mjedisor të publikut dhe të komunitetit të biznesit nuk është ende në nivelin e duhur. Roli i organizatave jofitimprurëse mjedisore, edhe pse është rritur në mënyrë të ndjeshme nga viti në vit, nuk ka ndikimin e duhur në jetën publike dhe politike të vendit.

Ngritja e strukturave vendore për mbrojtjen e mjedisit përbën një arritje të rëndësishme, veçanërisht po të merret parasysh që trashëgimia institucionale dhe ligjore në këtë fushë ishte shumë e pakët. Domosdoshmëria e trajnimit të këtyre strukturave shtrohet sot në plan të parë dhe këtij synimi i shërben edhe manuali i përgatitur.

Qëllimi kryesor i këtij manuali është: kuptimi më i mirë, nga ana e organeve të qeverisjes vendore, i mjedisit si një bankë në të cilën janë të depozituara sasi të kufizuara asetesh apo kapitali të burimeve natyrore të rinovueshme (ujëra, bota bimore dhe ajo shtazore) dhe të parinovueshme (naftë, gaz, burime minerale e të tjera). Përmes operacioneve të bankës, kapitali gjeneron interes.

Një shoqëri mjedisore e qëndrueshme duhet të mbrojë kapitalin natyror të rinovueshëm, të ulë interesin dhe ta përdorë me zgjuarski kapitalin e parinovueshëm të burimeve natyrore.

Është tashmë një koncept i pranuar që mjedisi kontribuon në përmirësimin e mirëqenies së shoqërisë dhe rritjen ekonomike përmes tre funksioneve baze të tij:

- Sigurimit të lëndëve të para për proceset e aktiviteteve ekonomike;

- Funksionimit të tij si vend-depozitimi për mbetjet e çdo lloji, të prodhuara nga aktiviteti ekonomik dhe njerëzor; dhe

- Siguron përdorim të drejtpërdrejtë të tij për shoqërinë njerëzore.

Lidhja e ngushtë midis mjedisit, si burim bazë dhe mirëqenie, është veçanërisht e vërtetë për vendet në zhvillim, të cilat, në kontrast me vendet e zhvilluara, varen kryesisht në burimet mjedisore të rinovueshme dhe në kapacitetin e vetë-rigjenerimit të mjedisit. Që këtu lind nevoja e zhvillimit të qëndrueshëm dhe e zgjidhjes së problemeve mjedisore.

Problemet mjedisore janë kryesisht të lidhura me ndikimin e aktivitetit njerëzor mbi burimet mjedisore. Këto marrin në përgjithësi formën e ndotjes, shterimit apo degradimit të ujërave, ajrit dhe tokës. Erozioni i tokës, kripëzimi dhe ndotja e ujërave, shkretëtirëzimi, shpyllëzimi dhe degradimi i bregdetit llogariten si dëmet dhe problemet më të mëdha mjedisore në vende si Shqipëria.

Mirëpo, meqenëse problemet mjedisore janë specifike dhe të veçanta, në varësi të vendndodhjes gjeografike, mënyra më e mirë për zgjidhjen e tyre është ndërtimi dhe zbatimi i strategjive/planeve të veprimit në mënyrë të decentralizuar. Më poshtë jepen arsyet pse decentralizimi i vendim-marrjes (delegimi i funksioneve nga qeverisja qendrore në atë vendore) është më efektiv për adresimin e problemeve mjedisore:

- Organet e qeverisjes vendore dhe institucionet lokale kanë një njohje më të mirë të problemeve mjedisore dhe socio-ekonomike të zonës së tyre dhe, për pasojë, janë edhe të interesuarit e drejtpërdrejtë për të mbrojtur mjedisin e tyre, nëse iu janë dhënë të drejta të qarta (dhe detyra) lidhur me burimet natyrore;

- Përgjegjësia më e lartë në vendim-marrje shoqërohet me motivim më të lartë për një përdorim më efikas të burimeve natyrore;

- Ka më shumë mundësi për të përfshirë në vendim-marrje grupe shoqërore më pak të favorizuara;



- Lehtëson pjesëmarrjen lokale, për shkak të homogjenitetit më të lartë të nevojave të përbashkëta për një numër më të kufizuar njerëzish;
- Rrit transparencën gjatë procesit të vendim-marrjes;
- Lejon ndërtimin e kapaciteteve lokale, për sigurimin e shërbimeve në pajtueshmëri me kërkesat lokale.

Termet e referencës së projektit kanë kërkuar pjesëmarrje të gjerë për hartimin e manualit, duke mbuluar në detaje të gjitha aspektet ligjore dhe teknike lidhur me menaxhimin praktik të problemeve mjedisore në shkallë vendore, në kushtet e Shqipërisë dhe duke shfrytëzuar praktikën më të mirë ndërkombëtare në këtë fushë.

Përderisa legjislacioni mjedisor po zhvillohet shumë shpejt, Manuali është projektuar që të jetë një dokument në zhvillim, i cili do të marrë parasysh ndryshimet e pritshme, për harmonizimin e shpejtë të tij me direktivat evropiane në fushën e mbrojtjes së mjedisit.

Manuali përbëhet nga 6 kapituj, të cilët duke filluar nga i pari trajtojnë:

- **Kapitulli i parë:** përmbledh çështjet më të spikatura të ligjeve, vendimeve dhe rregulloreve të mjedisit.
- **Kapitulli i dytë:** trajton reformën e decentralizimit dhe kuadrin ligjor përkatës.
- **Kapitulli i tretë:** analizon institucionet vendore për mbrojtjen e mjedisit dhe paraqet nevojën e edukimit mjedisor të organeve të qeverisjes vendore.
- **Kapitulli i katërt:** jep një rast studimor të decentralizimit mjedisor në Japoni dhe dy raste të zbatimit të Axhendës Lokale 21 në Mbretërinë e Bashkuar dhe Izrael.
- **Kapitulli i pestë:** trajton çështje të menaxhimit të problemeve mjedisore në nivel vendor duke përfshirë platformat e përmirësimit të cilësisë së ajrit, ujërave, çështje të menaxhimit të

mbetjeve dhe të ruajtjes së biodiversitetit në nivel qendror dhe vendor. Në varësi të problematikave mjedisore janë trajtuar raste studimore për zgjidhjen e situatave konkrete.

➤ **Kapitulli i gjashtë:** jep detaje lidhur me hartimin e planeve vendore të veprimit për mbrojtjen e mjedisit.

Ndërsa kapitujt kryesorë përbëjnë një dokument referimi, disa nga shtojcat sigurojnë informacion të dobishëm për aktivitetet e përditshme të strukturave përkatëse për mjedisin në organet e qeverisjes vendore. Këto përfshijnë:

➤ Ekstrakte nga ligjet e mjedisit me informacione specifike për inspektorët e mjedisit;

➤ Përgatitja e dosjes mjedisore nga personat fizikë dhe juridikë dhe Strukturat Mjedisore të Organeve të Qeverisjes Vendore për projektet e infrastrukturës vendore që do të zbatohen;

➤ Lista e veprimtarive vendore që pajisen me autorizim mjedisor;

➤ Lista e veprimtarive vendore që pajisen me pëlqimin mjedisor;

➤ Urdhër i Përbashkët për Miratimin e “Rregullores së Brendshme Tip” të Policisë Bashkiake e të Komunës;

➤ Një listë referuese materialesh të botuara në fushën e mjedisit;

➤ Përcaktime të termave kryesore mjedisore.

## **2** **DECENTRALIZIMI DHE** **MENAXHIMI MJEDISOR**

---

### **2.1. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E KUADRIT LIGJOR MJEDISOR**

Shqipëria ka legjislacionin e saj të ri mjedisor, të krijuar kryesisht gjatë dekadës së fundit. Ai bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe përfshin lloje të ndryshme të akteve normative, si ligje të përgjithshme e të veçanta për mjedisin e për përbërës të tij, vendime të Këshillit të Ministrave, urdhra e udhëzime të ministrive, rregullore specifike, norma e standarde etj. Ky legjislacion është përgjithësisht i përqasur me standardet e BE-së, sepse mbështetet në të njëjtat parime që është mbështetur legjislacioni mjedisor evropian, është hartuar me asistencën e ekspertëve të huaj, si dhe pasqyron përgjithësisht kërkesat e konventave, në të cilat Shqipëria është palë.

Megjithatë, legjislacioni mjedisor vazhdon të jetë në një proces intensiv plotësimesh e përmirësimesh, për t'iu përgjigjur me efektivitet nevojave për politika bashkëkohore të mbrojtjes mjedisore, zhvillimit të qëndrueshëm dhe procesit të drejt integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

### **2.2. PËRMBLEDHJE SPECIFIKE E LEGJISLACIONIT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT**

Kuadri Ligjor për Mjedisin është i bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe përbëhet nga ligjet dhe aktet normative, si vendimet e Këshillit të Ministrave, aktet ministeriale, rregulloret, udhëzimet dhe standardet.

Kushtetuta, e miratuar nga Parlamenti në 1998, kërkon nga institucionet përgjegjëse ruajtjen e një mjedisi të shëndetshëm, ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm.

Në dhjetëvjeçarin e fundit dhe në veçanti gjatë viteve 2001 e në vijim janë hartuar dhe miratuar një numër i konsiderueshëm ligjesh dhe aktesh të tjera nënligjore për mjedisin, të cilat kanë kontribuar në plotësimin e kuadrit ligjor dhe në mbështetjen më të plotë ligjore të masave parandaluese dhe rehabilituese për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimet. Kuadri ligjor i miratuar është në masën më të madhe të tij i harmonizuar edhe me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian.

Në kontekstin e këtij manuali janë cituar disa nga aktet ligjore më kryesore për mbrojtjen e mjedisit, me fokus qeverisjen vendore.

### **2.2.1. MBROJTJA E MJEDISIT - LMM**

**(LIGJI NR. 8934, DATË 05.09.2002)**

Ligji ka për qëllim të rregullojë marrëdhëniet ndërmjet njeriut dhe mjedisit, mbrojtjen e përbërësve të mjedisit dhe proceseve mjedisore, sigurimin e kushteve materiale për zhvillimin e qëndrueshëm, duke plotësuar kuadrin e nevojshëm për zbatimin e kërkesave kushtetuese për një mjedis ekologjikisht të pastër.

LMM është një ligj kuadër, ku ndër objektivat e tij do të veçonim:

- Përmirësimin e kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit publik.
- Përdorimin racional të resurseve natyrore dhe pakësimin e shkarkimeve ndotëse në mjedis, parandalimin e dëmtimeve ndaj tij dhe rehabilitimin e dëmeve në mjedis.

- Koordinimin e aktiviteteve ekonomike dhe sociale të vendit me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.
- Krijimin dhe forcimin e sistemit institucional për mbrojtjen e mjedisit në nivel qendror dhe vendor.

### **2.2.2. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis-LVNM (Ligji nr. 8990, datë. 23.01.2003)**

LVNM është një nga aktet ligjore më të rëndësishme për parandalimin e ndotjes apo dëmtimit të mjedisit nga aktivitetet humane. Ai synon të sigurojë:

- Vlerësimin e përgjithshëm, të integruar dhe në kohë, të ndikimeve mjedisore, të projekteve ose veprimtarive që kërkojnë të zbatohen, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative në mjedis;
- Një proces vlerësimi të hapur dhe të administruar me paanshmëri, nëpërmjet pjesëmarrjes së organeve qendrore e vendore, publikut, organizatave jofitimprurëse për mjedisin, propozuesit të projektit dhe personave fizikë dhe juridikë, të specializuar në këtë fushë.

Ky ligj përcakton rregullat, procedurat, afatet, të drejtat dhe detyrat:

- Për të identifikuar, saktësuar dhe vlerësuar ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të projektit ose veprimtarisë në mjedisin ku do të zbatohen;
- Për të krahasuar përparësitë dhe mangësitë e një projekti, të propozuar në variante të tjera, të mundshme, që përmbajnë ndryshime;
- Për vendin ku do të zbatohet projekti;
- Për përmasat dhe kapacitetet e tij;
- Për teknologjinë;

- Për krahasimet me gjendjen e mjedisit, nëse nuk do të zbatohet projekti;
- Për përcaktimin e masave për të parandaluar dhe zbutur dëmtimet në mjedis;
- Për të siguruar shqyrtim cilësor teknik, profesional, juridik dhe administrativ të kërkesës dhe të marrjes së vendimit nga organet përkatëse.

### **2.2.3. ADMINISTRIMI MJEDISOR I MBETURINAVE**

#### **TË NGURTA-LAMMN**

**(LIGJI NR. 9010, DATË 12.02.2003)**

Ky ligj synon mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta, nëpërmjet administrimit mjedisor të tyre në çdo fazë, përfshirë krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin, të cilat çojnë në pakësimin e mbetjeve dhe zvogëlimin e ndikimeve të tyre të rrezikshme e të dëmshme.

Objekt i këtij ligji janë:

- Mbetjet urbane;
- Mbetjet industriale;
- Mbetjet spitalore;
- Mbetjet e ndërtimit;
- Mbetjet në sistemin e kanalizimeve të ujërave të zeza, kanaleve kulluese e rezervuarëve;
- Mbetjet bujqësore dhe blegtorale;
- Mbetjet e vëllimshme.

Ky ligj nuk zbatohet për mbetjet e rrezikshme, radioaktive, bërthamore dhe eksplozive, administrimi i të cilave rregullohet me ligje të veçanta.

#### **2.2.4. LARGIMI PUBLIK I MBETURINAVE - LPM**

**(LIGJI NR. 8094, DATË 21.03.2000)**

Ky ligj synon mbrojtjen e mjedisit urban nga ndotja me mbeturina, si dhe largimin publik të tyre në brendësi të territoreve bashkiake e të komunave, sipas vijave kufizuese që janë në juridiksionin e çdo bashkie e komune. Ligji synon gjithashtu disiplinimin e shërbimeve publike për pastrimin e mbeturinave të qyteteve (dorëzimin, mbledhjen, fshirjen dhe grumbullimin) brenda perimetrit të territoreve të mësipërme.

Shërbimi i pastrimit të mbeturinave respekton këto parime të përgjithshme:

- Mënjanimin e çdo dëmi a rreziku për shëndetin, mirëqenien dhe sigurinë e jetës së personit;
- Garantimin e kërkesave higjeno-shëndetësore dhe çdo rrezik ndaj ndotjes së ajrit, ujit, tokës e nëntokës;
- Ruajtjen dhe mbrojtjen e faunës e të florës dhe minimizimin e degradimit të mjedisit e të pejsazhit.

Mbledhja e mbeturinave dhe largimi i tyre për në vend-grumbullim bëhet nga personat fizikë e juridikë, që janë të specializuar e licencuar në shërbimet e pastrimit të mbeturinave.

Metodat dhe teknologjitë që përdoren ose do të përdoren për largimin publik të mbeturinave, caktohen nga bashkitë dhe komunat, në bashkëpunim me organet kompetente, sipas rregullores për shërbimin e pastrimit publik.

#### **2.2.5. TRAJTIMI MJEDISORI I UJËRAVE TË**

**NDOTURA - LTMUN**

**(LIGJI NR. 9115, DATË 24.07.2003)**

Ligji ka për qëllim të mbrojë shëndetin e njeriut dhe mjedisin nga ndikimet negative të ujërave të ndotura, duke përcaktuar rregullat e

trajtimit mjedisor të tyre, si dhe detyrimet e shkarkuesve të ujërave të ndotura.

Objekt i zbatimit të këtij ligji janë:

- ujërat e ndotura urbane;
- ujërat e ndotura industriale, sipas degëve të veçanta të industrisë;
- ujërat nga kullimi i tokave bujqësore;
- ujërat e ndotura të çdo lloji.

#### **2.2.6. MBROJTA E AJRIT NGA NDOTJA – MAN**

**(LIGJI NR. 8897, DATË 16.05.2002)**

Ligji përcakton detyrimet e personave fizikë dhe juridikë për mbrojtjen e ajrit nga ndotësat e shkarkuar prej aktiviteteve që zhvillohen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Inspektorati i Mjedisit dhe Inspektorati i Mjedisit Urban ushtrojnë kontrolle dhe vendosin masa ndëshkimore në përputhje me të drejtat dhe detyrat e përcaktuara në legjislacionin që rregullon veprimtarinë e tyre.

➤ Rregullore nr.1, datë 15.03.2006, e MMPAU dhe MPPTT: “Për parandalimin e ndikimeve negative në shëndet e në mjedis të veprimtarive ndërtimore”. Personat fizike dhe juridike nuk mund të fillojnë të ushtrojnë veprimtari ndërtimore pa u pajisur me leje, autorizim ose pëlqim mjedisor.

➤ Normat për shkarkimet nga burimet e lëvizshme janë miratuar me Udhëzim të përbashkët të Ministrave të MPAU dhe PPTT, nr.6527, date 24.12.2004: “Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të mjedisit nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe mënyrat e kontrollit të tyre ”.



**2.2.7. SUBSTANCAT DHE PREPARATET KIMIKE –  
SPK (LIGJI NR. 9108, DATË 17.07.2003)**

Ligji ka për qëllim të rregullojë administrimin e substancave dhe të preparateve kimike për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve e të kafshëve, si dhe për mbrojtjen e mjedisit nga rreziqet që mund të shkaktojnë lëndët e rrezikshme.

Subjektet prodhuese dhe importuese janë të detyruara të regjistrojnë substancat që hedhin në treg edhe në rastet kur kjo substancë përmbahet në një substancë tjetër si shtesë, përzierje ose papastërti, ose përmbahet në preparat, si një nga përbërësit e tij.

Prodhuesi dhe importuesi, përpara hedhjes në treg të substancës apo preparatit që regjistrohet, paraqet në ministrinë e ngarkuara nga ky ligj, një aplikim me shkrim, i cili përmban informacion edhe mbi substancat/preparatet, sasitë, sigurimin teknik, etj.

Personat juridikë dhe fizikë, të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare, janë të detyruar që për menaxhimin e substancave dhe të preparateve të klasifikuara sipas pikave 6 dhe 7, të nenit 5 të këtij ligji, të njoftojnë ARM-në përkatëse të regjistrojë hyrjet e këtyre substancave dhe sasinë maksimale të ruajtur.

Gjithashtu ata duhet t'i dërgojnë kësaj agjencie, rregulloren e sigurimit teknik për këto substanca. Ky detyrim vlen edhe për substancat e përdorura për kërkime shkencore dhe për zhvillim.

**2.2.8. MBROJTJA E MJEDISIT DETAR NGA NDOTJA DHE  
DËMTIMET - MMDND (LIGJI NR. 8905, DATË 6.06.2002)**

Ligji ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit detar të Republikës së Shqipërisë nga ndotjet e dëmtimet, parandalimin dhe shmangien e tyre, të shkaktuara nga veprimtaritë njerëzore në det e në zonën bregdetare, të cilat prishin cilësinë e ujit, dëmtojnë burimet e detit e të bregdetit, rrezikojnë faunën dhe florën, kërcënojnë shëndetin e njeriut, si dhe vështirësojnë zhvillimin normal të veprimtarive në këtë mjedis.

**2.2.9. MBROJTJA E LIQENEVE NDËRKUFITARE –  
MLN (LIGJI NR. 9103, DATË 10.07.2003)**

Ky ligj synon mbrojtjen e gjendjes natyrore të liqeneve ndërkufitare, garantimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e jetës dhe të ekosistemeve në to, duke nxitur zhvillimin e veprimtarive të dobishme, në përputhje me kërkesat e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe duke ndaluar veprimtaritë që i rrezikojnë këto ekosisteme.

Në kapitullin që trajton mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare, në nenin 4 të tij, theksohet se për mbrojtjen e gjendjes natyrore të liqeneve ndërkufitare veprojnë të gjitha aktet ligjore e nënligjore që mbrojnë mjedisin në Republikën e Shqipërisë, si dhe konventat, protokollet dhe marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

**2.2.10. ADMINISTRIMI I MBETJEVE TË RREZIKSHME - AMR  
(LIGJI NR. 9537, DATË 18.05.2006)**

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë normat që rregullojnë administrimin e sigurt të mbetjeve të rrezikshme, grumbullimin, transportin, ruajtjen e përkohshme, përpunimin, trajtimin, asgjësimin, importimin dhe eksportimin e tyre.

Klasifikimi është bërë referuar nenit 3 të Ligjit nr.9010, datë 13.02.2003, “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” dhe VKM nr. 99, datë 18.02.2005, “Për miratimin e Katalogut Shqiptar të Mbetjeve”.

Parimet e administrimit të mbetjeve të rrezikshme:

➤ Administrimi i mbetjeve të rrezikshme realizohet pa rrezikuar shëndetin e njeriut apo mjedisin dhe pa përdorur procese, të cilat mund të dëmtojnë mjedisin, veçanërisht:

✓ nuk paraqesin rrezik për ajrin, ujin, tokën, bimët dhe kafshët;

- ✓ nuk shkaktojnë bezdi, me anë të zhurmës apo aromave;
- ✓ nuk ndikojnë negativisht mbi zonën rurale, urbane apo vende të tjera me interes të veçantë.
- Mbetjet e rrezikshme nuk lejohen të përzihen me mbetje të tjera, përveçse kur përzierja është e dobishme për përmirësimin e sigurisë gjatë transportit, rikuperimit apo asgjësimit të tyre.
- Personi që prodhon mbetje të rrezikshme paguan kostot e transportit, të rikuperimit dhe asgjësimit.
- Në nenin 20 ndalohet në të gjitha rrethanat importimi i mbetjeve të rrezikshme në Republikën e Shqipërisë, si dhe tranziti ndërkufitar i tyre përmes territorit të Republikës së Shqipërisë.
- Ndërsa në nenin 21 lejohet eksporti i Mbetjeve të Rrezikshme me leje mjedisore, e cila jepet në përputhje me rregullat dhe kërkesat e Konventës së Bazelit.

#### **2.2.11. PYJET DHE SHËRBIMIN PYJOR - PSHP**

**(LIGJI NR. 9385, DATË 4.05.2005)**

Objekti i ligjit është përcaktimi i rregullave të njëjta për marrëdhëniet, detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e institucioneve shtetërore, organeve të pushtetit vendor, organizatave jofitimprurëse, pronarëve privatë dhe të biznesit për ruajtjen, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e fondit pyjor kombëtar, të tokës pyjore dhe të burimeve natyrore e biologjike të tyre.

Qeverisja e fondit pyjor kombëtar mbështetet në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm e shumë-funksional të pyjeve e kullotave, të përfshira në strategjinë e zhvillimit të sektorit të pyjeve e kullotave, në programin kombëtar dhe në planet afatgjata të veprimit.

## **REFORMA E DECENTRALIZIMIT NË SHQIPËRI**

Reforma e decentralizimit në Shqipëri synon të bëjë më të qëndrueshëm sistemin demokratik, të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin

qeverisës, të stimulojë krijimin e një baze të qëndrueshme për zhvillimin ekonomik, ta bëjë qeverisjen më transparente dhe të sigurojë pjesëmarrjen e qytetarëve në vendim-marrje për administrimin e jetës komunitare.

Në kuadër të zhvillimit të reformës së decentralizimit, në kuptim të transferimit të funksioneve, përgjegjësive dhe kompetencave nga pushteti qendror, njësisive të qeverisjes vendore, në parametra bashkëkohorë, Shqipëria ka nënshkruar Kartën Evropiane të Autonomisë Lokale dhe e ka ratifikuar atë me Ligjin Nr.8548, datë 11.11.1999, "Për ratifikimin e Kartës Evropiane të autonomisë vendore". Gjithashtu legjislacioni i miratuar për decentralizim është në përputhje me parimet dhe frymën e kësaj karte.

Shqipëria, si vend anëtar i Këshillit të Evropës, merr pjesë aktive në komisionet dhe aktivitetet e zhvilluara për rritjen dhe konsolidimin e demokracive lokale. Nëpërmjet këtyre pjesëmarrjeve është përfituar nga eksperiencat e vendeve të tjera anëtare përsa i përket zhvillimit dhe pasurimit të filozofisë së decentralizimit dhe rritjes së autonomisë vendore.

Reforma e decentralizimit, si një proces kompleks dhe i vazhdueshëm, përmbledh kalimin e funksioneve të mëposhtme nga qeverisja qendrore në atë vendore:

➤ Furnizimi me ujë të pijshëm dhe kanalizimet: këtu përfshihet edhe transferimi i pronave të paluajtshme shtetërore të shoqërive anonime të Ujësjellës-Kanalizimeve, në pronësi të bashkive dhe/apo komunave;

➤ Planifikimi urban dhe menaxhimi i tokës urbane përmes krijimit dhe funksionimit të KRRT-ve për çdo njësi të qeverisjes vendore;

➤ Inventarizimi i plotë i rrugëve urbane dhe transferimi i tyre, si dhe fondet e investimeve kapitale përkatëse në pronësi të bashkive;

➤ Shërbimi i transportit publik, sipas të cilit bashkitë dhe komunitat gëzojnë të drejtën e liçensimit të mjeteve të transportit urban;

➤ Mbrojtja e mjedisit, e cila realizohet nga organet përkatëse të qeverisjes vendore në bashkëpunim me Agjencitë Rajonale të Mjedisit, të ngritura në nivel prefekturash dhe në varësi të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;

➤ Me miratimin e dokumenteve të politikave të decentralizimit në fushën e arsimit, shëndetësisë, si edhe ndihmës dhe shërbimeve sociale u arrit ndarja e përgjegjësive dhe kompetencave, të cilat transferohen menjëherë apo gradualisht në organet e qeverisjes vendore sipas fushave:

- Në arsimin para-universitar;
- Në shërbimin parësor shëndetësor dhe mbrojtjen e shëndetit publik;
- Në ndihmën ekonomike dhe shërbimet sociale, që konsiston në administrimin e azileve, shtëpive të fëmijëve, objekteve të shërbimit social, si dhe në administrimin e fondeve për punë, ndihmë ekonomike e shërbime në komunitet, të cilat janë kompetenca të plota të njësive të qeverisjes vendore.

? Shpërndarja e përgjegjësive brenda pushtetit vendor bëhet në përputhje me rolin që luajnë organet përkatëse vendore në bashki, komuna dhe qark sipas ligjit, duke ndjekur fazat e mëposhtme:

- |  |
|--|
| <ol style="list-style-type: none"><li>1. Përcaktimi i qartë i përgjegjësive dhe autoritetit si dhe përcaktimi i skemës së varësisë;</li><li>2. Përcaktimi i kriterëve të financimit, i fondeve dhe i procedurave;</li><li>3. Kuadri ligjor i kërkuar;</li><li>4. Ngritja e kapaciteteve;</li><li>5. Vlerësimi.</li></ol> |
|--|

Në kuadër të decentralizimit të kompetencave lidhur me mjedisin, strukturat e mbrojtjes së mjedisit në njësitë e qeverisjes vendore, si dhe inspektorati e policia e bashkisë dhe komunës, kanë

përgjegjësi që rrjedhin nga ligji organik i organizimit dhe funksionimit të tyre, legjislacioni mjedisor dhe akte të tjera normative.

Kompetencat specifike vendore për mjedisin i kanë cilësuar Agjencitë Rajonale të Mjedisit si organe të specializuara për monitorimin dhe kontrollin e mjedisit dhe të elementëve të tij.

#### **KUADRI LIGJOR SPECIFIK PËR ORGANIZIMIN E QEVERISJES VENDORE**

Kuadri ligjor specifik për organizimin e qeverisjes vendore është gjithashtu i bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe përbëhet nga ligjet dhe aktet normative, si vendimet e Këshillit të Ministrave, aktet ministeriale, rregulloret, udhëzimet dhe standardet përkatëse. Kjo pjesë e legjislacionit kombëtar është hartuar në kuadër të reformës së decentralizimit dhe në përgjigje të përpjekjeve të vendit për harmonizimin e legjislacionit me direktivat përkatëse të BE-së.

#### **2.4.1. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I QEVERISJES VENDORE – OFQV (LIGJI NR. 8652, DATË 31.07.2000)**

Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të qeverisjes vendore, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre dhe të organeve përkatëse.

Në gamën e funksioneve dhe kompetencave që përcakton ky ligj për qeverisjen vendore në fusha të ndryshme të veprimtarisë ekonomiko-sociale, si në infrastrukturë, shërbimet me karakter kulturor, ekonomik dhe sportiv, zhvillimit ekonomik, rendit dhe mbrojtjes civile, disa prej tyre, janë të lidhura drejtpërsëdrejti apo tërthorazi me mbrojtjen e mjedisit:

- 1) Funksionimi i sistemit të kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të ujërave të zeza;
- 2) Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve me karakter vendor, trotuareve dhe shesheve publike;
- 3) Administrimi i parqeve, lulishteve dhe zonave të gjelbëruara publike;
- 4) Grumbullimi, largimi dhe përpunimi i mbeturinave;

- |   |
|---|
| <ol style="list-style-type: none"><li>5) Planifikimi urban, menaxhimi i tokës dhe strehimi, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;</li><li>6) Përgatitja e programeve të zhvillimit ekonomik vendor;</li><li>7) Ruajtja dhe zhvillimi i pyjeve, kullotave dhe burimeve natyrore me karakter vendor.</li></ol> |
|---|

Në funksionet e përbashkëta të qeverisjes vendore me pushtetin qendror, krahas arsimit, shëndetësisë, kujdesit social, rendit dhe mbrojtjes civile, përfshihet dhe mbrojtja e mjedisit (referuar pikës 3/d të nenit 11, të ligjit të mësipërm).

Organet e njësive të qeverisjes vendore mund të ndërmarrin nisma me interes publik vendor për çdo çështje që nuk u ndalohe me ligj ose që nuk i është dhënë ekskluzivisht me ligj, një organi tjetër shtetëror.

Komunat dhe bashkitë kanë kompetenca të plota administrative, shërbimi, investimi dhe rregullatore për funksionet e veta të përcaktuara në këtë ligj, të cilat i ushtrojnë duke respektuar politikat kombëtare dhe rajonale. Për këto funksione, pushteti qendror mund të vendosë standarde e norma specifike kombëtare.

#### **Parimet themelore të funksionimit të organeve të njësive të qeverisjes vendore:**

- 1) Organet e njësive të qeverisjes vendore veprojnë në bazë të parimit të autonomisë vendore;
- 2) Marrëdhëniet ndërmjet vetë organeve të njësive të qeverisjes vendore, si dhe marrëdhëniet e tyre me organet e pushtetit qendror bazohen në parimin e ndërvarësinë dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta;
- 3) Në veprimtarinë e tyre organet e njësive të qeverisjes vendore respektojnë Kushtetutën, ligjet dhe aktet e nxjerra në bazë dhe për zbatimin e tyre;
- 4) Organet e njësive të qeverisjes vendore janë persona juridikë;

5) Çdo komunë, bashki dhe qark është organ qeverisës me vazhdimësi.

#### **Funksionet e Qarkut:**

- 1) Funksionet e qarkut janë ndërtimi dhe zbatimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat shtetërore në nivel qarku, si dhe çdo funksion tjetër i vet i dhënë me ligj;
- 2) Qarku ushtron të gjitha funksionet që i delegohen nga një ose më shumë komuna e bashki brenda territorit të tij, sipas një marrëveshjeje të lidhur midis palëve;
- 3) Qarku kryen dhe ushtron kompetencat e deleguara nga pushteti qendror, sipas parimeve të parashikuara në nenin 12 të këtij ligji.

#### **2.4.2. RATIFIKIMI I KARTËS EVROPIANE TË AUTONOMISË VENDORE - RKEAV (LIGJI NR. 8548, DATË 11.11.1999)**

Duke ruajtur dispozitat më të përgjithshme, të krijuara nga ligji, bashkësitë vendore mund të përcaktojnë vetë strukturat e brendshme administrative, me të cilat duhet të pajisen, me synimin që t'ia përshtatin ato nevojave të tyre specifike dhe të sigurojnë një drejtim efikas.

Statuti i personelit të bashkësive vendore duhet të mundësojë një rekrutim cilësor njerëzish, bazuar në parimet e meritës e të aftësisë; për këtë qëllim ai duhet të përmbledhë kushtet e duhura të formimit, të shpërblimit dhe të perspektivave të profesionit.

#### **2.4.3. PREFEKTI (LIGJI NR. 8927, DATË 25.7.2002)**

Ky ligj përcakton misionin e prefektit, si përfaqësues i Këshillit të Ministrave në Qark, cilësinë dhe kushtet për emërimin e tij dhe në mënyrë të veçantë përgjegjësitë, detyrat dhe të drejtat e tij në marrëdhëniet me administratën shtetërore dhe me organet e qeverisjes vendore që veprojnë në qark.



### **Misioni i prefektit:**

1) kujdeset, ndjek dhe merr masa për plotësimin nga të gjitha institucionet në nivel qarku të detyrimeve që ato kanë për të garantuar sovranitetin, rendin kushtetues dhe shëndetin publik;

2) mbikëqyr, kontrollon dhe bashkërendon veprimtarinë e institucioneve qendrore në nivel vendor;

3) drejton veprimtarinë e strukturave administrative shtetërore, të cilat me akte ligjore e nënligjore të veçanta, janë caktuar në varësinë e tij të drejtpërdrejtë;

4) bashkërendon veprimtarinë e institucioneve qendrore në nivel vendor, si dhe të këtyre me organet e qeverisjes vendore në komuna, bashki e qarqe;

5) është i vetmi institucion administrativ që verifikon ligjshmërinë e akteve të miratuara nga organet e qeverisjes vendore në komuna, bashki e qark.

## **REFORMA DECENTRALIZUESE DHE DELEGIMI I KOMPETENCAVE TEK AUTORITETET MJEDISORE VENDORE**

### **2.5.1 INSTITUCIONET VENDORE PËR MBROJTJEN E MJEDISIT**

Organet e qeverisjes vendore përfaqësojnë strukturën më të rëndësishme shtetërore për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit që kanë në juridiksion, duke zbatuar përgjegjësitë, të drejtat e detyrat që u jep Ligji nr.8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore". (Referuar nenit 73 të Ligjit nr.8934, datë 5.09.2002, "Për mbrojtjen e mjedisit").

Në mbrojtje të mjedisit ato kanë për detyrë:

1. të realizojnë zbatimin e ligjeve për mbrojtjen e mjedisit;
2. të hartojnë plane vendore për mbrojtjen e mjedisit, duke integruar mbrojtjen e mjedisit në planet e rregullimit të territorit;
3. të bëjnë publike programet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit;

4. të njoftojnë publikun për gjendjen e mjedisit dhe për veprimtaritë vendore, subjekte të vlerësimit të ndikimit ndaj mjedisit.
5. të nxisin e të mbështesin veprimtaritë e organizatave jofitimprurëse për mjedisin, duke tërhequr mendimin e tyre në vendim-marrjet për mjedisin;
6. të përcaktojnë vendet e grumbullimit e të përpunimit të mbeturinave prodhuese dhe jetësore, në përputhje me kriteret mjedisore dhe planet e zhvillimit;
7. të organizojnë depozitimin e mbetjeve dhe të lëndëve të rrezikshme dhe ruajtjen e zonave të gjelbra në qendrat qytetëse dhe rreth tyre;
8. të administrojnë mbeturinat qytetëse, impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura dhe të mbeturinave të ngurta;
9. të disiplinojnë transportin dhe ndërtimet në mjediset qytetëse.

### **2.5.2. AGJENCITË RAJONALE TË MJEDISIT**

Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM) janë organe të specializuara për mbrojtjen e mjedisit, që varen nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe organizohen e veprojnë në nivel qarku. (Referuar nenit 69 të Ligjit nr.8934, datë 5.09.2002, "Për mbrojtjen e mjedisit").

Në zbatim të përparësive dhe objektivave të MMPAU, Agjencitë Rajonale:

- 1) realizojnë zbatimin e ligjshmërisë për mbrojtjen e mjedisit në nivel vendor;
- 2) ndihmojnë organet e pushtetit vendor për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit që kanë në juridiksion, bashkëpunojnë për hartimin dhe zbatimin e planeve vendore të veprimit për mjedisin;
- 3) nxisin përdorimin e teknologjive të pastra dhe futjen e sistemeve të administrimit mjedisor;
- 4) marrin pjesë në procesin e miratimit të lejes dhe të deklaratës mjedisore, duke përbushur detyrat që përcakton Ministri i Mjedisit me udhëzim të veçantë. Japin pëlqimin dhe autorizimin mjedisor për veprimtari vendore;
- 5) hartojnë dhe paraqesin për miratim në këshillin e qarkut raportin dyvjeçar të gjendjes së mjedisit të qarkut. Pas miratimit, ky

raport i bëhet i ditur publikut nëpërmjet mediave të shkruara dhe elektronike;

6) ndërmarrin veprimtari ndërgjegjësuere për mjedisin, bashkëpunojnë me bashkësitë, me organizatat jofitimprurëse mjedisore dhe profesionale të biznesit.

Rregullat e hollësishme për organizimin, funksionimin dhe sistemimin e agjencive rajonale të mjedisit caktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mjedisit.

### **2.5.3. INSPEKTORATI MJEDISIT**

Inspektorati i Mjedisit përbëhet nga Kryeinspektori, nga inspektorët në Ministrinë e Mjedisit dhe nga inspektorët e agjencive rajonale të mjedisit.

Detyrat kryesore të Inspektoratit të Mjedisit: (Referuar nenit 71 të Ligjit nr.8934, datë 5.09.2002, “Për mbrojtjen e mjedisit”).

1) ushtron kontroll të vazhdueshëm mbi mjedisin dhe ndaj veprimtarive ndotëse, për të siguruar mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet zbatimit të legjislacionit mjedisor dhe kërkesave të vëna në lejen dhe në deklaratën mjedisore. Kontrollat kryhen nga grupe inspektorësh ose nga një inspektor i vetëm;

2) kërkon pjesëmarrjen e organeve të qeverisjes vendore, të përfaqësuesve të bashkisë, të organizatave jofitimprurëse mjedisore dhe të mediave në kontrollat mbi veprimtaritë ndotëse;

3) krijon dosjen mjedisore për çdo veprimtari të pajisur me leje mjedisore. Rregullat e hollësishme për formën, përmbajtjen, administrimin e dosjes mjedisore, përcaktohen nga Ministri i Mjedisit;

4) ndihmon personat fizikë e juridikë për të realizuar vetë-monitorimin, verifikimin dhe zbatimin e sistemeve të integruara të administrimit dhe kontrollon zbatimin e tyre;

5) urdhëron masa të detyrueshme për zbatim për përmirësimin e gjendjes së mjedisit, për pakësimin e ndotjes dhe të dëmtimit të mjedisit;

- 6) vë në dijeni rregullisht pushtetin vendor për gjendjen e mjedisit, për veprimtaritë, projektet dhe instalimet e miratuara, sipas kërkesave të këtij ligji;
- 7) kontrollon regjistrat e ndotësve, rregulloret e brendshme, teknike e teknologjike dhe dokumentet e tjera që lidhen me veprimtarinë dhe rrezikun e ndotjes;
- 8) vendos sanksione, sipas këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore, që mbrojnë përbërës të veçantë të mjedisit;
- 9) bën publike rezultatet për çdo kontroll të ushtruar.

Veprimtaria kontrolluese e Inspektoratit të Mjedisit pasqyrohet në dokumente standarde të miratuara nga Ministri i Mjedisit. Rregullat e hollësishme për organizimin, funksionimin e Inspektoratit të Mjedisit sanksionohen në **Vendimin nr. 24, datë 22.01.2004, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mjedisit”**, të Këshillit të Ministrave.

Gjithashtu, Inspektorati i Mjedisit:

- 1) Kujdeset që gjendja e mjedisit dhe ndikimet mbi të të pasqyrohen vazhdimisht në mjetet e informimit publik;
- 2) Inspektorati propozon përmirësime të kuadrit ligjor, me qëllim rritjen e efektshmërisë së kontrollit, përsosjen e masave detyruese ligjore, rritjen e përgjegjësisë së subjekteve, për të ulur ndikimin në mjedis e të tjera;
- 3) Inspektorati i Mjedisit në organizimin e kontrolleve bashkëpunon me Policinë e Rendit, Policinë Pyjore, Policinë e Ndërtimit, Inspektoratin Sanitar Shtetëror, Inspektoratin Shtetëror të Punës, Inspektoriatin e Mbrojtjes së Bimëve, Inspektoriatin e Peshkimit, Inspektoriatin e Hidrokarbureve, Inspektoriatin Veterinar dhe strukturat e organeve të qeverisjes vendore, sipas njësisve territoriale përkatëse.

#### **2.5.4. INSPEKTORATI I MJEDISIT URBAN**

Inspektorati i Mjedisit Urban është organizuar dhe funksionon duke zbatuar **VKM nr. 228, 27.05.1992, “Për ruajtjen e mjedisit urban nga ndotja dhe dëmtimet”**.

Ruajtja e mjediseve urbane dhe e peizazhit natyror brenda, në periferi e ndërmjet qyteteve e qendrave të tjera të banuara, si rrugët trotuaret, mjediset e përbashkëta në lagjet e banimit, mjediset e gjelbëruara, parqet periferike, parqet kombëtare anash rrugëve kombëtare, qendrat e pushimit jashtë qyteteve, plazhet, varrezat e mjedise të tjera të kësaj natyre nga ndotësit, (e ngurtë, të lëngët e të gaztë, duke përfshirë dhe ndotjet akustike të lokaleve e të tjera) si dhe nga dëmtimet nga ndërtimet pa leje të subjekteve të ndryshme, është e detyrueshme për të gjithë personat juridikë e fizikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtari në territorin e tyre administrativ.

### **2.5.5. POLICIA BASHKIAKE**

Në Republikën e Shqipërisë, pranë bashkive e komunave, organizohet dhe funksionon policia e bashkisë dhe e komunës, përkatësisht në vartësi të kryetarit të bashkisë e të komunës. Policia bashkiake dhe e komunës është organ ekzekutiv, që ka për detyrë të kryejë funksione në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike brenda territorit të bashkisë a të komunës, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe që nuk janë në kompetencë të autoriteteve të tjera shtetërore

Në zbatim të Ligjit nr. 8224, dt.15.05.1997, “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës”, të ndryshuar me Ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Policia Bashkiake ka për detyrë:

1. të sigurojë zbatimin efektiv të akteve të nxjerra nga kryetari i bashkisë, të vendimeve të këshillit që kanë të bëjnë me sigurimin e rendit e të qetësisë dhe mbarëvajtjen e punëve publike;
2. të marrë masa për ruajtjen e pasurive të Bashkisë, si dhe atyre që administrohen prej saj;
3. të sigurojë zbatimin e urdhrave të nxjerra nga kryetari i Bashkisë në lidhje me personat juridikë ose fizikë, që nuk plotësojnë konform ligjit detyrimet financiare e fiskale ndaj Bashkisë, si dhe çdo detyrim tjetër pasuror ndaj tyre;
4. të mbikëqyrë e të verifikojë nëse shtetasit në administrim të pasurisë së tyre, zbatojnë ose plotësojnë kërkesat e akteve bashkiake;
5. të konstatojë e të parandalojë ndotjet e mjedisit, hedhjet e mbeturinave të ndryshme, të sinjalojë kryetarin e Bashkisë për

shfaqjet e parazitëve të dëmshëm e të rrezikshëm, si dhe për rastet e shfaqjes së epidemive;

6. të ndalojë, shmangë e prishë ndërtimet e paligjshme, të ndalojë zëniet e paligjshme të trojeve dhe të ndërtesave e objekteve publike të Bashkisë, si dhe të organizojë lirimim e tyre;

7. të kujdeset për qetësinë publike, duke shmangur zënkat, duke mënjanuar zhurmat e shkaktuara nga grumbullimet e njerëzve, altoparlantët e radiove e magnetofonave, rënien pa vend të burive të automjeteve në rrugë, banesa, plazhe e mjedise të tjera publike, që sjellin shqetësime për të tjerët;

8. të marrë masa për ruajtjen e rendit, kur ka grumbullime njerëzish, si në tregje, panairë, ceremoni publike, artistike, fetare e sportive, në kinema, teatro e salla sportive, objekte të kultit dhe në mjedise të tjera publike;

9. të inspektojë tregjet, të kontrollojë zënien e vendeve për tregti ambulante, të verifikojë pajisjen me licencë të tregtarëve dhe personave të tjerë, që merren me veprimtari shit-blerjeje, me tregtimin e pijeve alkoolike, të objekteve me vlera artistike e kombëtare, të lëndëve djegëse, të kontrollojë respektimin e masës, peshës dhe çmimit të shitjes;

10. të kujdeset për respektimin e orarit të shërbimit të njësieve tregtare, bar-bufëve, restoranteve, bilardove, lojërave të fatit e të objekteve të tjera me veprimtari publike, si dhe për zbatimin nga ana e këtyre të rregulloreve apo urdhrave të nxjerra nga kryetari i Bashkisë;

11. të kontrollojë marrjen e masave të sigurisë që parandalojnë fatkeqësitë e ndryshme natyrore, si dhe të ndihmojë në kapërcimin e tyre, duke u dhënë gjithashtu ndihmë të dëmtuarve në raste urgjence;

12. të marrë masa të përkohshme ndaj të sëmurëve psikikë në gjendje të rëndë, që krijojnë shqetësime për rendin publik;

13. të kujdeset për ruajtjen e afisheve, njoftimeve e shpalljeve publike, si dhe heqjen e atyre që janë të paligjshme ose të paautorizuara.

14. të kontrollojë e të marrë masa për zbatimin e rregulloreve, urdhrave e udhëzimeve të lëshuara nga kryetari i Bashkisë për probleme që lidhen me zbatimin e këtij ligji.

## **2.5.6. KOMPETENCAT MJEDISORE TË DELEGUARA TEK AUTORITETET LOKALE**

Në zbatim të Ligjit nr.8990, datë 23.01.2003, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" dhe të VKM nr. 805, datë 04.12.2003, "Për miratimin e listës së veprimtarive, që ndikojnë në mjedis, për të cilat kërkohet leje mjedisore", organi që shqyrton dhe miraton lejet mjedisore është Komisioni i Shqyrtimit të Kërkesave në MMPAU.

Në kuadër të krijimit të lehtësirave, të shmangies së barrierave administrative ndaj subjekteve, si dhe të decentralizimit të kompetencave ligjore, Ministri i Mjedisit ka miratuar Udhëzimin nr.3, datë 17.08.2004, "Për miratimin e veprimtarive, formatimin e aplikimit dhe rregullat e procedurat e dhënies së pëlqimit dhe autorizimit mjedisor nga agjencitë rajonale të mjedisit".

1) Veprimtaritë me karakter vendor që ndikojnë në mjedis, por që nuk përfshihen në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 805, datë 4.12.2003, "Për miratimin e veprimtarive me ndikim në mjedis për të cilat kërkohet leje mjedisore", miratohen nga Agjencitë Rajonale të Mjedisit (ARM), në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore.

2) Agjencitë Rajonale të Mjedisit pajisin me autorizim ose me pëlqim mjedisor veprimtaritë me karakter vendor që ndikojnë në mjedis, sipas Listës që i bashkëngjitet këtij Udhëzimi në formën e shtojcës.

3) Autorizimi dhe pëlqimi mjedisor përcaktojnë kushtet dhe kërkesat, në bazë të të cilave duhet të zhvillohet veprimtaria, me qëllim që të shmangen apo të zbuten ndikimet negative në mjedis dhe shëndetin e njeriut.

4) Autorizimi dhe pëlqimi mjedisor janë të njëvlershëm me lejen mjedisore që lëshon Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për veprimtaritë me karakter kombëtar që ndikojnë në mjedis.

5) Veprimtaritë që pajisen me autorizim apo pëlqim mjedisor, respektojnë kërkesat e legjislacionit mjedisor dhe të

autorizimit e të pëlqimit, njësoj si ato që janë pajisur me leje mjedisore.

**NEVOJA PËR NJË STRATEGJI TË EDUKIMIT MJEDISOR  
NË NIVEL VENDOR**

Me qëllim garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit, si një nga prioritetet më kryesore të Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social dhe të Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, si dhe në kuadër të plotësimit të detyrimeve të Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit me BE-në, hartimi dhe miratimi i Strategjisë së Edukimit Mjedisor (EM) në Nivel Vendor përbën domosdoshmëri, pasi:

- 1) Edukimi mjedisor si një strategji komunikimi do të përçojë dashurinë dhe kujdesin për natyrën në të gjitha komunitetet;
- 2) EM duhet të jetë një nga komponentët kryesorë të Planeve Lokale të Veprimit për Mjedisin (PLVM);
- 3) Agjencitë Rajonale të Mjedisit, Strukturat Mjedisore në organet e qeverisjes vendore (SMQV), Drejtoritë Arsimore, Drejtoritë e Shërbimit Parësor Shëndetësor duhet të përdorin elementë të EM në aktivitetet e përditshme dhe ato të përbashkëta;
- 4) ARM, SMQV dhe Dhomat e Biznesit nëpër bashki, duhet të punojnë për futjen e EM në bizneset dhe veprimtaritë lokale, për prezantimin e bizneseve të gjelbra dhe përfitimet që i vijnë biznesit dhe komunitetit nga përdorimi i tyre;
- 5) Në bashkëpunim me OJF-të mjedisore dhe bazuar në Strategjinë e Edukimit Mjedisor, SMQV duhet të organizojnë aktivitete, si dhe të shfrytëzojnë mediat lokale për ndërgjegjësimin e komunitetit dhe rolin e tij në përmirësimin e cilësisë së jetës, duke u përkujdesur për mjedisin në të cilin jetojnë, me qëllim mbrojtjen e tij në tërësi dhe të burimeve natyrore vendore, për t'u prezantuar me dinjitet në familjen evropiane edhe në aspektet e edukatës mjedisore.



# **MENAXHIMI I**

## **3 PROBLEMEVE MJEDISORE**

### **NË NIVEL VENDOR**

---

Në zinxhirin e përpjekjeve në shkallë kombëtare për mbrojtjen e mjedisit, organet e qeverisjes vendore luajnë një rol të rëndësishëm për vetë faktin se problemet mjedisore, nga natyra, janë specifikisht të lokalizuara dhe, për pasojë, kërkojnë rregullime të tilla institucionale dhe përdorim të instrumenteve ekonomike të ndryshme, sipas faktorëve mjedisorë dhe ekologjikë në zona gjeografike të ndryshme. Këtu vjen në ndihmë decentralizimi institucional për adresimin e problemeve mjedisore, përmes të cilit autoriteti dhe përgjegjësia për disa funksione janë transferuar nga organet qendrore në ato të qeverisjes vendore.

#### **PROBLEMET KRYESORE MJEDISORE**

Me fillimin e periudhës tranzitore në Shqipëri u evidentua menjëherë ndikimi negativ i ekonomisë së centralizuar të së kaluarës në mjedis. Për pasojë, që në fillim të viteve 90', krahas shumë problemeve të tjera më prioritare, çështjet mjedisore u shtruan për zgjidhje nga Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit, pararendës i organeve të tjera qendrore, me rrjetin përkatës pranë organeve të qeverisjes vendore, për të ardhur sot në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, si institucioni qendror i specializuar për mbrojtjen e mjedisit: parandalimin dhe kufizimin e ndotjes, të degradimit të mjedisit, përtëritjen, ruajtjen dhe përmirësimin e tij.

Vendi përballët me një sërë problemesh mjedisore, të cilat evidentohen në raportet e gjendjes së mjedisit dhe në të tjera dokumente për mjedisin, të hartuara në këto 10-15 vitet e fundit:

1) Sektori industrial, me teknologjinë e vjetër në përdorim, dhe parku i automjeteve të vjetra gjenerojnë ndotje të ajrit. Pellgjet e ujërave nëntokësore ndoten potencialisht nga shkarkimet e ujërave industriale, megjithëse gjendja e ujërave sipërfaqësore është disi më e mirë se sa përpara viteve 90', për shkak të mosfunksionimit të një pjese të mirë të industrisë së rëndë;

2) Mbetjet urbane dhe shkarkimet industriale ndotin tokën. Mospërdorimi i mirë i tokës dhe praktikatat e shfrytëzimit joracional të saj kanë rritur fenomenin e erozionit dhe kanë ndikuar në kripëzimin e tokës së punueshme;

3) “Zonat e nxehta mjedisore”, që janë në shumicën e tyre zona industriale të braktitura, karakterizohen nga përqendrimet të larta të substancave toksike dhe kancerogjene, duke ekspozuar popullsinë në afërsi të tyre përkundrejt rreziqeve shëndetësore, për pasojë të mjedisëve të kontaminuara;

4) Mungesa e masave organizative dhe shfrytëzimi afat-gjatë, sistematik dhe pa kriter i burimeve pyjore kanë shkaktuar shpyllëzim në shkallë të gjerë. Shpyllëzimi, fragmentimi i habitateve dhe degradimi i ekosistemeve kanë ndikuar rrjedhimisht negativisht edhe mbi biodiversitetin.

Për zgjidhjen e problemeve të sipërpërmendura, janë bërë deri më tani përpjekje të rëndësishme, për të përqafuar një sjellje bashkëkohore në lidhje me mjedisin, përmes:

1) Formulimit të strategjive, planeve të veprimit dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit me të gjithë komponentët e tij;

2) Dekretimit të një kuadri të ri ligjor për mjedisin;

3) Ngritjes dhe funksionimit të strukturave të veçanta shtetërore për mbrojtjen e mjedisit;

4) Përfshirjes së shoqërisë civile në problemet mjedisore (përmes aktivitetit të OJF-ve mjedisore);

5) Përcaktimit të roleve dhe përgjegjësive të aktorëve kryesorë në fushën e mjedisit si organet shtetërore, qendrore dhe vendore, shoqëria civile, biznesi dhe investuesit e ndryshëm etj.;

6) Koordinimit në shkallë të gjerë edhe me faktorin mjedisor ndërkombëtar: me organizatat ndërkombëtare, globale apo rajonale, me shtete të ndryshme, midis të cilëve më të rëndësishme janë ato fqinjë, me të cilët ndajmë një mjedis të përbashkët etj.;

7) Formulimit dhe zbatimit të një serie projektesh të rëndësishme mjedisore, të mbështetura me fonde buxhetore apo nga donatore të fuqishëm.

#### **MENAXHIMI I MBETJEVE**

Shoqëria e sotme shqiptare po përballet me transformimet e mëdha ekonomike, të shoqëruara me rritjen e konsumit prej popullsisë së të mirave materiale dhe për rrjedhojë edhe me rritjen e sasisë së mbeturinave të gjeneruara. Veç kësaj, edhe për shkak të migrimit të popullsisë dhe ritmeve të larta të rritjes së popullsisë, menaxhimi i mbetjeve të ngurta urbane është shndërruar në një sfidë të fuqishme, kryesisht në qytetet e mëdha të vendit.

#### **3.2.1. SITUATA AKTUALE**

Mbetjet e ngurta urbane gjenerohen nga burime shtëpiake, administrata shtetërore me të gjitha strukturat e saj, sektorët e ndërtimit, prodhimit e shërbimet e ndryshme. Mbetjet e gjeneruara grumbullohen pa asnjë ndarje paraprake të tyre, ndërsa problemi rëndohet sa kohë që bashkë me to grumbullohen edhe mbetje të tjera që përdoren në jetën e përditshme, por që mund të rezultojnë të rrezikshme (psh. bateritë etj.).

Largimi i mbetjeve të gjeneruara bëhet nëpër pikat e grumbullimit bashkiak apo komunal me hedhje të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet qesesh plastike të posaçme ose jo, por gjithsesi pa asnjë ndarje të mbetjeve sipas llojit apo përbërjes.

Transporti i mbetjeve në vend-depozitimet (fushat) e plehrave nga pikat e grumbullimit të mbetjeve nuk ka frekuencën dhe cilësinë e

dëshiruar; për pasoje, koha e qëndrimit të mbetjeve në këto pika lejon fermentimin e tyre e, për rrjedhojë, keqësimin e cilësisë urbane dhe rritjen e rrezikut për shëndetin e qytetarëve. Problemi përkeqësohet në periudhën e verës.

Sa i takon përzgjedhjes dhe caktimit zyrtar të vend-depozitimeve të mbetjeve urbane, shumica e vend-depozitimeve nuk plotësojnë kriteret mjedisore që synojnë drejt kufizimit maksimal të mundshëm të shpërhapjes së ndotjes dhe shkallë minimale të ekspozimit të popullatës ndaj kësaj ndotjeje. Informacioni mbi sasinë e gjeneruar të mbetjeve dhe kompozimin e tyre është relativisht i kufizuar.

Vlerësimi në shkallë kombëtare jep një shifër rreth 600,000 ton në vit, me një prodhim specifik rreth 0,8 kg/banor në ditë. Sasia e mbetjeve të gjeneruara pritet të rritet me rritjen graduale të ekonomisë dhe rritjen e nivelit të jetesës.

Përbërësit më të rëndësishëm të mbetjeve janë ato organikë, letra, xhama, metale, mbetje tekstile, plastmasa dhe druri, nga të cilat përqindja e lëndës organike, në varësi nga qarku, luhetet nga 40 - 60% të totalit të tyre.

Kësaj sasive mbetjesh i shtohet edhe një sasi prej rreth 350,000 ton në vit mbetje insertesh, të ardhura nga industria e ndërtimit, të cilat nuk kanë vend-depozitime të posaçme dhe për pasojë shkojnë në vend-depozitimet e mbetjeve urbane, duke shtuar volumin dhe vështirësuar menaxhimin e tyre.

Përgjegjësia e drejtpërdrejtë e menaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane është e organeve të qeverisjes vendore. Në pjesën më të madhe të qyteteve, mbetjet grumbullohen dhe transportohen përmes kompanive të shërbimit të bashkive, ose private të kontraktuara nga bashkitë. Zonat rurale nuk mbulohen me asnjë lloj shërbimi për grumbullimin apo transportimin e mbetjeve, gjë që çon në krijimin e vend-depozitimeve ilegale anës rrugëve, apo në djegien e tyre të hapur në natyrë.

Sa lidhet me vend-depozitimet, problemet kryesore mjedisore të identifikuar lidhen me djegien e plehrave në to, duke u shndërruar në një burim të rëndësishëm të ndotjes së ajrit dhe filtrimet e

mundshme të ujërave të perkolatit në ujëra nëntokësore. Për pasojë, pjesa më e madhe e vend-depozitimeve janë shndërruar në “zona të nxehta mjedisore”. Nga ana tjetër, për shkak të mungesës së fondeve, ka mungesa të theksuara për mjete të nevojshme dhe fuqi punëtore për mirë-menaxhimin e mbetjeve. Mungojnë lehtësitë për veçimin, ndarjen, përpunimin apo riciklimin e mbetjeve, me përjashtim të një pjese të shisheve të qelqit, letrës, kartonit, mbetjeve të skrapit dhe kënaqeve të aluminit, të cilat në sasira të vogla grumbullohen për t’u ricikluar.

Problemi vështirësohet kur në shumicën e rasteve edhe mbetjet spitalore dhe ato industriale, duke përfshirë edhe mbetje të rrezikshme, trajtimi dhe asgjësimi i të cilave është përgjegjësi e gjeneruesve dhe për të cilat ka një kuadër të veçante ligjor, shkojnë dhe depozitohen në vend-depozitimet e mbetjeve të ngurta urbane, duke ndikuar në keq-menaxhimin aktual, përmes rritjes së ndikimit negativ në shëndet dhe në mjedis.

Sa lidhet me organizimin aktual të tërheqjes së mbetjeve në shkallë vendore, vërehet se:

- 1) Automjetet janë të standardit të dobët dhe të pambuluara;
- 2) Gjendja e kazanëve të grumbullimit të mbetjeve është relativisht e keqe;
- 3) Heqja jo e shpeshtë e mbetjeve çon në tejmbushje, madje dhe derdhje të kazanëve;
- 4) Mbetjet në rrugë shkaktojnë erë të rëndë dhe rrezik epidemish.

Në komunat e vogla nuk ofrohet shërbimi i mbledhjes së mbetjeve dhe individët janë vetë përgjegjës për heqjen dhe eliminimin e mbetjeve të tyre.

Kjo shpesh çon në hedhjen e mbetjeve kuturu, në anë të rrugës, apo në djegien e mbetjeve në natyrë.

Hedhja e paautorizuar zakonisht bëhet në tokë dhe kanale uji, sidomos buzë vendbanimeve të vogla. Materialet shpesh i merr uji

apo era dhe i shpërndan në mjedis, duke ndotur tokën dhe rrjedhën e ujit, në të cilën bien.

### 3.2.2. LEGJISLACIONI SPECIFIK

Në fushën e administrimit të mbetjeve veprojnë një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore si më poshtë:

- a) Ligji “Për mbrojtjen e mjedisit” (1993) dhe më pas Ligji i ri “Për mbrojtjen e mjedisit” (Shtator 2002);
- b) Ligji “Për largimin publik të mbeturinave” (1996);
- c) VKM “Për mbetjet e rrezikshme dhe mbeturinat” (1994);
- d) Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Vendor” (2000);
- e) Ligji “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (2003);
- f) Ligji “Për sistemin e taksimit në Republikën e Shqipërisë” (2003), me kapitullin përkatës për eko-taksat, sipas të cilit është vendosur një takse prej 1.5 lekë për shishet plastike dhe ambalazhe kartoni të plastifikuar 1.5 litërshe, si dhe 2 lekë për ato me volum mbi 1.5 litra. Të ardhurat nga këto taksa shfrytëzohen me destinacion mbrojtjen e mjedisit.
- g) VKM “Për rregullat dhe procedurat e importimit të mbetjeve për qëllime trajtimi, përdorimi dhe riciklimi” (2003);
- h) VKM “Për miratimin e Katalogut Shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, 2005, e të tjera.

Legjislacioni i sipërpërmendur është në pjesën më të madhe të tij i harmonizuar me direktivat përkatëse të BE-së në këtë fushë. Gjithsesi, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në bashkëpunim me ministrinë e linjës dhe aktoret e interesuar, po bën përpjekje maksimale për harmonizimin e tij të plotë me legjislacionin evropian.

Në paketën e sipërpërmendur, duke filluar me Ligjin bazë “Për mbrojtjen e mjedisit”, administrimi i mbetjeve urbane është ai

proces që synon parandalimin e krijimit të mbetjeve, si edhe riciklimin, ripërdorimin dhe rigjenerimin e tyre në procese të tjera.

Ligji Nr. 9010, datë 13.02.2003, “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, trajton nga ana e tij në mënyrë të detajuar të gjitha fazat e administrimit, që nga krijimi, grumbullimi, ndarja, ruajtja, transportimi, riciklimi, përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve.

Sipas të njëjtit ligj, përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve urbane duhet të kryhet nëpërmjet metodave dhe renditjes së detyrueshme për zbatim: ndarjes sipas klasifikimit të miratuar, riciklimit dhe ripërdorimit, fermentimit, djegies dhe groposjes sanitare.

Përcaktimi i vendit, ku instalohet impianti i përpunimit dhe asgjësimit të mbetjeve urbane, duhet t'i nënshtrohet procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe bëhet pasi mbahen parasysh një sërë kriteresh mjedisore.

Organet e qeverisjes vendore duhet të marrin masa për rehabilitimin e fushave ekzistuese të mbetjeve urbane në drejtim të:

- 1) Mbulimit me dhë dhe ngjeshjes;
- 2) Hapjes së kanaleve të veçanta për ujërat e kullimit;
- 3) Mbrojtjes nga zjarret;
- 4) Ndalimit të hyrjes për personat e paautorizuar;
- 5) Gjelbërimit të pjesës së fushës, ku nuk depozitohen mbetje.

Po sipas Ligjit “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, mirë-administrimi dhe rehabilitimi i vend-depozitimeve ekzistuese të mbetjeve urbane kryhet sipas rregulloreve lokale të vend-depozitimeve. Nga ana tjetër, personat fizikë dhe juridikë që prodhojnë, zotërojnë, përpunojnë dhe asgjësojnë mbetje të ngurta urbane, duhet të aplikojnë për leje mjedisore për ushtrimin e këtyre veprimtarive. Leja mjedisore jepet vetëm pas marrjes së miratimit nga qeverisja vendore dhe agjencia përkatëse rajonale e mjedisit.

Veç organeve të qeverisjes vendore, në shkallë qendrore për hartimin e Planit Kombëtar të Administrimit të Mbetjeve të Ngurta Urbane dhe kontrollin e zbatimit të tij, veprojnë edhe Ministria e

Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Brendshme. Të tjera organe dhe/ose aktorë me detyra dhe përgjegjësi në këtë fushë janë edhe:

1) Inspektorati i Mjedisit Urban dhe Inspektorati Sanitar Shtetëror, si organe kontrolli për cilësinë e pastrimit e transportit të mbetjeve në vend-depozitimet e tyre, të përpunimit dhe asgjësimit të mbetjeve urbane, të ndërtimit dhe mbetjeve të vëllimshme, si dhe zbatimin e akteve nënligjore të nxjerra nga organet që i kanë nën varësi;

2) Inspektorati i Mjedisit, si organ kontrolli për zbatimin e kushteve të vëna në lejet mjedisore, për kompanitë që kontraktohen të bëjnë pastrimin e trajtimin e mbetjeve;

3) Biznesi privat, që me pak investime, mund të përdorë praktika të “prodhimeve të pastra”, duke përfshirë riciklimin apo gjenerimin minimal të mbetjeve nga sektori i shërbimeve dhe ai i prodhimit;

4) Publiku i interesuar për menaxhimin mjedisor të mbetjeve, duke qenë njëkohësisht edhe gjenerues i tyre.

Një dispozitë e rëndësishme në kuadrin ligjor për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta urbane, lidhet me ndalimin në Republikën e Shqipërisë të importimit të mbetjeve të rrezikshme dhe të çfarëdolloj mbetjeje për qëllime asgjësimi.

Ligji përcakton edhe cilat mbetje nuk mund të groposen në etapën e tyre të fundit pas trajtimit, si më poshtë:

- 1) Mbetjet e lëngëta;
- 2) Mbetjet eksplozive dhe oksiduese;
- 3) Mbetjet e përflakshme;
- 4) Mbetjet spitalore, infektive dhe shpuese;
- 5) Gomat e përdorura të automjeteve.

Me qëllim që të bëhet plotësisht i zbatueshëm, Ligji “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” duhet të plotësohet edhe me një numër aktesh nënligjore, kryesisht rregullore, që lidhen



me secilën nga metodat e përpunimit dhe asgjësimit të mbetjeve të ngurta urbane dhe pastaj edhe me mbetjet e ndërtimit, mbetjet industriale, të minierave, mbetjet bujqësore dhe blegtorale, mbetjet spitalore dhe ato të krijuara në pikat e kalimit ndërkuftar. Mbi bazën e këtyre rregulloreve tip, organet e qeverisjes vendore do të duhet të nxjerrin rregulloret e tyre për çdo rast konkret.

### **3.2.3. PLATFORMA KOMBËTARE**

Objektivat në fushën e administrimit të mbetjeve urbane janë të përcaktuara në Planin Kombëtar të Veprimit në Mjedis si më poshtë:

- 1) Hartimi i një strategjie për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve urbane, ku përfshihet plotësimi i kuadrit ligjor dhe projekte demonstrimi në këtë fushë;
- 2) Stabilizimi i administrimit urban, duke përfshirë gjithashtu edhe menaxhimin e mbetjeve urbane;
- 3) Hartimi i një programi për mbylljen e sigurt të vend-grumbullimeve ekzistuese të plehrave, që paraqesin rrezik për shëndetin dhe mjedisin, si dhe ndërtimin e fushave të grumbullimit të mbeturinave, bazuar në kriteret mjedisore;
- 4) Ndërgjegjësimi i publikut lidhur me mirë-menaxhimin e mbetjeve urbane.

Në zbatim të legjislacionit mjedisor, Ligjit Nr. 9010, date 13.02.2003, “ Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta ”, Ligjit Nr. 8652, datë 31.07.2000, “ Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore ”, si edhe në bazë të konkluzioneve të një serie aktiviteteve ( konferenca, seminare, takime të tjera pune në nivel qendror apo lokal), që kanë trajtuar probleme të menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri, platforma për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane kërkon:

1) Ngritjen e një organi koordinues për administrimin e mbetjeve të ngurta, me përfaqësues të institucioneve qendrore dhe të organeve të qeverisjes vendore;

2) Hartimin dhe zbatimin e Planit Kombëtar për Administrimin e Mbetjeve të Ngurta Urbane;

3) Përcaktimin e metodologjisë për trajtimin mjedisor të mbetjeve, në përputhje me natyrën dhe llojin e tyre;

4) Sigurimin dhe përdorimin e efektshëm të mjeteve financiare për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta urbane;

5) Kontrollin e vazhdueshëm mbi veprimtaritë që krijojnë mbetje, si edhe mbi ata që angazhohen në transportimin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin e tyre në fushat e sektorët që mbulohen nga ana e Inspektoratit të Mjedisit, Inspektoratit Sanitar, organit që ka liçensuar veprimtarinë, si edhe organet e qeverisjes vendore të zonës, ku zhvillohet veprimtaria;

6) Hartimin, miratimin dhe zbatimin e rregulloreve tip për përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve të ngurta urbane, të ndërtimit, të mbetjeve të vëllimshme, të mbetjeve industriale dhe atyre të minierave, bashke me kriteret dhe rregullat për instalimin e impianteve të përpunimit të tyre, të trajtimit të mbetjeve bujqësore e blegtorale, si edhe të mbetjeve spitalore, bashkë me kriteret dhe rregullat për instalimin dhe funksionimin e impianteve të djegies së tyre;

7) Hartimin, miratimin dhe zbatimin e aktit nënligjor për administrimin e mbetjeve të ngurta urbane në pikat e kalimit ndërkufitar;

8) Hartimin, miratimin dhe zbatimin e rregulloreve për monitorimin e mbetjeve të ngurta urbane;

9) Hartimin, miratimin dhe zbatimin e aktit nënligjor për rehabilitimin e vend-grumbullimeve industriale ekzistuese;

10) Sqarimin e kompetencave dhe përgjegjësi në rastin e mbetjeve të depozituara ilegalisht gjatë segmenteve të rrugëve nacionale, me qëllim asgjësimin e tyre dhe ndalimin e depozitimeve të tjera në të ardhmen;

11) Përcaktimin me të mirë të përgjegjësive dhe kompetencave të organeve qendrore të përfshira në administrimin e mbetjeve të ngurta urbane;

12) Ngritjen e një rrjeti për të lehtësuar komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit midis specialistëve përgjegjës në institucionet qendrore dhe vendore;

13) Informimin e donatorëve, bashkëpunimin me to dhe trajnimin e specialisteve, për të aplikuar për projekte në nivel qarku, bashkie apo komune;

14) Rritjen e bashkëpunimit me OJF-të që janë të përfshira në fushën e administrimit të mbetjeve urbane dhe të ndërgjegjësimit të publikut.

#### **3.2.4. DIMENSIONI LOKAL I PROBLEMIT**

Organet e qeverisjes vendore, të ngarkuara me detyra dhe kompetenca në fushën e administrimit të mbetjeve të ngurta urbane, duhet të marrin masa për të:

1) Rritur ndërgjegjësimin në të gjitha nivelet, duke filluar nga drejtuesit e institucioneve deri te qytetarët e thjeshtë dhe duke përfshirë gjithnjë e më shumë median, edukimin në shkolla, trajnimin e personave përgjegjës në çdo qark, bashki e komunë etj., me qëllim që administrimi i mbetjeve të kthehet në çështje prioritare;

2) Caktuar në nivel qarku, bashkie e komune të paktën një specialist për problemet e administrimit të mbetjeve urbane;

3) Përgatitur raportin e gjendjes dhe administrimit të mbetjeve në shkallë njësisish të qeverisjes vendore;

4) Hartuar dhe zbatuar planet vendore për administrimin e mbetjeve të ngurta, si pjesë të planeve lokale të veprimit në mjedis (qarqet, bashkitë, komunat), me qëllim që nevojat e studiuara (për fonde dhe burime njerëzore) të përfshihen në buxhetin respektiv dhe fondet e siguruara të përdoren për pastrimin, transportin dhe depozitimin e siguritë të mbetjeve të ngurta në shkallë vendore;

5) Studiuar dhe zbatuar skema tarifore të efektshme në shkallë vendore, për të mbuluar një pjesë të konsiderueshme të kostos për pastrimin, transportimin dhe depozitimin e sigurtë të mbetjeve të ngurta;

6) Studiuar, projektuar dhe thithur fonde (përmes hartimit dhe zbatimit të projekteve përkatëse) për ndërtimin e vend-depozitimeve të sigurta (landfilleve) të të gjitha niveleve dhe mundësisht në shkallë qarku;

7) Kryer të gjitha procedurat për miratimin e vendit për depozitimin e mbetjeve të ngurta, në përputhje me studimet e kryera dhe duke respektuar mendimin e komunitetit;

8) Rehabilituar deri në mbyllje vend-depozitimet ekzistuese, në raste të identifikimit të problemeve mjedisore të shkaktuara prej tyre;

9) Hartuar rregulloret lokale, mbi bazën e rregulloreve tip të miratuara për ndarjen e mbetjeve sipas klasifikimit të miratuar, riciklimin dhe përdorimin e tyre, kompostimin, groposjen dhe djegien në impiante të veçanta të mbetjeve urbane;

10) Siguruar kontrollin mbi zotëruesit e mbetjeve, me qëllim që ata vetë, me shpenzimet e tyre, të sigurojnë grumbullimin, transportin, ruajtjen, përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve të gjeneruara prej tyre;

11) Disiplinuar tregjet për depozitimin e mbetjeve tregtare;

12) Rishikuar sistemin e gjobave për ndotësit publikë të mjedisit;

13) Përcaktuar vendet për grumbullimin e mbetjeve inerte;

14) Shtrirë shërbimin e pastrimit edhe në zonat periferike;

15) Modeluar dhe vendosur kosha rrugore, të paktën për parqet apo sheshet kryesore;

16) Hartuar dhe zbatuar projekte pilot për ndarjen e mbetjeve që në burim;

17) Kontrolluar zbatimin e kushteve në lejet mjedisore dhe në kontratat e pastrimit të qyteteve;

18) Hartuar dhe zbatuar planet e veprimit dhe marrjen e masave të posaçme për pastrimin e plazheve nga mbetjet e ngurta, për përmirësimin e gjendjes në qarqet e zonave bregdetare.

### **3.2.5. RAST KONKRET PËR ANALIZIMIN E PROBLEMIT:**

#### **MENAXHIMI I MBETJEVE TË NGURTA URBANE NË VLORË**

##### ***Pozimi i problemit***

Qyteti i Vlorës ka një sipërfaqe rreth 1609 km<sup>2</sup> dhe një popullsi prej 110,000 banorë. Popullsia është rritur në mënyrë të konsiderueshme gjatë 10-12 viteve të fundit, në sajë të fenomenit të migrimit nga zonat rurale përreth, si edhe nga zona të tjera të vendit. Rritja e popullsisë është shoqëruar nga ana tjetër me rëndimin e situatës lidhur me menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane dhe, më specifikisht, lidhur me gjetjen e mundësive për asgjësimin e mbetjeve, pa shkaktuar dëm në shëndetin e popullatës dhe mjedisin përreth.

Aktualisht, mbetjet urbane në qytetin e Vlorës asgjësohen në një fushë të hapur plehrash, në varësi të organeve të pushtetit vendor. Kjo fushë plehrash, rreth 2 km në perëndim të qendrës së qytetit, është në funksionim që prej vitit 1970, nuk ka kapacitetin e duhur për të përballuar sasinë në rritje të mbetjeve urbane dhe, meqenëse është projektuar pa marrë në konsideratë mbrojtjen e mjedisit, nuk ka sistem për grumbullimin e ujërave të perkolatit. Përpara viteve 90', fusha konsiderohej zonë periferike, ndërsa sot banorët përreth i kanë shtëpitë vetëm 10-20 m larg saj.

Për pasojë, kontaminimi i mundshëm nga kjo fushë plehrash përben një kërcënim të vazhdueshëm në rritje për mjedisin përreth dhe shëndetin e qytetarëve.

Mbetjet që shkojnë në fushën e plehrave për t'u asgjësuar janë me natyrë shtëpiake, të tregtisë, të institucioneve, të pastrimit të rrugëve dhe të qytetit në përgjithësi, nga sektori i ndërtimit, i shëndetësisë dhe i industrisë. Në total, sasia ditore e dërguar në fushën e plehrave është rreth 102 ton, e rritur rreth tre herë në raport me vitin 1990. Sa lidhet me përbërjen e mbetjeve urbane, pjesën më të madhe e zë lënda organike, e ndjekur nga dhera dhe të tjera lëndë të dekompozueshme.

Një pjesë e këtyre mbetjeve digjen, në kundërshtim me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore, duke prodhuar një ndotje të konsiderueshme të ajrit për të gjithë rajonin.

Sistemi aktual i grumbullimit dhe i transportimit të mbetjeve për në vend-depozitim nuk ka ndryshuar që prej vitit 1990 dhe për pasojë është i papërshtatshëm. Në Vlorë ka rreth 600 vende të miratuara për grumbullimin e plehrave, me rreth 500 kontenierë metalikë, bashkë me rreth 100 kontenierë të hapur çimentoje, të cilët normalisht mbushen dhe nuk mjaftojnë për sasinë ditore të plehrave të gjeneruara.

Nga ana tjetër, zonat periferike janë të pambuluara me kontenierë, duke përfshirë edhe popullsinë që banon afër fushës së plehrave. Më pas plehrat transportohen në vend-depozitim një herë në ditë, me makina jo të përshtatshme, apo edhe me karroca të tërhequra me kafshë. Kur kontenierët nuk zbrazen plotësisht dhe vendi përreth nuk pastrohet, era që vjen, si pasojë e fermentimit të tyre, përben një shqetësim konstant për banorët. Ky është një rast tipik, sa kohë që menaxhimi i mbetjeve urbane vuan nga mungesa e organizimit, sidomos afër qendrave tregtare, ku edhe sasia ditore e mbetjeve të gjeneruara është më e madhe.

Grumbullimi, transportimi dhe depozitimi i mbetjeve urbane në Vlorë kryhet nga një kompani private e kontraktuar nga Bashkia, e cila me mjetet, teknologjinë dhe personelin në dispozicion nuk arrin të mbulojë të gjitha nevojat e qytetit. Ky proces mbikëqyret nga Bashkia e cila jep edhe fondet për pastrimin e qytetit dhe menaxhimin

e mbetjeve. Në fushën e plehrave mbetjet nuk i nënshtrohen ndonjë seleksionimi paraprak. Ato kompaktohen të gjitha së bashku dhe në raste të rralla i nënshtrohen ndonjë dezinfektimi me gëlqere.

Në fushën e plehrave nuk ka sisteme drenazhimi apo kontrolli të biogazit të gjeneruar. Për më tepër kanali kryesor i ujërave të ndotura të qytetit të Vlorës kalon përmes fushës së plehrave, e cila është e ndërtuar në një zonë ranore, në nivel të ulët në krahasim me

nivelin e detit, duke përbërë edhe një zgjidhje jo të gjetur në lidhje me shtresat gjeologjike. Ndotja e identifikuar në zonë lidhet me cilësinë e përkeqësuar të ajrit dhe të ujërave. Problemi rëndohet nga prania e banorëve përreth, jetesa e të cilëve bazohet në aktivitetin bujqësor dhe në përdorimin e ujit të puseve për ujë të pijshëm.

### ***Rekomandime për zgjidhjen e problemit***

Ndërsa Vlora rritet dhe ndryshon aktivitetin ekonomik, ekziston nevoja për të ndryshuar edhe sistemin aktual të menaxhimit të mbetjeve urbane. Situata aktuale jashtë kontrollit dhe afër qendrës së qytetit, jo vetëm që ka një ndikim negativ në shëndetin e banoreve dhe mjedisit përreth, por ndikon negativisht edhe në përparimin ekonomik të Vlorës.

Për pasojë, shtrohet domosdoshmëria e gjetjes së një tjetër vendi për asgjësimin e mbetjeve urbane dhe e hartimit të një plani afatgjatë menaxhimi për mbetjet e ngurta të qytetit, që të mund të zgjidhet ky problem për të paktën 15 vitet e ardhme.

#### **1. Përzgjedhja e vendit të ri të depozitimit të mbetjeve urbane**

Një listë prej të paktën 10 vendesh potenciale duhet të sigurohet nga një studim paraprak, i porositur nga Bashkia e qytetit.

Më pas këto 10 vende duhet t'i nënshtrohen një analize multikriteriale, që merr në konsiderate largësinë nga qendrat e banuara, faktorët natyrorë (gjeologjinë, drenazhimin, florën dhe faunën), faktorët kulturorë, aksesin e këtyre vendeve nga rrugët që i lidhin me Vlorën dhe koston e përlogaritur të ndërtimit të vend-

depozitimit. Pronësia mbi tokën dhe gatishmëria e banorëve përreth vendit të zgjedhur përbën një prej faktorëve më të rëndësishëm në përzgjedhjen e vendit.

Nga kjo listë prej të paktën 10 vendesh, tre më të mundshmet duhen seleksionuar në raundin e parë, të cilat do t'i nënshtrohen më pas një studimi edhe më të hollësishëm, që merr në konsideratë edhe hartimin e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis për secilën prej tyre dhe konsultimin e vazhdueshëm me banorët që jetojnë pranë vendit të përzgjedhur. Sa më lart, kjo do të çojë në vendin potencial për ndërtimin sipas të gjitha kriterëve të vend-depozitimit të ri të mbetjeve të ngurta urbane.

Ky vend-depozitim, në përputhje me konkluzionet e studimeve kombëtare në këtë fushë, të porositura nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, duhet të ndërtohet me teknologjinë përkatëse, me ndikim minimal në shëndet dhe në mjedis. Zona e përzgjedhur më pas duhet të miratohet nga organet përkatëse të qeverisjes vendore, të cilat njëkohësisht kryejnë edhe punën për gjetjen e fondeve për ndërtimin e tij.

## 2. Plani i menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta

Ky plan duhet të hartohet nga organet e qeverisjes vendore, në përputhje me udhëzimet e dala për këtë qëllim nga organet qendrore të caktuara me përgjegjësinë e hartimit të politikave kombëtare për menaxhimin e mbetjeve urbane. Plani duhet t'i shërbejë menaxhimit të mbetjeve për popullsinë aktuale dhe atë të parashikuar për Vlorën në njëzet vitet e ardhme. Në vazhdim jepen elementët e këtij plani:

- Sigurimi i të dhënave bazë për popullsinë aktuale dhe të pritshme në Vlorë, si edhe për gjenerimin specifik të mbetjeve për banor në ditë, aktual dhe të pritshëm, me qëllim projektimin e skemës së grumbullimit dhe transportimit dhe të parametrave të vend-grumbullimit të ardhshëm të mbetjeve të ngurta urbane;



- Studimin paraprak të mundësive për riciklim, kompostim, trajtim paraprak të mbetjeve të ngurta urbane, që do të shoqërohej me reduktimin e mbetjeve për t'u asgjësuar në vend-depozitim;

- Përlllogaritja e kostove për secilën fazë të administrimit të mbetjeve të ngurta urbane, që nga gjenerimi deri te asgjësimi i tyre në vend-grumbullim;

- Vlerësimi i potencialit të Bashkisë ( burime njerëzore dhe financiare) për administrimin si duhet të mbetjeve urbane dhe planifikimi i tyre në buxhet për vitet që vijnë në përputhje me koston e përlllogaritur;

- Studimi, hartimi, diskutimi me të gjithë të interesuarit dhe miratimi i një skeme të pranueshme tarifore për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane;

- Studimi i nevojave dhe hartimi i të gjitha akteve në nivel bashkiak dhe në zbatim të legjislacionit kombëtar në këtë fushë, që mundëson zbatimin e të gjitha elementeve të këtij plani;

- Bashkëpunimi me strukturat qendrore dhe donatorët për gjetjen e fondeve për realizimin e elementëve përkatës të planit të hartuar/miratuar nga Bashkia;

- Studimi i mundësive për mbylljen e sigurtë të fushës aktuale të plehrave në Vlorë.

## **KONTROLLI DHE PARANDALIMI I NDOTJES SË UJËRAVE**

Shqipëria është e pasur në rezerva ujore, përfshirë këtu lumenjtë, liqenet dhe lagunat, detet dhe ujërat nëntokësore. Rrjeti hidrografik është mjaft kompleks, i shpërndarë në tërë territorin dhe me rezerva të bollshme, si dhe mbulon rreth 43,305 km<sup>2</sup>. Gjithsej janë gjashtë basene kryesore lumore, të cilat shtrihen edhe jashtë kufijve të vendit. Këto përfshijnë edhe katër liqene dhe tre rezervuare të mëdhenj. Në total, rezervat ujore të Shqipërisë llogariten rreth 13,300m<sup>3</sup> për person në vit. Burimet ujore përdoren për nevoja urbane, industriale, për sektorin bujqësor si edhe për prodhim hidro - energjie.

Shqipëria është gjithashtu e pasur me burime ujore nëntokësore, me një potencial prej 1,250 milion m<sup>3</sup> në vit në shtatë pellgje gjeologjike kryesore.

Kontrolli dhe parandalimi i ndotjes së ujërave përbën një sfidë për organet qendrore dhe vendore, të cilat ndihmojnë dhe kontrollojnë procesin e trajtimit mjedisor të ujërave të ndotura dhe mbrojnë mjediset ujore të Republikës së Shqipërisë nga ndotjet dhe dëmtimet e shkaktuara nga veprimtaria njerëzore.

Mbrojtja e ujit përfshin ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, burimet e tyre, sasinë dhe cilësinë, shtretërit dhe brigjet e ujërave sipërfaqësore dhe formimet akuifere.

### **3.3.1. SITUATA AKTUALE**

Cilësia e ujërave, si një parametër shumë i rëndësishëm dhe i lidhur ngushtë me shëndetin e njeriut, florën, faunën dhe zhvillimin normal të aktiviteteve ekonomike në mjediset ujore, përcaktohet përmes monitorimit fiziko - kimik dhe bakteriologjik të tyre, të kryer mbi baza vjetore nga institucionet përgjegjëse si Instituti i Shëndetit Publik, Instituti i Hidrometeorologjisë, Instituti i Mjedisit, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar e të tjera institucione. Monitorimi i ujërave dëshmon se ujërat sipërfaqësore janë pjesërisht të ndotur.

Në aspektin cilësor, ndonëse vlerësohet një pakësim i ndotjes nga aktivitete industriale dhe bujqësore, si rrjedhojë e mbylljes së mjaft aktiviteteve industriale pas vitit 1991 dhe rënies së prodhimit

bujqësor në përgjithësi, është shtuar ndotja urbane, si rrjedhojë e migrimit të popullsisë nga zonat rurale drejt qyteteve.

Si faktorë kryesorë të ndotjes vlerësohen:

- Ujërat e ndotura urbane, të shkarkuara direkt në ujërat sipërfaqësore pa u trajtuar;
- Ujërat e ndotura industriale dhe ujërat e shkarkuara nga sektori i bujqësisë.

Ndotja historike industriale gjithashtu vazhdon të mbetet një faktor konstant në prishjen e cilësisë së ujërave sipërfaqësore / nëntokësore.

Në lidhje me shkarkimet e ujërave të ndotura urbane situata është kritike.

Kjo sepse akoma mungon gati plotësisht infrastruktura e grumbullimit dhe e trajtimit të tyre, duke përfunduar në shkarkime direkte në ujëra sipërfaqësore dhe në dete, pa kurrfarë trajtimi fillestar.

Kjo edhe pse popullsia është rritur në mënyrë të ndjeshme sidomos në qytete të mëdha si Tiranë, Durrës etj. Situata vështirësohet akoma më shumë në zonën bregdetare, ku rritja e madhe e strukturave turistike ( veçanërisht në zonat e plazheve nga Velipoja në Sarandë) nuk është shoqëruar me masat respektive për menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe trajtimin e ujërave të zeza.

Nga ana tjetër, mungesa e metodave të përshtatshme të asgjësimit/depozitimit të mbetjeve të ngurta ka rritur mjaft tryshinë e këtij sektori mbi cilësinë e ujërave sipërfaqësore (lumenjtë që kalojnë pranë vend-depozitimeve të mbetjeve dhe infiltrimet e ujërave të perkolatit në ujërat nëntokësore të zonës).

Ndotja e ujërave sipërfaqësore nga veprimtaritë bujqësore dhe blegtorale është një dukuri që po shtohet krahas zhvillimeve në këtë sektor. Megjithatë, aktualisht nuk ekziston një program monitorimi apo vlerësimi për potencialin ndotës në trupat ujore nga ky sektor.

Industria është një kontribues në rritje i shkarkimeve ndotëse në ujrat sipërfaqësore. Më parë ujërat kishin ndotje të rënda nga prodhimi i plehrave azotike dhe fosfatike, sodës dhe kimikateve të tjera, impiantit të metalurgikut, prodhimit të çimentos dhe industrisë së drurit dhe letrës. Tani shumë nga këto industri nuk funksionojnë. Ndotja më e evidente vjen nga industria ushqimore, ajo e materialeve të ndërtimit dhe e lëkurëve. Shumica e këtyre aplikojnë teknologji të vjetër, gjë që do të thotë se nuk i trajtojnë shkarkimet përkatëse.

Si rezultat, shumë lumenj tregojnë një deficit në oksigjen, me një kërkesë të lartë kimike për oksigjen (NKO) dhe kërkesë biologjike për oksigjen (NBO), vlerat e të cilave përcaktojnë ndotjen nga materialet organike, shpesh me origjinë shtëpiake. Lumenjtë më të ndotur në vend janë: Semani, Gjanica, Erzeni dhe Lumi i Tiranës. Këta lumenj përmbajnë përqendrime të larta fenolësh (0.98-3.90 mg/l).

Gjithashtu, në konkluzionet e monitorimeve vjetore të ujërave bregdetare, evidentohet fakti se, për shkak se të gjitha ujërat urbane të vendit tonë shkarkohen pa asnjë lloj trajtimi paraprak, vërehet një ndotje bakteriologjike mjaft e lartë e ujërave sipërfaqësore dhe bregdetare, sidomos në zonat pas shkarkimeve urbane. Më e theksuar kjo ndotje është e shprehur në zonën e shkarkimeve pas hidroforëve dhe stacioneve të pompimit në Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë dhe Sarandë.

### **3.3.2. LEGJISLACIONI SPECIFIK**

Në fushën e administrimit të burimeve ujore vepron një paketë e tërë ligjore, në përbërje të së cilës renditen sa më poshtë:

1) Ligji Nr. 8093/ 1996, “Për rezervat ujore”, i cili është ligji kryesor për sa i takon administrimit të burimeve ujore. Ligji parashikon mbrojtjen dhe përdorimin me kriter dhe të qëndrueshëm të rezervave ujore dhe organizon menaxhimin dhe administrimin e rezervave ujore nga këshillat e baseneve ujore;

2) Ligji Nr. 8102/1996, “Për shpërndarjen e ujit dhe rregullimin në sektorin e sanitimit”, i cili ka të bëjë me sigurinë e

shëndetit si rezultat i shpërndarjes së sigurt të ujit të pijshëm dhe trajtimit të ujërave shtëpiake;

3) Ligji Nr. 7846/1994, “Për ndërtimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe operacionet në sistemet e vaditjes dhe drenazhimit”, i cili rregulon veprimtarinë e përdorimit të ujit në sektorin e bujqësisë;

4) Ligji Nr. 8934, datë 05.09.2002, “Për mbrojtjen e mjedisit” i cili mbron përbërësit e mjedisit dhe proceset mjedisore, siguron kushtet materiale për zhvillimin e qëndrueshëm, duke plotësuar kuadrin e nevojshëm për zbatimin e kërkesës kushtetuese për një mjedis ekologjikisht të pastër. Sipas këtij ligji, mbrojtja e ujit përfshin ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, burimet e tyre, sasinë, cilësinë, shtretërit dhe brigjet e ujërave sipërfaqësore dhe formimet akuifere.

Po sipas këtij ligji, mbrojtja e ujit siguron parandalimin e dëmtimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe tejkalimin e normave respektive të cilësisë, përmirësimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësore të ndotura dhe arritjen e cilësisë së ujit, parandalimin e shkatërrimit të cilësisë së ujërave nëntokësore, rehabilitimin e ujërave nëntokësore të ndotura, përmirësimin e bilancit ndërmjet shkallës së ekstraktimit dhe ripërtëritjes natyrore të ujërave nëntokësore, si edhe mbrojtjen e florës dhe të faunës ujore;

5) Ligji Nr. 8652/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i cili i jep qeverisjes vendore fuqi të plotë administrimi, shërbimi, investimi dhe rregullimi për sistemin e shpërndarjes së ujit, të grumbullimit dhe të drenazhimit të tij;

6) Ligji Nr. 9115/2003, “Mbi trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, i cili ka për qëllim të mbrojë mjedisin dhe shëndetin e njeriut nga ndikimet negative të ujërave të ndotura, duke përcaktuar rregullat e trajtimit mjedisor të tyre, si edhe detyrimet e shkarkuesve të ujërave të ndotura.

Sipas këtij ligji, organet shtetërore, qendrore dhe vendore kanë për detyrë të bashkëpunojnë me Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për:

- Përcaktimin e teknikave dhe metodave më të mira për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura;
- Hartimin e planeve për trajtimin e ujërave të ndotura në mënyrë të integruar;
- Krijimin e kuadrit ligjor dhe institucional;
- Sigurimin dhe përdorimin e frytshëm të mjeteve të nevojshme financiare;
- Kontrollin a vazhdueshëm të veprimtarive që shkaktojnë ndotje të ujërave.

Nga ana tjetër, personat fizikë dhe juridikë, veprimtaria e të cilëve shkarkon ujëra të ndotura, kanë për detyrë:

- Të ulin në vazhdimësi sasinë e ujërave të përdorura që shkarkojnë;
- Të pakësojnë shkallën e ndotjes së ujërave që shkarkojnë;
- Të administrojnë dhe trajtojnë ujërat që shkarkojnë, përmes ndërtimit dhe funksionimit të rrjetit të kanalizimeve, të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura, nxitjes së ripërdorimit të ujërave të trajtuara, zbatimit të normave të shkarkimeve të lëngëta;
- Të hartojnë dhe zbatojnë programin e masave, subjekt kontrolli më pas nga Inspektorati i Mjedisit.

Sipas të njëjtit ligj, në lejet mjedisore për veprimtaritë që shkarkojnë ujëra të ndotura, Ministria e Mjedisit përcakton edhe:

- Kushtet e veçanta për respektimin e normave të shkarkimeve të lëngëta;
- Kërkesat për ndërtimin e rrjetit të brendshëm të kanalizimeve;
- Kërkesat për trajtimin parësor të ujërave të ndotura;
- Masat për parandalimin e ndotjes së mjedisit;
- Kolektorin, ku duhet të shkarkohen ujërat e ndotura dhe rrëgjimin e shkarkimit të tyre;

- Mbajtjen e regjistrave përkatës;
- Kryerjen e vetë - monitorimit.

Ndërsa leja mjedisore për trajtuesit e ujërave të ndotura përmban:

- Kërkesat dhe kushtet e vendit të ndërtimit të impianteve dhe instalimeve për pastrimin e ujërave;
- Llojin e impiantit që do të përdorin;
- Metodikat, teknikat dhe teknologjitë që përdor impianti;
- Normat e lejuara që duhet të plotësojnë ujërat pas trajtimit;
- Mjedisin pritës, ku do të derdhen ujërat e pastruara;
- Kërkesat për trajtimin mjedisor të llumrave;
- Mbajtjen e regjistrave përkatës;
- Kryerjen e monitorimit dhe publikimin e rezultateve të tij.

Ligji “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura” përcakton si veprime të ndaluara:

- Shkarkimin në tokë ose sipërfaqe ujore të ujërave të ndotura që nuk plotësojnë normat e shkarkimeve;
- Trajtimin dhe pastrimin e ujërave jashtë vendeve të përcaktuara në lejen mjedisore për këtë qëllim, nga persona të palicensuar, ose me teknika dhe teknologji të papërshtatshme;
- Përzierjen me ujëra sipërfaqësore të shkarkimeve të lëngëta të vend-depozitimeve të mbetjeve;
- Përdorimin e ujërave të ndotura për çdo qëllim ose veprimtari tjetër.

**VKM Nr. 177, datë 31.03.2005, “Mbi normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritës ”:** Normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta, sipas këtij Vendimi, janë instrumenti kryesor që mbështetin zbatimin e Ligjit

“Për administrimin mjedisor të ujërave të ndotur”, që mundësojnë kontrollin e zbatimit të tij nga Inspektorati i Mjedisit dhe organet e tjera të ngarkuara me parandalimin e ndotjes së ujërave sipërfaqësore për shkak të derdhjes në to të ujërave të ndotura urbane dhe industriale.

Sipas VKM-së së mësipërme, veprimtaritë e reja industriale do të respektojnë kërkesat e tij që nga dita që do të fillojnë aktivitetin. Ato nuk pajisen me leje mjedisore, nëse nuk kanë të instaluar paraprakisht impiantin e trajtimit të ujërave që ndotin.

Për veprimtaritë ekzistuese, është parashikuar një kohë prej pesë vjetësh për marrjen e masave për respektimin e normave të lejuara të shkarkimeve sipas këtij vendimi.

Ndërkohë, për shkarkimet e lëngëta urbane, koha për t'u përgatitur për respektimin e normave sipas këtij vendimi është parashikuar të jetë 8 vjet, sepse do të duhet të rikonstruktohen e të ndërtohen kanalizimet, sistemet kolektorë, si dhe të ngrihen impiantet e trajtimit të tyre, që mungojnë në vendin tonë.

VKM-ja parashikon pjesëmarrje aktive të Këshillave të Baseneve Ujëmbledhës në parandalimin dhe eliminimin e ndotjes së baseneve nën juridiksionin e tyre përmes përgatitjes, publikimit dhe zbatimit të programeve dyvjeçare, të cilat përfshijnë:

- Identifikimin e shkarkimeve të lëngëta dhe të mjedisve ujore pritëse që ndoten;
- Masat dhe teknikat më të mira të mundshme për zvogëlimin e ndotjes;
- Propozimet për zëvendësimin ose riciklimin e substancave të rrezikshme për veprimtaritë industriale përkatëse;
- Personat përgjegjës për zbatimin e kërkesave të programit;
- Kohën e zbatimit dhe monitorimin e procesit zbatues të tij.



### 3.3.3. PLATFORMA KOMBËTARE

Në zbatim të legjislacionit të mjedisit, platforma e mbrojtjes dhe përmirësimit të cilësisë së ujërave kërkon:

- 1) Zbatimin e legjislacionit mjedisor në përgjithësi dhe atij specifik në fushën e ujërave në veçanti;
- 2) Plotësimin e legjislacionit për mbrojtjen e ujërave me aktet nënligjore përkatëse dhe paralelisht me këtë, harmonizimin e tij me direktivat përkatëse të BE-së në fushën e ujërave, më të rëndësishmet ndër të cilat cilësohen: Direktiva Kuadër për Ujërat (2000/60/EC) dhe Direktiva për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane (91/271/EEC);
- 3) Rritjen e cilësisë së monitorimit të ujërave, si bazë për ndërtimin e planeve dhe strategjive sektoriale për mbrojtjen e cilësisë së ujërave (industria, bujqësia, sektori urban e të tjera);
- 4) Hartimi i projekt-propozimeve dhe tërheqja e donatorëve, veç fondeve të buxhetit të shtetit, për kompletimin e sistemeve të kanalizimeve të ujërave të ndotura urbane në shkallë vendi;
- 5) Hartimi i projekt-propozimeve dhe tërheqja e donatoreve, veç fondeve të buxhetit të shtetit, për ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura urbane në shkallë vendi, duke filluar me qytetet e zonës bregdetare;
- 6) Rritja e bashkëpunimit dhe bashkërendimi i punës midis organeve qendrore, përgjegjëse për menaxhimin e qëndrueshëm të ujërave, si edhe midis tyre dhe organeve të qeverisjes vendore për inventarizimin e burimeve ujore dhe hartimin/miratimin/zbatimin e planit kombëtar të menaxhimit të burimeve ujore mbi bazën e planeve respektive të baseneve ujëmbledhës;
- 7) Rritja e bashkëpunimit me vendet fqinje, në kuadër të marrëveshjeve mjedisore dypalëshe, shumëpalëshe dhe në rang ndërkombëtar, për mbrojtjen e ujërave në kontekstin ndërkufitar.

### 3.3.4. DIMENSIONI LOKAL I PROBLEMIT

Organet e qeverisjes vendore, të ngarkuara me detyra dhe kompetenca në fushën e menaxhimit të burimeve ujore, duhet të marrin masa për të:

➤ Fuqizuar strukturat përkatëse në shkallë vendore dhe bashkëpunimin e tyre me Këshillat e Baseneve Ujëmbledhës dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit, me qëllim që të përgatisin, publikojnë dhe zbatojnë programet dyvjeçare, ku do të përfshihen:

✓ Identifikimi i burimit të shkarkimeve të lëngëta dhe i mjediseve ujore pritëse që ndoten;

✓ Masat dhe teknikat më të mira të mundshme për zvogëlimin e ndotjes;

✓ Propozimet për zëvendësimin ose riciklimin e substancave të rrezikshme, për veprimtaritë industriale që shkarkojnë në basenet ujëmbledhës përkatës;

✓ Personat përgjegjës për zbatimin e kërkesave të programit;

✓ Kohën e zbatimit dhe monitorimit të procesit zbatues të tij.

➤ Për të ndaluar veprimtaritë ndotëse industriale në qarqet/bashkitë/komunat përkatëse që shkarkojnë ujëra të ndotura tej normave të lejuara;

➤ Për të ndaluar ndërtimet turistike dhe ato urbane pa infrastrukturën përkatëse të ujësjellës - kanalizimeve;

➤ Për të kompletuar sistemin e kanalizimeve të ujërave të ndotura urbane;

➤ Për të projektuar dhe ndërtuar impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane.

**3.3.5. RAST KONKRET PËR ANALIZIMIN E PROBLEMIT:  
ADMINISTRIMI MJEDISOR I UJËRAVE  
NË BASHKINË E POGRADECIT DHE MBROJTJA E LIQENIT<sup>1</sup>**

***Pozimi i problemit***

Qyteti i Pogradecit ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme gjatë viteve të fundit, si pasojë e ndryshimeve politiko - ekonomike në vend. Popullsia është rritur, si pasojë e migrimit nga zonat rurale, duke e çuar numrin e banorëve që jetojnë në këtë qytet në rreth 38,000. Qyteti, duke përjashtuar zonën ekonomike, ndërtimet e parregullta në fushën e Buçimasit dhe ato të zonës periferike përgjatë rrugës kombëtare Pogradec-Korçë, shtrihet në një sipërfaqe të përgjithshme rreth 233.4 ha.

Sistemi i kanalizimit të qytetit është i shtrirë (përgjatë bregut 30-40%) me drejtim nga perëndimi në lindje, paralel me vijën e bregut. Ujërat e zeza të aksit kryesor pompohen nga tre stacione pompimi në një kanal që vuan nga infiltrimet dhe punon në gjendje mbingarkese, sidomos gjatë periudhës së shirave. Kjo ka sjellë që ujërat e ndotura të qytetit të derdhen direkt në liqen. Në zonën që nuk është e lidhur me sistemin e kanalizimeve, bëhet derdhja direkt e këtyre ujërave në përrenj dhe prej këtej në liqen.

Nga ana tjetër, gjendja e rrjeteve dhe e stacioneve të pompimit të ujërave të zeza është e rënduar për shkak të shkallës së lartë të amortizimit të tyre, si edhe shërbimit të pamjaftueshëm. Ndërmarrja e Ujësjiellës Kanalizimeve sh.a., Pogradec ka bërë një sërë pastrimesh në tubacionet kryesore dhe pesetat e kontrollit, me objektivin që, më pas, të funksionojë e gjithë skema, e cila kërkon ndërhyrje të plotë në stacionet e pompimit.

Për të mbrojtur cilësinë e ujit të liqenit, është vënë në zbatim Projekti i Menaxhimit të Ujit, Kanalizimeve dhe Drenazhimit (me fonde të përbashkëta të qeverisë Gjermane dhe Zvicëranë).

---

<sup>1</sup> Ky rast studimor i referohet Planit Lokal të Veprimit në Mjedis për Bashkinë e Pogradecit, përgatitur nga REC ( Qendra Rajonale e Mjedisit) dhe botuar më 2005.

Për shkak të sa më sipër, janë identifikuar:

- dëmtimi i florës dhe i faunës së liqenit, që shoqërohet me ulje të vlerave turistike rekreative të tij;
- dëmtimi i bregut të liqenit dhe rritja e rrezikshmërisë për sëmundje infektive;
- eutrofikimi i liqenit, për shkak të shkarkimit masiv të ujërave të zeza dhe përdorimit të detergjenteve me përbërje të lartë fosfori.

### ***Rekomandime për zgjidhjen e problemit***

Veç masave të rrepta për zbatimin e legjislacionit kombëtar në fushën e parandalimit dhe kontrollit të ndotjes së ujërave dhe nxjerrjes së akteve ligjore lokale, të domosdoshme për mbrojtjen e liqenit dhe të ujërave sipërfaqësore të zonës, për organet e qeverisjes vendore rekomandohet edhe:

- Ndërtimi i rrjetit të plotë të ujërave të zeza për të gjithë qytetin;
- Ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të zeza;
- Hartimi dhe zbatimi i planit dy-vjeçar për përmirësimin e cilësisë së ujërave të zonës dhe me specifikisht të ujit të liqenit (nga Këshilli i Basenit dhe Agjencia Rajonale e Mjedisit);
- Organizimi i aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit të popullsisë lokale për mbrojtjen e ujërave.

### **MENAXHIMI I NDOTJES SË AJRIT**

Mbrojtja e ajrit siguron mbrojtjen e shëndetit të njeriut, të kafshëve dhe të bimëve, bashkësive dhe habitateve të tyre, vlerat natyrore dhe kulturore, nga ndikimet negative të ajrit të ndotur, parandalimin e dëmtimit dhe kërcënimit të shoqërisë nga cilësia e

përkeqësuar e ajrit atmosferik, mbrojtjen e cilësisë së ajrit në zonat ku nuk është i dëmtuar dhe përmirësimin e tij në zonat e tjera.

### **3.4.1. SITUATA AKTUALE**

Ndotja e ajrit pati një rënie të theksuar mbas ndryshimeve politike në fillim të viteve '90, si pasojë e mbylljes së aktiviteteve industriale më të rëndësishme të vendit që ishin njëkohësisht edhe burimet më potenciale të emetimit të ndotësave në ajër. Paralelisht me këtë fenomen lindi dhe u zhvillua një problem i ri mjedisor, ai i ndotjes në rritje të ajrit urban, kryesisht nga shkarkimet e automjeteve, aktivitetet e ndërtimit dhe keqadministrimi i mbetjeve të ngurta.

1) Importimi gjatë 15 vjetëve të fundit i rreth 300,000 automjeteve, në pjesën dërmuese të përdorura, nga të cilët rreth 80% punojnë me naftë, si dhe cilësia e dobët e karburanteve të prodhuara në vend dhe të importuara, kanë shkaktuar një përkeqësim progresiv të cilësisë së ajrit urban në qytetet kryesore të vendit;

2) Faktor tjetër i ndotjes së ajrit janë edhe ndërtimet e shumta që nuk respektojnë kriteret për mbrojtjen e mjedisit, si edhe ndërhyrjet e paligjshme në territoret urbane e suburbane. Të dy aktivitetet që lidhen me industrinë e ndërtimit dhe trafikun rrugor pritet të rriten, duke u bashkëshoqëruar me ndotje të mëtejshme të ajrit, nëse nuk merren masa parandaluese;

3) Cilësia e rrugëve e problematikat që lidhen me shfrytëzimin, mirëmbajtjen e pamjaftueshmërinë e tyre dhe të parkimeve kontribuojnë në rritjen e sasisë së pluhurit dhe të shkarkimeve në ajër nga automjetet;

4) Mosrespektimi i kërkesave të vendosura në kontratat e firmave që pastrojnë qytetet është gjithashtu një shkak i përkeqësimit të cilësisë së ajrit;

5) Reduktimi i ndjeshëm i sipërfaqeve të gjelbëruara;

6) Një tjetër faktor ndotës lidhet me sektorin industrial (shkarkime përtej normave të lejuara, kryesisht në qytetet industriale si Elbasani, Fieri e të tjera).

Këto dukuri vihen re kryesisht në qytetet kryesore të vendit e në radhë të parë në kryeqytetin e vendit, Tiranë, në të cilin janë përqendruar aktivitetet e ndërtimit dhe të tjera, si edhe qarkullojnë çdo ditë rreth 100.000 automjete.

Ndonëse është e vështirë të flitet me shifra reale për burimet e sakta të ndotjes së ajrit në hapësirë, kohë dhe parametra, për shkak të mungesës së inventarit të shkarkimeve në ajër, të dhënat e monitorimit të cilësisë së ajrit të botuara në Raportet e Gjendjes së Mjedisit të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave tregojnë për një rritje progresive të përbërjeve ndotëse karakteristike për shkarkimet e automjeteve.

Tashmë treguesit e nivelit të ndotjes nga pluhuri dhe  $PM_{10}$ , për qytetin e Tiranës, janë gjetur disa herë më të larta se limitet e lejuara për cilësinë e ajrit urban, sipas legjislacionit shqiptar të vitit 2003, (VKM Nr. 803, datë 04.12.2003, “Për Normat e Cilësisë së Ajrit”). Pranë limitit të lejuar janë edhe tregues të tjerë të ndotjes si  $NO_x$  dhe Ozoni. Një situatë e ngjashme është edhe në qytete të tjera kryesore të vendit si Elbasani, Durrësi, Fieri, dhe Vlora.

### **3.4.2. LEGJISLACIONI SPECIFIK**

Prapa faktorëve të sipërpërmendur e të përcaktuar si përgjegjës për ndotjen e ajrit, qëndrojnë fusha veprimtarie të trajtuara e të mbuluara me legjislacion specifik, tërësia e të cilëve përbën kuadrin ligjor rregullator për mbrojtjen e ajrit.

Më poshtë është trajtuar vetëm kuadri ligjor mjedisor për mbrojtjen e ajrit, i cili është relativisht i ri dhe, si i tillë, ndikimet e tij pozitive në ruajtjen e ajrit janë akoma modeste. Kjo edhe për faktin e njohur se ai përcaktohet si legjislacion shumë teknik e profesional dhe nga ana tjetër zbatimi i tij përfaqëson një poçes që përmbledh shumë veprimtari e masa konkrete e me kosto të lartë.

Legjislacioni i ri mjedisor për mbrojtjen e ajrit përbëhet nga:

- 1) Ligji nr.8934, datë 5.09.2002, “Për mbrojtjen e Mjedisit”;
- 2) Ligji nr.8897, datë 16.05.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”;

3) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.435, datë 12.09.2002, “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër”;

4) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.248, datë 24.04.2003, “Për miratimin e normave të përkohshme të shkarkimeve në ajër”;

5) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.803, datë 04.12.2003, “Për normat e cilësisë së ajrit”;

6) VKM nr. 103, datë 31.03.2002, “Për monitorimin e mjedisit në RSH”;

7) Udhëzimi nr. 6527, datë 24.12.2004, “Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis, nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave, shkaktuar nga mjetet rrugore dhe mënyrat e kontrollit të tyre”, i cili ka hyrë në fuqi në fillim të muajit qershor të vitit 2005;

8) Rregullorja e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave e vitit 2006, “Për parandalimin e ndikimeve negative në shëndet e në mjedis të veprimtarive ndërtimore”;

9) Urdhër i Ministrit të Mjedisit nr. 37, datë 29.03.2004, “Për realizimin e vetmonitorimit”,

Hartimi dhe miratimi i këtij legjislacioni ka plotësuar një boshllëk të ndjeshëm në legjislacionin mjedisor, jo vetëm se tani kemi një kuadër ligjor të veçantë për mbrojtjen e ajrit, por edhe sepse ai përpunoi koncepte e kategori specifike të fushës dhe futi në përdorim terminologjinë e nevojshme juridike; hartoi dhe vuri në përdorim normat e shkarkimeve dhe të cilësisë së ajrit, pa të cilat as që mund të flitet për mbrojtje efektive të pastërtisë së ajrit.

Po kështu, ai grupoi veprimtaritë ndotëse mbështetur në kritere bashkëkohore; saktësoi detyrat e operatorëve, veprimtaritë e të cilëve gjenerojnë shkarkime në ajër; avancoi konceptet dhe praktikat për monitorimin e cilësisë së ajrit e të shkarkimeve në të; riformuloi rolet e përgjegjësitë e organeve shtetërore e të kontrollit për zbatimin e kërkesave të ligjit. Dhe të gjitha këto janë njëherësh edhe tregues konkretë të përafrimit të tij me legjislacionin përkatës të BE-së.

Gjithsesi, hartimi dhe vënia në zbatim e këtij legjislacioni është vetëm fillimi në vargun e angazhimeve për të krijuar një kuadër të

plotë ligjor mjedisor për mbrojtjen e ajrit, i cili të jetë edhe plotësisht i përputhur me direktivat e BE. Në këtë këndvështrim, aktualisht ai është në proces aktiv plotësimesh e përmirësimesh, që shfaqen në disa drejtime dhe kanë të bëjnë:

- Me plotësimin e kuadrit nënligjor rregullator;
- Me plotësime apo amendime të detyrueshme të akteve të veçanta, të identifikuara si të tilla gjatë zbatimit të këtij kuadri ligjor;
- Me thellimin e procesit të përafrimit të tij me direktivat përkatëse të BE-së;
- Me krijimin e infrastrukturës së domosdoshme që lehtëson zbatimin e këtij kuadri ligjor;

Në tërësinë e këtij kuadri ligjor për mbrojtjen e ajrit, më i drejtpërdrejt është pa dyshim Ligji Nr. 8897, datë 16.05.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, i cili ka për qëllim të garantojë të drejtën e shtetasve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit shqiptar nga ndotja e ajrit.

Ligji përcakton burimet e ndotjes (të palëvizshme dhe të lëvizshme), treguesit bazë të gjendjes së ajrit, normat e shkarkimeve në ajër (bashkë me normat e përkohshme të shkarkimeve), normat e cilësisë së ajrit, si edhe lartësitë e pajisjeve shkarkuese. Në ligj jepen gjithashtu:

- Detyrimet për mbrojtjen e ajrit të operatoreve të burimeve të palëvizshme, të cilët kanë për detyrë të zbatojnë kushtet teknike, të respektojnë normat e shkarkimeve në ajër, të përgatisin rregullore teknike për funksionimin e burimeve të ndotjes, të kryejnë monitorimin e shkarkimeve në ajër, të ndalin aktivitetin në rast avarie, të marrin masa për normalizimin e gjendjes, si edhe të njoftojnë publikun;
- Detyrimet për mbrojtjen e ajrit të operatorëve të burimeve të lëvizshme, të cilët detyrohen t’i përdorin dhe mirëmbajnë ato në përputhje me kushtet e përcaktuara nga prodhuesit dhe të respektojnë normat e shkarkimeve;



➤ Të gjithë operatorët që shkarkojnë ndotës në ajër, detyrohen të publikojnë të dhëna për ndotjen e ajrit dhe të dërgojnë periodikisht njoftim të plotë në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;

➤ Ministria e Mjedisit përgatit inventarin e shkarkimeve në ajër në nivel kombëtar, rrethi, qyteti dhe burimi individual ndotjeje;

➤ Personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, detyrohen të pajisen me leje mjedisore nga Ministria e Mjedisit në bashkëpunim me qeverisjen vendore për të gjitha aktivitetet me potencial ndotës për ajrin;

➤ Për ndotjen e ajrit, operatorët e burimit ndotës paguajnë taksë shkarkimesh, sipas sasisë dhe tipit të ndotësve të shkarkuar, sipas përcaktimeve në Ligjin Nr. 8435, datë 28.12.1998, “ Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë ”.

Në mënyrë që ligji të bëhet plotësisht funksional është e nevojshme që ai të plotësohet edhe me një sërë aktesh të tjera nënligjore, me anë të të cilave do të:

➤ miratohen edhe tregues të tjerë mjedisorë të gjendjes së ajrit për zona të veçanta dhe në varësi të natyrës së shkarkimeve në ajër;

➤ miratohen edhe burime të tjera të ndotjes, që mund të shfaqen;

➤ miratohen normat e cilësisë së ajrit, të depozitimit dhe normat specifike për zona të veçanta;

➤ miratohen kërkesat e cilësisë së lëndëve djegëse të detyrueshme për t’u zbatuar nga prodhuesit, importuesit, eksportuesit, transportuesit dhe tregtuesit;

➤ shpallen zonat që kërkojnë mbrojtje të veçantë të ajrit, për te cilat edhe Ministri i Mjedisit, i Shëndetësisë dhe organet përkatëse të qeverisjes vendore udhëzojnë masa të veçanta mbrojtëse;

➤ miratohen kriteret e ngritjes dhe të vënies në funksionim të sistemit paralajmërues për smogun;

- miratohen rregullat, procedurat dhe afatet e raportimit të gjendjes së ajrit në situatë smogu e të tjera.

### 3.4.3 PLATFORMA KOMBËTARE

Kjo platformë konsiston në disa aspekte:

#### ***Në fushën e monitorimit dhe të regjistrave të shkarkimeve në ajër:***

- Fuqizimi i rrjetit kombëtar të monitorimit të ajrit dhe hartimi i programit kombëtar të monitorimit, duke përcaktuar stacionet e monitorimit, parametrat, metodat, frekuencën e monitorimit dhe menaxhimin e të dhënave deri në publikim të tyre;
- Përmirësimi i pajisjeve laboratorike për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe matjen e shkarkimeve në ajër, bashkë me trajnimin e personelit teknik të angazhuar me monitorimin;
- Rishikimi i lejeve mjedisore për aktivitetet potencialisht ndotëse të ajrit, me qëllim futjen në to të kërkesave specifike për monitorim të shkarkimeve të tyre në ajër dhe raportimin pranë Agjencive Rajonale të Mjedisit;
- Hartimi, mirëmbajtja dhe botimi i regjistrave të shkarkimeve në ajër nga burimet kryesore stacionare të ndotjes.

#### ***Në fushën e transportit:***

- Riazhornimi dhe zbatimi i normave të lejuara të shkarkimeve nga mjetet e lëvizshme me Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrit të Mjedisit nr. 6527, datë 24.12.2004, në mbështetje të Ligjit Nr. 8897, datë 16.05.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”;
- Përgatitja e infrastrukturës së nevojshme për kontrollin periodik të mjeteve të transportit për shkarkimet në ajër sipas normave të lejuara dhe marrja e masave të nevojshme për trajnimin e stafit teknik.

- Marrja e masave për unifikimin e standardeve kombëtare me standardet evropiane për lëndët djegëse naftë dhe benzine të importuara për përdorim në automjete dhe zbatimimi i tyre nga strukturat përkatëse;
- Përgatitja e standardeve të reja lidhur me vajrat lubrifikante të importuara, konform parametrave cilësorë të vajrave që qarkullojnë në tregun evropian;
- Përgatitja dhe miratimi i akteve ligjore përkatëse që sanksionojnë përdorimin e karburanteve të vendit që nuk plotësojnë standardet e BE-së vetëm për traktorët bujqësorë, transportin detar, peshkimin dhe për ngrohje, duke minimizuar dhe shmangur nga tregu përdorimin e tyre nga mjetet e transportit rrugor;
- Zbatimi i Planit të Masave në mbështetje të Strategjisë Kombëtare të Energjisë për nxitjen e transportit publik;
- Aprovimi dhe zbatimi i rekomandimeve përkatëse lidhur me reduktimin e ndotjes nga sektori i transportit sipas dokumentit të Strategjisë Kombëtare të Mjedisit;
- Përgatitja dhe miratimi i Strategjisë Kombëtare për Transportin e Qëndrueshëm, që veç sa më lart do të konsiderojë rrugët dhe mjetet për promovimin e transportit publik dhe përdorimit të mjeteve të tjera shoqërore për mjedisin si biçikleta e të tjera.

### ***Masat fiskale***

Një seri masash duke ndërhyrë në Ligjin Nr.8977, datë 12.12.2002, "Për sistemin e taksave në RSH, ndryshuar me Ligjin Nr.9158, datë 18.12.2003", që synojnë drejt përmirësimit të strukturës së mjeteve të transportit me qëllim:

- Favorizimin e mjeteve të reja dhe që përdorin si lëndë djegëse benzinën, në raport me ato me naftë;
- Rritjen e detyrimeve fiskale mbi distributorët e mjeteve të përdorura dhe favorizimin e distributorëve të mjeteve të reja të transportit;

- Rendimin e tarifave fiskale për pajisjet dhe pjesët e këmbimit për mjetet e përdorura në raport me pajisjet dhe pjesët e këmbimit për mjetet e reja;
- Minimizimin me qëllim të heqjes nga përdorimi të gomave të përdorura, të cilat ndotin mjedisin dhe ndalimin e përdorimit të tyre për djegie;

***Në fushën e industrisë:***

- Respektimi i VKM Nr.435, datë 12.09.2002, “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”, për të gjitha burimet e reja stacionare të ndotjes së ajrit dhe respektimi i VKM Nr. 248, datë 24.04.2003, “Për miratimin e normave të përkohshme të shkarkimeve në ajër dhe zbatimin e tyre” për të gjitha burimet e ekzistuese stacionare të ndotjes së ajrit”;
- Respektimi i VKM Nr.103, date 31.03.2002, “Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë”;
- Përgatitja dhe zbatimi i Planit të Veprimeve në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Industrisë Joushqimore, sa lidhet me mbrojtjen e mjedisit dhe përkatësisht me mbrojtjen e cilësisë së ajrit.

***Në fushën e ndërtimit:***

- Rishikimi i ligjit të urbanistikës me qëllim evidentimin e elementeve të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm;
- Përmirësimi i rregullores së kantierëve të ndërtimit në drejtim të respektimit të normave për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja;
- Rishikimi i kompetencave të policisë ndërtimore dhe asaj bashkiake me qëllim rritjen e efektiviteteve të kontroleve në kantieret e ndërtimit;
- Rishikimi i normave në ndërtim lidhur me raportet midis sipërfaqes ndërtuese dhe sipërfaqeve të gjelbra në favor të këtyre të fundit.

#### 3.4.4. DIMENSIONI LOKAL I PROBLEMIT

Organet e qeverisjes vendore të ngarkuara me detyra dhe kompetenca në fushën e mbrojtjes së ajrit duhet të :

➤ Parashikojnë në organikat e tyre edhe një strukturë për mbrojtjen e mjedisit, me staf teknik të trajnuar për çështjet e mjedisit, midis të tjerave edhe për kontrollin dhe parandalimin e ndotjes së ajrit;

➤ Përgatisin Planet Lokale të Veprimit në Mjedis në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministrinë e Brendshme, me qëllim që të parashikojnë masat lidhur me:

- ✓ përmirësimin e kualitetit të rrugëve;
  - ✓ përmirësimin e qarkullimit rrugor për shmangien e fluksit të madh të makinave në qendër të njësive të tyre vendore, ku është e përqendruar dhe pjesa më e madhe e popullsisë;
  - ✓ hartimin dhe miratimin e rregulloreve që lidhen me parkimet e automjeteve;
  - ✓ hartimin dhe miratimin e rregulloreve që lidhen me lëvizjen e makinave që përdoren në sektorin e ndërtimit, me qëllim minimizimin e ndotjes që vjen si pasojë e tyre;
  - ✓ përmirësimin e cilësisë së ajrit nga të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari industriale në territoret që ata kanë nën juridiksion;
  - ✓ shndërrimin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis në një procedurë bazë të veprimtarisë parandaluese të organeve të qeverisjes vendore.
- Bashkitë duhet të marrin masa për të:
- ✓ rritur investimet në sektorin e transportit publik për të rinovuar stokun e autobusëve, subvencionuar biletat e udhëtimit me

mjetet e transportit publik, caktimin e korsive të rezervuara vetëm për autobusë dhe rritjen e cilësisë së shërbimit në transportin publik;

- ✓ kompletuar pajisjet semaforike të rrugëve me sistemin e dhënies prioritete autobusëve;

- ✓ hartuar dhe zbatuar strategjitë e parkimit në qytete;

- ✓ hartuar dhe zbatuar projekte për asfaltimin e të gjitha rrugëve në qytete (asfaltimi i rrugëve ekzistuese dhe hapja e rrugëve të reja të shoqëruara edhe me sinjalistikat përkatëse);

- ✓ zonifikuar qytetet me qëllim uljen e fluksit të trafikut;

- ✓ krijuar vendparkimeve të sigurt për biçikletat dhe korsi përkatëse anës rrugëve të qyteteve, bashkë me sinjalistikën përkatëse;

- ✓ të kryer këmbësorimin e segmenteve të caktuara rrugore për gjatë gjithë ditës ose për pjesë të caktuara të ditës.

- Organet e qeverisjes vendore duhet të marrin masa për:

- ✓ Rigjallërimin e parqeve ekzistuese dhe ngritjen e parqeve të reja në hapësirat e identifikuara si të lira të mundshme për ngritjen e këtyre parqeve;

- ✓ Kryerjen e investimeve me qëllim gjelbërimin rrugor në rrugët e asfaltuara;

- ✓ Përcaktimin e kriterëve për sipërfaqet e gjelbra të detyrueshme në lejet e reja të ndërtimit;

- Organet e qeverisjes vendore duhet të marrin masa për informimin e vazhdueshëm të popullsisë mbi gjendjen e ndotjes së ajrit dhe masat e marra për përmirësimin e tij përmes:

- ✓ Hartimit të raportit mbi gjendjen e mjedisit (çdo dy vjet) me kapitullin përkatës për ndotjen e ajrit;

- ✓ Informimit të publikut përmes medias së shkruar, audiovizive, botimeve;

- ✓ Përgatitjes së materialeve të thjeshta sensibilizuese (fletë-palosje e të tjera);
- ✓ Organizimit të ditës pa makina dhe gjate ditëve të tjera organizimit të aktiviteteve sportive apo teatrore me temën e mbrojtjes së cilësisë së ajrit;
- ✓ Ngritjes dhe funksionimit të Këshillit Rajonal të Mjedisit si organ konsultativ pranë Këshillit të Qarkut, i cili të analizojë midis të tjerash edhe problemet e cilësisë së ajrit;
- ✓ Ngritjes dhe funksionimit të Komisioneve Qytetare të Mjedisit pranë bashkive, një prej shqetësimeve të cilëve të përbëjë edhe mbrojtja e ajrit;
- ✓ Përfshirjes së OJF-ve mjedisore në vendim-marrjen e organeve vendore.

**3.4.5. RAST KONKRET PËR ANALIZIMIN E PROBLEMIT:  
PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË AJRIT NË TIRANË  
NGA AKTIVITETET QË LIDHEN ME TRANSPORTIN  
URBAN/TRAFIKUN<sup>2</sup>**

***Pozimi i problemit***

Tirana ka 250 km rrugë, prej të cilave një kilometrazh shumë i vogël është i asfaltuar, ndërkohë që në një pjesë tjetër të tyre kryhen rikonstrukcione, të cilat megjithë rezultatet e pritshme në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës e qarkullimit, për momentin shkaktojnë vështirësi në qarkullimin e automjeteve në kryeqytet si edhe përkeqësimin e cilësisë së ajrit.

Gjendja e rrugëve, mungesa e sinjalistikave, numri i kufizuar i vend-parkimeve dhe mosrespektimi i rregullores së qarkullimit e rëndojnë tej mase trafikun e përditshëm. Nga ana tjetër, numri i makinave që qarkullojnë në qytet është i madh (rreth 30% e numrit të

---

<sup>2</sup> Ky rast studimor i referohet Strategjisë Lokale për një Mjedis të Shëndetshëm në Qytetin e Tiranës, 2005-2008, përgatitur nga Bashkia Tiranë dhe Qendra EDEN më 2005.

përgjithshëm të automjeteve në shkallë vendi janë të regjistruara në Tiranë, shtu këtu edhe numrin e madh të automjeteve që hyjnë e dalin përditë në kryeqytet).

Transporti publik, megjithë përmirësimet e vazhdueshme të bëra nga ana e Bashkisë, përdoret ende në masë të ulët dhe shpërndarja e tij gjeografike nuk i mbulon nevojat e popullsisë.

Cilësia e karburanteve të tregtuara në vend lë për të dëshiruar e veç kësaj pjesa më e madhe e automjeteve përdorin naftën për lëndë djegëse.

Sa më lart kanë ndikimin e tyre negativ në:

- Ndotjen e ajrit dhe zhurmave në kryeqytet, duke ndikuar drejtpërdrejt në shëndetin e popullatës;
- Kushtet e transportit dhe përdorimin me efikasitet të tij, i cili lidhet direkt me zhvillimin ekonomik;
- Sigurinë e shëndetit në rrugë.

### ***Rekomandime për zgjidhjen e problemit:***

Që Tirana të ketë standarde bashkëkohore në fushën e qarkullimit rrugor (menaxhimin e trafikut) dhe transportit publik, si edhe me qëllim arritjen e sigurisë rrugore, komoditetit të lëvizjes me transport publik dhe uljen e ndotjes së ajrit, Bashkia e Tiranës duhet të punojë për:

- Rritjen e standardeve të transportit publik dhe privat;
- Aplikimin e sinjalistikës rrugore në të gjitha traktet rrugore;
- Qetësimin e trafikut dhe rritjen e sigurisë në rrugë.

Për të arritur sa më sipër, Bashkia duhet të ndërmarrë iniciativat e mëposhtme:

- Hartimi dhe zbatimi i strategjisë së parkimit publik në qytet;



- Hartimi dhe zbatimi i projekteve për kompletimin e qytetit me sinjalistikën vertikale, horizontale dhe elektronike;
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimit në transportin publik;
- Hartimi dhe zbatimi i strategjisë së transportit të qëndrueshëm për qytetin;
- Hartimi dhe zbatimi i skemës funksionale të trafikut që merr në konsideratë reduktimin e ndotjes së ajrit;
- Ngritja e qendrave të administrim-kontrollit dhe mirëmbajtjes për sinjalistikat;
- Hartimi dhe aplikimi i standarteve të reja në fushën e transportit publik;
- Studimi dhe projektimi i stacioneve qendrore (terminal) për të gjitha kategoritë e transportit;
- Realizimi i transportit alternativ (biçikletat, trami elektrik e të tjera);
- Forcimi i edukimit mjedisor për publikun në përgjithësi me konceptet bazë mjedisore lidhur me mbrojtjen e cilësisë së ajrit dhe efektin negativ të sektorit të transportit;
- Forcimi i bashkëpunimit (pushtet vendor-pushtet qendror-biznes-OJF) dhe koordinimi i veprimtarive me qëllim menaxhimin e qëndrueshëm të trafikut;
- Zhvillimi i programeve edukative-informuese me pikësynim familjen dhe grupimet komunitare lidhur me impaktin e transportit/trafikut në mjedis dhe rrugët e përmirësimit të cilësisë së ajrit;
- Përfundimi i ngritjes së sistemit të informacionit mjedisor në nivel lokal për informimin aktiv dhe pasiv të publikut përmes komunikimit elektronik.

## **MENAXHIMI I BIODIVERSITETIT DHE ZONAVE TË MBROJTURA NATYRORE**

Mbrojtja e biodiversitetit përfshin të gjitha organizmat e gjalla, biocenozat dhe habitatet e tyre. Flora dhe fauna mund të përdoren vetëm nëse nuk dëmtohen proceset natyrore, kushtet e biodiversitetit, si dhe nuk rrezikohen funksionet e tyre për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të popullatave në mjedisin e tyre natyror.

Me qëllim që të sigurohet një mbrojtje e veçantë e përbërësve të rëndësishëm të rezervave natyrore, të biodiversitetit dhe të natyrës në tërësi, organet qendrore përgjegjëse, në bashkëpunim dhe mbi bazën e mendimit të organeve të qeverisjes vendore, u sigurojnë zonave të caktuara statusin e zonave të mbrojtura dhe më pas kujdesen për ruajtjen, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të tyre dhe të burimeve natyrore dhe biologjike, lehtësimin e kushteve për zhvillimin e turizmit mjedisor si edhe për informimin dhe edukimin e publikut në lidhje me administrimin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **3.5.1. SITUATA AKTUALE**

Biodiversiteti është një nga thesaret më të çmuara vendit tonë. Llojet dhe ekosistemet që përbëjnë biodiversitetin sigurojnë burime dhe shërbime që janë thelbësore për jetën tonë. Sfidat, me të cilat ndeshemi në këtë drejtim, kanë të bëjnë me: humbje dhe copëtim habitatit, dëmtim, varfërim dhe degradim të ekosistemeve e habitateve, shqetësim të kafshëve të egra në natyrë, zhdukje llojesh apo kërcënim për zhdukje dhe prishje apo erozion gjenetik.

Në ruajtje të biodiversitetit kanë përfunduar apo janë duke u zbatuar një sërë projektesh si: projekti për ruajtjen e liqenit të Ohrit, projekti për ruajtjen e ekosistemeve ligatinore dhe bregdetare të Mesdheut dhe projektet e përvitshme për monitorimin e biodiversitetit, të cilat japin të dhëna përkatësisht për gjendjen e florës dhe faunës në zona të mbrojtura e ligatinore bregdetare. Nga viti në vit informacioni ka ardhur në rritje dhe është pasuruar me

elemente të reja: sot kryhet edhe monitorimi nëpërmjet llojeve bioindikatore.

Në zbatimin e angazhimeve globale, evropiane, rajonale apo kombëtare, Shqipëria dhe vendet e tjera janë duke zbatuar plane për të ndaluar degradimin e mëtejshëm të biodiversitetit. Zonat e mbrojtura vazhdojnë të jenë një instrument i rëndësishëm për strategji të tilla ruajtjeje dhe përbëjnë elementet bazë për ngritjen e një rrjeti mbarë - evropian ekologjik.

Në të njëjtën kohë integrimi i çështjeve të biodiversitetit në sektorë të ndryshëm është duke u bërë gjithnjë e më tepër një realitet.

### **3.5.2. LEGJISLACIONI SPECIFIK**

Legjislacioni aktual mjedisor shqiptar për mbrojtjen e biodiversitetit dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura përbëhet nga aktet e mëposhtme:

- Ligji Nr. 8934, datë 05.09.2002, “Për mbrojtjen e mjedisit”;
- Ligji Nr. 8906, datë 06.06.2002, “Për zonat e mbrojtura”;
- Ligji Nr.9103, datë 10.07.2003, “Për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare”;
- VKM Nr. 676, datë 20.12.2002, “Për shpalljen e monumenteve të natyrës shqiptare”;
- VKM Nr. 531, datë 31.10.2002, “Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit dhe të territorit përreth tij zonë natyrore veçanërisht e mbrojtur dhe përfshirjen e tij në listën e ligatinave me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujore”;
- VKM Nr. 267, datë 24.04.2003, “Për procedurat e shpalljes së zonave të mbrojtura dhe atyre buferike”;
- VKM Nr. 266, datë 24 .04.2003, “Për administratat e zonave të mbrojtura”;

- VKM Nr. 865, datë 22.10.2004, “Për shpalljen e sistemit ligator Vjosë-Nartë peizazh ujor-tokësor i mbrojtur”;
- VKM Nr. 86, datë 11.02.2005, “Për krijimin e komiteteve të menaxhimit të zonave të mbrojtura”;
- VKM Nr. 807, datë 04.12.2003, “Për rregullat e dhënies në përdorim të shpellave”;
- VKM Nr. 804, datë 04.12.2003, “Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare që vihen në mbrojtje”;
- VKM Nr. 86, datë 11.02.2005, “Për Komitetet e menaxhimit të zonave të mbrojtura ”;
- Ligji Nr.9385, datë 4.05.2005 “Për pyjet dhe policinë e shërbimit pyjor”, i ndryshuar.
- VKM Nr. 648, datë 13.12. 2002, “ Për ndalimin e përkohshëm të prerjes së lëndëve drusore, me përjashtim të asaj që përdoret për dru zjarri ”.

### **3.5.3. PLATFORMA KOMBËTARE**

Kjo platformë konsiston në disa aspekte:

- Zbatimi i legjislacionit ekzistues dhe plotësimi i tij në përputhje me direktivat përkatëse evropiane dhe marrëveshjet e tjera dypalëshe, shumëpalëshe apo ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është aktualisht palë;
- Ngritja e Komiteteve të Menaxhimit të Zonave të mbrojtura;
- Shpallja e zonave të reja të mbrojtura detare dhe bregdetare;
- Marrja e masave të karakterit hidraulik kundër erozionit;
- Moslejimi i shfrytëzimit të rërës së lumenjve për qëllime ndërtimi, me qëllim shtimin e prurjeve të ngurta të lumenjve dhe depozimin e tyre në brigjet detare dhe mbrojtja nga erozioni;

- Disiplinimi apo kufizimi i hapësirave që mund të shfrytëzohen si plazhe;
- Përgatitja e planeve të veprimit të habitateve dhe specieve të rrezikuara për ranishtat dhe dunat ranore;
- Mbajtja nën kontroll dhe moslejimi i përhapjes së specieve invazive në territore të përcaktuara;
- Zgjerimi i sipërfaqeve të mbrojtura, ku të përfshihen të gjitha sipërfaqet ligatinore dhe përfshirja brenda Zonave Veçanërisht të Mbrojtura dhe shpallja e tyre si Zona Ramsar: Përgatitja e planeve të menaxhimit;
- Ndërmarrja e pyllëzimeve të reja dhe ndërprerja e prerjeve të paligjshme dhe e ndërtimeve për qëllime turistike në brezin pyjor me pisha mesdhetare;
- Ndërhyrje me ripyllëzime në vendet më të dëmtuara.
- Ndalohet gjuetia në zonat ligatinore bregdetare të vendit për një afat kohor prej 3-5 vjetësh, me qëllim që t'i jepet mundësi faunës së egër që të rimarrë veten dhe më pas të kalohet në një gjueti të kontrolluar dhe racionale brenda mundësive reale të vjeljes së gjahut;
- Rritja e shkallës së edukimit mjedisor për rëndësinë ekoturistike të llojeve të shpendëve nëpërmjet bashkëpunimit të Ministrisë së Mjedisit me Ministrinë Bujqesisë dhe Ushqimit dhe Ministrinë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.
- Ndalimin nga ana e Rojës Bregdetare, në bashkëpunim me Inspektoriatin e Peshkimit dhe Inspektoriatin e Mjedisit, të peshkimit me lëndë plasëse.

#### **3.5.4. DIMENSIONI LOKAL**

Organet e qeverisjes vendore, të ngarkuara me detyra dhe kompetenca në fushën e mbrojtjes së natyrës, duhet të kenë parasysh sa më poshtë vijon:

- Zbatimin e të gjitha detyrave dhe ushtrimin e kompetencave të organeve të qeverisjes vendore sipas legjislacionit mjedisor;
- Përmirësimin e strukturave vendore për kontrollin dhe mbarështimin e pyjeve;
- Vazhdimin e procesit të transferimit të pyjeve tek njësitë vendore;
- Rehabilitimin dhe ruajtjen e pyjeve përmes nxitjes së investimeve private e kolektive;
- Nxitjen e nismave individuale dhe kolektive për pyllëzimin e tokave të zhveshura e të abandonuara;
- Rritjen e efektivitetit të administratave të zonave të mbrojtura për përgatitjen/zbatimin e planeve të menaxhimit të tyre, duke përfshirë gjerësisht komunitetin;
- Hartimin dhe zbatimin e planeve të veprimit për zhvillim të integruar të territoreve nën juridiksionin e organeve të qeverisjes vendore;
- Hartimin dhe zbatimin e planeve lokale për mbrojtjen e tokës nga erozioni.

## **RAST KONKRET PËR ANALIZIMIN E PROBLEMIT:**

### **SHTIMI I SIPËRFAQEVE TË GJELBËRTA NË KORÇË<sup>3</sup>**

#### ***Pozimi i problemit***

Pozicioni gjeografik si dhe klima e favorshme kanë ndikuar që Korça të konsiderohej si një nga qendrat me të admirueshme, duke filluar që nga periudha prehistorike, gati 6000 vjet para erës sonë. Nga pikëpamja ekonomike, Korça përbën një qendër të rëndësishme të zonës me një popullsi prej rreth 84,000 banorë në vitin 2004.

Ndryshimet e mëdha sociale të ndodhura në Shqipëri në periudhën e fundit e gjetën të papërgatitur qytetin nga ana urbanistike, gjë që solli rritjen e problematikës lidhur me zhvillimin urban të qytetit. Kështu nga një planifikim i programuar dhe i mbajtur gjithmonë nën kontroll, ky zhvillim urban filloi të dalë nga kontrolli në përmasa të pallogaritshme.

Ndërtimet e reja brenda zonës ekzistuese të banimit kanë përmirësuar kushtet aktuale të banimit, duke shtuar rrezikun e shkatërrimit të vlerave natyrore, të kulturës e të arkitekturës. Pjesa e kodrave, që përfshihet brenda vijës së verdhë të qytetit dhe që përbën parkun periferik të qytetit, ishte mjaft e gjelbëruar, por në periudhën e tranzicionit u dëmtua nga prerjet e shumta. Nga ana tjetër, pjesa e kodrave, dikur të gjelbëruara, sot iu është kthyer ish-pronarëve dhe krijon vështirësi për gjelbërimin e tyre.

Në parqet ekzistuese në qendër dhe në periferi të qytetit mungon infrastruktura. Për pasojë, parqet janë dëmtuar si rezultat i keqtrajtimit nga kalimtarët, bagëtia, si dhe plakja e degradimi i bimësisë ekzistuese.

Vihen re boshllëqe të bimësisë me drurë dekorativë në rrugët ekzistuese dhe mungesa në mbjellje në rrugët e reja. Gjithashtu

---

<sup>3</sup> Ky rast studimor i referohet Planit Lokal të Veprimit në Mjedis për Bashkinë e Korçës, përgatitur nga REC - Qendra Rajonale e Mjedisit dhe botuar më 2005.

mungojnë parqet dhe lulishtet në bllok -pallatet ekzistuese dhe në ato që pritet të ngrihen.

Është bërë evident edhe shqetësimi për dëmtimin e veprave të artit dhe monumentet e kulturës në parqet ekzistuese dhe dëmtime në bordura rrugësh, stola, shatërvanë e të tjera.

Për pasojë, mungesa e mjediseve çlodhëse dhe ulja e cilësisë së ajrit sjell pasoja negative në shëndetin e qytetarëve, krijon një mjedis jo të përshtatshëm banimi dhe ul vlerat turistike dhe tërheqëse të qytetit.

### ***Rekomandime për zgjidhjen e problemit***

Duke vënë re mungesat e sipërpërmendura, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, biznesi dhe vete qytetarët e Korçës këto pesë vitet e fundit janë angazhuar për mbjelljen e mjaft pemëve në zonën e kodrave të qytetit, për t'i kthyer disi gjelbërimin kësaj zone. Sidoqoftë, organet e qeverisjes vendore do të duhet të marrin masa edhe për:

- Ndërtimin e lulishteve të reja me pemë dhe shkurre dekorative, stola, fusha sportive dhe të ndriçuara në bllok-pallatet ekzistuese, si edhe miratimin e projekteve ndërtimore për pallatet e reja vetëm nëse kanë të përfshira lulishte dhe sipërfaqe të tjera të gjelbëruara përreth tyre;

- Ndërtimin e rrjetit rrugor si rrugica të brendshme, stola dhe pjergullata, vepra arti, mbjellje pemësh dhe shkurresh dekorative në parqet periferike si parku “Rinia” dhe kodrat “Belvedere”;

- Ndërtimin e rrugëve dhe rrugicave, tapeteve të barit, stola dhe vepra arti, basene e shatërvanë dhe vendosjen e ndriçimit dekorativ në parqet kryesore të qytetit;

- Mbjelljen e pemëve dhe shkurreve dekorative në rrugët ekzistuese dhe në rrugët e reja;

- Mbjelljen dhe përmirësimin e pemëve dhe shkurreve dekorative. për të krijuar një brez të gjelbëruar izolues në varrezat e qytetit.



- Ngritjen e qendrave të informimit të publikut për problemet mjedisore dhe kryerjen e aktiviteteve të ndryshme jo vetëm në ditët mjedisore.

## **4 HARTIMI I PLANEVE VENDORE TË VEPRIMIT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT**

---

Organet e qeverisjes vendore hartojnë plane veprimi për mjedisin, në përputhje me përparësitë dhe kërkesat e strategjisë kombëtare të mjedisit.

Në hartimin dhe miratimin e planeve dhe të programeve mjedisore, organet e qeverisjes vendore angazhojnë publikun dhe organizatat jofitimprurëse mjedisore dhe profesionale të biznesit.

Domosdoshmëria e hartimit të planeve lokale të veprimit është në përputhje me strategjinë e decentralizimit të pushtetit sipas sektorëve prioritarë dhe me dhënien e kompetencave në rritje qeverisjeve vendore. Rritja e rolit të shoqërisë civile dhe e komuniteteve në vendimmarrje është shumë e rëndësishme.

Veprimtaritë specifike nën këto plane janë:

1) Vlerësimi i kapaciteteve njerëzore (duke përfshirë numrin dhe shkallën e kualifikimit të tyre) dhe financiare brenda organeve të qeverisjes vendore në dispozicion të mbrojtjes së mjedisit;

2) Organizimi i programeve trajnuese me pjesëmarrjen e subjekteve të interesuara;

- 3) Vlerësim i gjendjes së mjedisit në nivel vendor;
- 4) Identifikimi i prioriteteve dhe i rrugëzgjdhjeve;
- 5) Ngritja e strukturave të koordinimit ndërsektorial vendor;
- 6) Zhvillimi i partneritetit ndërmjet pushtetit vendor dhe OJQ-ve.

Kostot ekonomike dhe sociale të dëmtimit të mjedisit, të cilat duhen vlerësuar në kuadër Strategjive dhe planeve lokale të veprimit në përputhje me Deklaratën e Mijëvjeçarit të nënshkruar nga RSH, të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Mjedisin janë:

1. Kostoja e shëndetit;
2. Kostoja e produktivitetit;
3. Kostoja për aspektet estetike.

**KUTIA 1: ZHVILLIMI I PLANIT TË VEPRIMIT:  
KRITERET, OBJEKTIVAT DHE VEPRIMET**

Kriteret për Vlerësimin e Problemeve	Grupet e Problemeve Prioritare	Objektivat e Planit të Veprimit	Kriteret për Klasifikimin e Veprimeve	Grupet e Aktiviteve Prioritare
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Ndikimi në produktivitetin dhe efektshmërinë ekonomike</li> <li>➤ Ndikimi në shëndet</li> <li>➤ Ndikimi në uljen e varfërisë</li> <li>➤ Ndikimi në ekosisteme</li> <li>➤ Shpërndarja hapësimore e problemit</li> <li>➤ Shkalla e emergjencës së problemit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mbishfrytëzimi i pasurive natyrore dhe ekosistemet e rrezikuara</li> <li>➤ Problemet e Mjedisit e të Shëndetit dhe lëndët e rrezikshme</li> <li>➤ Problemet specifike të elementeve të mjedisit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Zbatimi parimit të zhvillimit të qëndrueshëm</li> <li>➤ Përtëritja e burimeve natyrore</li> <li>➤ Parandalimi dhe zbutja e ndotjes së mjedisit</li> <li>➤ Nxitja e përdorimit optimal të pasurive natyrore për qëndrueshmërinë dhe efektshmërinë ekonomike</li> <li>➤ Rritja e kapaciteteve të institucioneve qendrore, vendore dhe komuniteteve në fushën e administrimit të mjedisit</li> <li>➤ Përmirësimi i cilësisë së jetës</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Mundësitë financiare</li> <li>➤ Kapacitetet zbatuese institucionale</li> <li>➤ Niveli i mbështetjes politike dhe publike</li> <li>➤ Qëndrueshmëria</li> <li>➤ Integrimi ndërsektorial</li> <li>➤ Urgjenca</li> <li>➤ Ndikimi në zbutjen e varfërisë dhe rritjen ekonomike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Masat politike</li> <li>➤ Masat ligjore dhe rregullatore</li> <li>➤ Ndërtimi i kapaciteteve institucionale</li> <li>➤ Investime</li> <li>➤ Informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut</li> <li>➤ Rritja e rolit të publikut dhe e shoqërisë civile në vendim-marrje</li> </ul>

## KUTIA 2: PËRFITIMET NGA PLANI I VEPRIMIT

PROJEKTET	PËRFITIMET
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Projektet institucionale</li> </ul>	- Zhvillimi i burimeve njerëzore; përmirësimi i efektshmërisë administrative; rritja e të ardhurave nga përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, rritja e cilësisë së jetës nga përmirësimi i mjedisit.
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mënjanimi i ndotjes së ajrit</li> </ul>	- Përmirësimi i shëndetit nga pakësimi i pluhurave dhe i përbërjeve ndotëse nga trafiku, rritja e vlerave estetike dhe të biodiversitetit.
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbrojtja e ujërave</li> </ul>	- Përmirësimi i shëndetit, ulja e varfërisë
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Furnizimi me ujë</li> </ul>	- Përmirësimi i shëndetit, ulja e varfërisë
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Projektet që lidhen me ujin e pijshëm dhe pastrimin e ujërave të zeza</li> </ul>	- Përmirësimi i shëndetit, cilësia e jetës, ruajtja e burimeve ujore, zhvillimi i turizmit, rritja e efektshmërisë ekonomike, ulja e varfërisë dhe rritja ekonomike, pakësimi i potencialit ndotës.
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritja e ndërgjegjësimit për përdorimin e qëndrueshëm të ujit</li> </ul>	- Rritja e efektshmërisë në përdorimin e ujit pakësimi i shkallës së ndotjes, ulja e shpenzimeve për rehabilitim.
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Administrimi i burimeve tokësore</li> </ul>	- Rritja e produktivitetit dhe administrimi i qëndrueshëm i tokës, ulja e varfërisë, nxitja e zhvillimit të bujqësisë së qëndrueshme.
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Administrimi i hedhurinave</li> </ul>	- Përmirësimi i shëndetit, rritja e vlerave estetike, parandalimi i ndotjes së mjedisit.
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pylltaria</li> </ul>	- Pakësimi i erozionit të tokës, pakësimi i përbytyjeve, përmirësimi i biodiversitetit, stabilizimi i pellgjeve ujëmbledhës, rritja e të ardhurave nga drutë e zjarrit dhe lënda drusore, ulja e varfërisë dhe rritja ekonomike, zhvillimi i turizmit, pakësimi ndryshimeve klimatike, rritja e shkallës së pastërtisë së ajrit, përmirësimi i cilësisë së jetës.
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ruajtja e biodiversitetit</li> </ul>	- Përmirësimi i mbrojtjes së pellgjeve ujëmbledhës, përmirësimi i mbrojtjes së habitateve për speciet e rrezikuara, përmirësimi i mbrojtjes së habitateve të zogjve migratorë, përmirësimi i mjedisit rekreativ dhe rritja e të ardhurave nga ekoturizmi.
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rehabilitimi i zonave të ndjeshme dhe të nxehta</li> </ul>	- Përmirësimi i shëndetit, përtëritja e burimeve natyrore, ulja e varfërisë, rritja ekonomike dhe riaftësimi i vetive natyrore të mjedisve të ndotura dhe përmirësimi i tyre.

# **5**

## **EKSPERIENCA NË DECENTRALIZIMIN MJEDISOR**

---

Shqipëria, si vend anëtar i Këshillit të Evropës, merr pjesë aktive në komisionet dhe aktivitetet e zhvilluara për rritjen dhe konsolidimin e demokracive lokale. Nëpërmjet këtyre pjesëmarrjeve është përfituar edhe nga eksperiencat e vendeve të tjera anëtare.

### **5.1 PËRVOJA JAPONEZE NË DECENTRALIZIMIN INSTITUCIONAL DHE FUNKSIONAL MJEDISOR**

#### **5.1.1. NEVOJA PËR DECENTRALIZIM**

Lëvizja drejt decentralizimit vjen nga vjetrimi i sistemit administrativ të centralizuar, i cili karakterizohet nga një mbipërqendrim i pushtetit, parave, njerëzve dhe informacionit midis autoriteteve qendrore, që ka çuar në më të shumtën e rasteve në zhveshjen e rajoneve lokale nga burimet e vitalitetit të tyre dhe, nëpërmjet një mbitheksimi mbi uniformitetin dhe barazinë mbarëkombëtare, janë injoruar kushtet dhe ndryshimet lokale.

Si rezultat, tani është duke u rritur ndjesia që nxitja e decentralizimit është e nevojshme për t'iu përgjigjur rrethanave dhe sfidave të një kohe të re.

Decentralizimi është vlerësuar gjithashtu për subvencionimin më të madh dhe lokalizimin e vendim-marrjes midis komuniteteve dhe qeverisjes lokale, për përcaktimin më të mirë të rolit dhe përgjegjësisë midis niveleve të ndryshme të qeverisjes, për shërbime të

ndryshme drejtuese që lidhin nevojat e kushteve lokale, si dhe për reduktimin e kontrollit dhe interferimin në minimum të qeverisë qendrore në qeverisjen lokale.

Paralel me këtë proces decentralizues dhe rritjen e autonomisë lokale është duke u rritur të kuptuarit midis të gjitha niveleve të palëve të interesuara që zgjidhja për problemet globale mjedisore mund të gjendet vetëm në nivel lokal, nëpërmjet veprimeve lokale që ndërmerren nga aktorët lokale.

Kjo ka hedhur dritë mbi qeverisjet lokale, që të marrin iniciativa për të zhvilluar politika krijuese, programe dhe projekte të mbrojtjes së mjedisit në një mënyrë të koordinuar, gjë që çon në ndikime pozitive globale. Nga qeverisjet lokale është pritur gjithashtu të krijohet një mjedis më i thjeshtë, ku të zërë vend pjesëmarrja më e thellë e aktoreve, e palëve të interesuara.

### **5.1.2. PROCESI DECENTRALIZUES**

Me aprovimin e ligjit “Për nxitjen e decentralizimit”, lëvizja decentralizuese në Japoni lëvizi nga stadi i debatimit në stadin e implementimit. Reformat që u kryen janë vlerësuar si ‘vala e tretë e reformës’ e që pasuan ato të bëra gjatë Meiji Restoration dhe ato të viteve të para të pas-Luftës së II Botërore.

Në dhjetor 1996, Komiteti për Nxitjen e Decentralizimit dorëzoi Raportin e Rekomandimeve të Para tek Kryeministri, të ndjekura nga një raport i dytë në korrik 1997. Bazuar në këto rekomandime, Qeveria vendosi një plan gjithëpërfshirës për decentralizimin.

Në mënyrë që të arriheshin rezultate kuptimplote, për decentralizimin, institucioneve lokale iu desh që të nxisin reforma administrative nëpërmjet rindërtimit gjithashtu të organizatave dhe institucioneve të tyre. Në respekt të zbatimit të masave të cituara në Raport, Ministria e Punës nxiti reformat lokale nëpërmjet shkrirjes së bashkive lokale, ristrukturimit të shpenzimeve kombëtare të grandeve të thesarit dhe rishikimin e sistemit të taksave lokale.

Një zhvillim i përgjithshëm që vuri në lëvizje fokusin mbi qeverisjen lokale ishte zhvendosja e theksit zhvillues nga rritja sasiore e ekonomisë lokale në përmirësimin cilësor të jetës së qytetarëve.

Sloganet zhvilluese të 1960 dhe 1970 fillimisht theksonin rritjen sasiore të ekonomisë lokale dhe qëndrore dhe vëmendje në infrastrukturën dhe shërbimet zhvilluese. Kjo i ka dhënë tani rrugë theksimit të një metodë zhvilluese cilësore, duke u fokusuar më shumë në cilësinë e jetës së qytetarëve të tij. Edhe njëherë energjitë krijuese të qeverisjes lokale dhe strukturave të tjera lokale janë përdorur për të zhvilluar një mjedis jetësor që i përshtatet dëshirave të qytetarëve dhe “qëndrueshmërisë” në të njëjtën kohë.

Tre zhvillimet e mësipërme janë veçanërisht domethënëse në dritën menaxhimit lokal mjedisor si brenda qytetit në vetvete dhe ndikimeve, efekteve në një mjedis më të gjerë rajonal dhe global. Qeverisja lokale dhe partnerët lokale që punojnë dhe shërbejnë aty janë përballur me situatën e rritjes dhe të forcimit të kapaciteteve të tyre për të menaxhuar mjedisin lokal. Ka një sërë mjetesh dhe ligje që janë të vlefshme për qeveritë lokale për një menaxhim të mirë mjedisor.

Shumë prej tyre kanë qenë krijuar në nivel ndërkombëtar, por që e kanë vendosur qeverisjen lokale si një aktor kyç dhe mbështetës në zbatimin e tij dhe duke patur një bashkëpunim të gjerë me mbështetësit lokalë në stadi të ndryshme të vendim-marrjes dhe implementimit.

Fjalë të tilla si cilësi e jetës, menaxhim i ujërave dhe mbetjeve, ruajtja e burimeve natyrore, reduktimi i ndotjeve, ndryshime administrative janë të lidhura me mjetet e menaxhimit mjedisor. Për shembull, një cilësi e lartë jete dhe mjedis urban i mirë janë të lidhura me:

1) Zbatimin e Axhendës Lokale 21; (Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin, e vitit 1991, nxori një urdhëresë për të gjitha autoritetet e qeverisjeve vendore për të përgatitur një Axhendë Lokale 21. Njësitë e Qeverisjes vendore në secilin vend janë për të ndërmarrë një proces konsultativ me popullsinë e komunitetit të tyre, për të arritur një konsensus për një plan axhenda 21 për komunitetin. Pas këtij procesi, në më shumë se



102 njësi të qeverisje vendore në Japoni, ose në rreth 90% të tyre, u zhvillua dhe implementua një Axhendë Lokale 21).

2) Reduktimi i problemeve të ndotjes dhe ruajtja e burimeve të rralla janë të lidhura me zbatimin e analizës vlerësuese të ciklit të jetës dhe Eko-labeling (etiketimit ekologjik ose miqësor me mjedisin);

3) Reduktimi i ndotjeve, modelet e konsumit të qëndrueshëm dhe ndryshimet në prodhim janë të lidhura me krijimin e një sistemi menaxhues mjedisor dhe standardit ISO 14001;

4) Përdorimi i energjive alternative, ruajtja e energjisë, ruajtja e burimeve natyrore me rregullat e racionalizmit të planifikimit urban dhe rregullave të ndërtimit;

5) Shkarkimi i karbonit dhe ndotja e ajrit me protokollin e Kyotos; demokracia, autonomia e qeverisjes lokale dhe decentralizimi përmes Qeverisjes Lokale.

### **5.1.3. QEVERISJA LOKALE**

#### **DHE MENAXHIMI MJEDISOR NË JAPONI**

Që prej 1980 është rritur kërkesa e konsumatorëve për produkte që nuk kanë ndikim në mjedis. Kjo është evidente në shitjen e produkteve si detergjentet jo toksikë, letra pa përmbajtje klori, vajra të riciklueshme dhe bateri pa Mërkur. Dëshira e publikut për të përdorur fuqinë e tij blerëse si një mjet për të mbrojtur mjedisin u jep prodhuesve mundësi për të zhvilluar produkte të reja. Nevoja për rregulla rreth etiketimit miqësor me mjedisin ka çuar në përpjekje konkrete për të zhvilluar protokolle të etiketimit ose standarde që i vlejné besimit të publikut.

Qeverisja lokale në Japoni ka luajtur një rol të rëndësishëm në gjenerimin e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë për këto çështje, duke ushtruar presion mbi biznesin dhe aktoret e industrisë, të marrin pjesë dhe të mbështesin iniciativa të tilla. Së bashku të dyja palët janë pjesë të standardit ISO 14040 (Vlerësimi i ciklit të jetës) dhe ISO 14020 (Eco-labeling).

#### **5.1.4. SISTEMI I MENAXHIMIT MJEDISOR DHE ISO 14001.**

ISO 14001 është një standard ndërkombëtar vullnetar, i cili në themel të tij vendos kërkesat për krijimin e një sistemi menaxhimi mjedisor. Ai ka të bëjë me identifikimin e ndikimeve më të rëndësishme mjedisore të një aktiviteti prodhues dhe vullnetarisht vendos një sistem menaxhimi mjedisor në vend, për të minimizuar ose eliminuar ndikimet negative nga veprimtaria. Qytetet në Japoni kanë qenë në ballë të kërkesave për t'u çertifikuar me ISO 140001, për të shërbyer si model për industrinë dhe organizatat e tjera.

Që prej 2000 më shumë se 40 prefektura, bashki dhe komuna rreth Japonisë kanë kërkuar të çertifikohen me ISO 14001.

#### **5.1.5. PROTOKOLLI KYOTOS**

Marrëveshja e parë midis kombeve më të mëdha industriale për arritjen e objektivave detyruese për reduktimin e gazeve serë u mbajt në dhjetor të 1997, në një takim të Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike në Kyoto.

#### **5.1.6. RREGULLAT PËR PLANIFIKIMIN URBAN DHE LIGJET E NDËRTIMIT**

Sistemi i planifikimit të qyteteve në Japoni kërkon parashikime bazë për zhvillimin e planifikuar të zonave urbane. Ato përfshijnë:

- tipin dhe standardet e planifikimit të qyteteve;
- procedurat e planifikimit;
- kontrollin e planifikimit;
- projektet e zhvillimit urban.

Detaje të rregulloreve dhe praktikave të planifikimit janë planifikuar në një legjislacion të veçantë; për shembull, për ndërtesat standarde ky akt rregullon aktivitetet ndërtuese në lidhje me planifikimin zonal dhe Akti i konsolidimit të tokës siguron procedura ligjore për projekte të konsolidimit të tokës në vende të specifikuara, sipas planeve të miratuara të qytetit.

Akti i planifikimit të qytetit i vitit 1968 formoi baza për planifikimin e qyteteve në Japoni dhe është lidhur me kontrollin efektiv të përdorimit të tokës, funksionimin e zonave të planifikuara të qyteteve dhe delegimin e kompetencave ligjore autoriteteve të qeverisjes vendore.

Një dizënjim dhe implementim efektiv i rregulloreve të planifikimit urban dhe standardeve të ndërtimit çon në krijimin e një jete mjedisore të standardeve të një cilësie të larte, duke respektuar mjedisin natyror.

## **5.2 PËRVOJA BRITANIKE**

### **NË ZBATIMIN E AXHENDËS LOKALE 21**

Në janar 1993, shoqata e pesë autoriteteve lokale në Mbretërinë e Bashkuar (Shoqata e Këshillave të Distrikteve, Shoqata e Këshillave Vendore, Shoqata e Autoriteteve Metropolitane, Konfederata e Autoriteteve Lokale Skoceze dhe Shoqata e Autoriteteve Lokale të Irlandës së Veriut) vendosën një Rend Dite Lokal (RDL - Axhendë Lokale 21) të përbashkët.

Grupi drejtues për zhvillimin dhe drejtimin e fushatës kishte për qëllim sigurimin e një baze të gjerë përgjegjësish nga autoritetet lokale që rrjedhin nga RDL 21. Ata krijuan një grup drejtues shumë sektorësh, për të drejtuar fushatën me përfaqësimin nga zyrtarë lokalë të zgjedhur, OJQ mjedisore, sektori i biznesit, bashkësitë e grave, sektori arsimor dhe akademik, unionet tregtare dhe bordet menaxhuese të autoriteteve lokale (BMAL). BMAL, e cila është agjencia teknike e shoqatave të qeverisjes lokale, u krijua si një sekretariat për fushatën.

Si detyrë të parë grupi drejtues përcaktoi elementët thelbësorë të RDL 21 në kontekstin e menaxhimit dhe përmirësimit të performancës mjedisore bashkiake; integrimi i zhvillimit të qëndrueshëm në politikën dhe aktivitetet bashkiake; rritja e ndërgjegjësimit, konsultimi dhe pjesëmarrja publike, ngritja e partneritetit, masat monitoruese dhe raportuese në progresin e qëndrueshmërisë.

Fushata përkrahu qeverisjet vendore në përpjekjet e tyre për t'u deleguar këto fusha duke i dhënë asistencë teknike (trajtime),

ekspertizë teknike dhe mundësi për shkëmbim informacioni. Si rezultat i kësaj, më se 60% e autoriteteve lokale në Mbretërinë e Bashkuar kanë hedhur hapa kryesore drejt sipërmarrjes së RDL 21. Iniciativa ka qenë një mënyrë për të forcuar organet e qeverisjes vendore, përkushtimin e tyre për mjedisin, zhvillimin ekonomik dhe social dhe demokracinë lokale.

Përmes fushatës britanike për axhendën, shoqata e autoriteteve lokale e kanë bërë axhendën pjesë të biznesit të përditshëm për shumicën e autoriteteve lokale. Një nivel i lartë suksesi në një periudhë kaq të shkurtër kohore mund të shpjegohet nga rëndësia e Shoqatave Kombëtare të Bashkive, roli i anëtarëve të grupit drejtues dhe rrjeteve të tyre përkatëse në influencimin e autoriteteve lokale dhe gatishmëria e vetë këtyre të fundit për të marrë rolin drejtues në zhvillimin e qëndrueshëm.

Këshilli Ndërkombëtar për Iniciativat Lokale Mjedisore (**ICLEI**) është një shoqatë e organeve të qeverisjes vendore dedikuar parandalimit dhe zgjidhjes së problemeve lokale, rajonale dhe globale të mjedisit nëpërmjet planeve lokale të veprimit.

ICLEI u krijua më 1990, sponsorizuar nga UNEP (Programi Mjedisor i Kombeve të Bashkuara), IULA (Unioni Ndërkombëtar i Autoriteteve Lokale) dhe Qendra e Diplomacisë Krijuese. Është një shoqatë demokratike me më shumë se 300 qytete anëtare, qytete të vogla, rrethe dhe shoqatat e tyre në 56 shtete, përkushtuar zhvillimit të qëndrueshëm. Çdo anëtar ka një pozicion në këshillin e ICLEI.

Në punën e vet intensive me qeveritë lokale, ICLEI ka krijuar dy programe botërore që janë shumë të rëndësishme për zbatimin e zhvillimit të qëndrueshëm në të gjithë botën. Iniciativa RDL 21 mbështet qeverisjet lokale në përgatitjen e zbatimit të planeve për zhvillimin e qëndrueshëm.

Tashmë ekzistojnë më se 2 000 autoritete lokale në 64 vende të përfshira në planifikimin e RDL 21. Qytetet për fushatën e mbrojtjes klimatike (CCP), punojnë me mëse 250 qytete në 41 shtete për të vendosur dhe zbatuar veprime konkrete për të reduktuar efektin serë të shkaktuar nga emetimi i gazrave në atmosferë. Këto aktivitete përmirësojnë cilësinë e ajrit lokal dhe kushtet e banimit urban. ICLEI mbështet këto programe me kërkime të detajuara,

projekte pilot, ekspertizë teknike, ndërtim kapacitetesh, grande të vogla inkurajuese, materiale burimore plus dhe një faqe Web ndërkombëtare.

ICLEI organizon trajnime intensive dhe programe shkëmbimi për përfaqësuesit e autoriteteve lokale dhe deri tani 8 000 persona kanë marrë pjesë në aktivitetet e rrjetit dhe trajnimeve të ICLEI. Ky i fundit është pozicionuar mirë për të dhënë projekte ndërkombëtare me kontakte të autoriteteve lokale në më shumë se 50 shtete.

Aktivitetet e tij zhvillohen nëpërmjet shoqërive jo-fitimprurëse të lidhura me të dhe të inkorporuar në Kanada, Amerikë dhe Gjermani, si dhe nëpërmjet një organizate partnere në Japoni.

Sekretariati Botëror është në Toronto-Kanada, Sekretariati Evropian dhe Qendra Ndërkombëtare e Trajnimit ndodhet në Freiburg-Gjermani, ka zyra në Berkley-Amerikë, Tokyo-Japoni, Harare-Zimbabve dhe Santiago-Kili.

### **5.3 PËRVOJA IZRAELITE**

#### **NË ZBATIMIN E AXHENDËS LOKALE 21**

Më 14 maj 2003, Qeveria e Izraelit aprovoi në mënyrë unanime propozimin e ministrit të Mjedisit, Prof. Yehuith Naot, për përgatitjen e planit strategjik për zhvillimin e qëndrueshëm të Izraelit. U vendos që “politika e qeverisë së Izraelit të bazohet në parimet e praktikës së zhvillimit të qëndrueshëm që kombinon një ekonomi dinamike, një përdorim me kriter të burimeve natyrore, mbrojtjen e ekosistemeve dhe krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë, për të përballuar të gjitha nevojat e brezave ekzistues dhe të ardhshëm”. Për më tepër vendimi kërkon nga qeveria promovimin e Planit të Zbatimit që u aprovua në Samitin Botëror të Johannesburgut dhe u kërkonte ministrive përkatëse të qeverive të hartonin Planin Strategjik për Zhvillimin e Qëndrueshëm, që do të përfshijë ndër të tjera “një plan me mjete të zbatimit, burime financimi në kuadrin e buxhetit të vet, objektiva të matshme dhe afate që duhen zbatuar”.

Për herë të parë, kandidatët për zgjedhjet bashkiake nënshkruan një marrëveshje, ku deklarohet përkushtimin e tyre ndaj mjedisit. Ceremonia e veçantë shënoi konkluzionin e mbledhjes speciale të 100 kryetarëve të bashkive, anëtarëve dhe kandidatëve të këshillave bashkiake, që u zhvillua në Parlamentin e Izraelit (Knesset) më 7 tetor 2003.

Ngjarja që bashkoi kokat e autoriteteve lokale dhe kandidatët bashkiakë me anëtarët e Knesset dhe aktivistët ambientalistë, u fillua me një Komitet të Brendshëm dhe të Mjedisit të Knesset dhe nga “Jeta dhe Mjedisi”, organizata mëmë e OJQ-ve ambientaliste.

Në përgatitjen për zgjedhjet lokale në tetor 2003, Ministria e Brendshme përgatiti një udhëzues për zyrtarët e rinj të sapo zgjedhur për përafrimin e cilësisë ambientaliste dhe Rendin e Ditës Lokal në 21 autoritete lokale. Guida u ofronte përfaqësuesve të zgjedhur publikë mjetet e nevojshme për të përparuar në zhvillimin lokal, bazuar mbi një vizion afatgjatë që merr parasysh brezat e tashëm dhe të ardhshëm. Përfshin kapituj mbi rolin e komiteteve mjedisore, menaxhimin e mjedisit lokal, parimet e planifikimit mjedisor, menaxhimin e infrastrukturave mjedisore dhe përdorimin e trojeve, zbatimin mjedisor, pjesëmarrjen e publikut në vendim-marrjen lidhur me mjedisin dhe zbatimin e zhvillimit të qëndrueshëm në autoritetet lokale.

Kapitulli mbi zhvillimin e qëndrueshëm lidhet me të tilla çështje si gjurma ekologjike e bashkisë, konservimi i burimeve, pjesëmarrja e publikut në drejtësinë sociale dhe mjedisore.

Për t'i nisur këto mesazhe në vendet e tyre, është organizuar një seminar special me kryebashkiakët dhe anëtarët bashkiakë për t'i familjarizuar me procesin e Rendit të Ditës Lokal (RDL), në përputhje me parimet për një autoritet të qëndrueshëm lokal.

### ***Shëndeti dhe qëndrueshmëria.***

Konferenca vjetore më 2003 e Rrjetit të Qyteteve të Shëndetshme të Izraelit (RQS) iu dedikua një plani të përbashkët lokal

në emër të shëndetit dhe qëndrueshmërisë. Konferenca e mbajtur në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Qendrës Heschel për Lidërshtipin Mjedisor bashkoi koordinatorët e RQS të Izraelit dhe koordinatorët e iniciativës Rendi i Ditës 21. Si konferenca dhe seminari nënvizuan lidhjet midis RQS dhe RDL 21, duke hedhur dritë mbi format e përbashkëta të bashkëpunimit në nivel lokal.

Gjithashtu, panele dhe lektorë mbi temat e zhvillimit të qëndrueshëm, RDL 21 dhe impakti i konsumit mbi shëndetin dhe qëndrueshmërinë, pjesëmarrësve në seminar iu kërkua të analizonin tre raste studimore, nga perspektiva e shëndetit, shoqërisë dhe ambientit dhe të paraqisnin rekomandime të përbashkëta për autoritetet lokale për zgjidhje të qëndrueshme.

Për të katërtin vit, Ministria e Mjedisit ka vazhduar projektin e fushës së gjelbër në bashkëpunim me Shoqatën e Qendrave Komunitare të Izraelit. Në verën e 2003, 13,761 fëmijë nga të gjitha shtresat e popullsisë morën pjesë në rreth 70 fusha të gjelbra në autoritetet lokale të gjithë vendit. Ministria e Mjedisit subvencionoi koston e fushës për 6 227 fëmijë që nuk mund të përballonin të gjithë çmimin. Motoja e këtij viti në të gjitha fushat ishte “konsumi i gjelbër”.

Aktivitetet qenë të fokusuar në reduktimin e përdorimit të qeseve plastike, duke rritur jetëgjatësinë e produkteve të ndryshme, duke promovuar një konsum të mençur dhe efektiv, duke analizuar rolin e publicitetit, reduktimit të mbeturinave, ndarjen e burimeve të mbeturinave, ripërdorimin e produkteve, riciklimin etj.

Në katër vitet e fundit 60 000 fëmijë morën pjesë në fushat e gjelbra në të gjithë vendin.

- Rreth 91% e popullsisë së Izraelit jeton në zona urbane.
- Shumë autoritete lokale janë certifikuar me ISO 14001 (Sistemet e Menaxhimit Mjedisor), ku përfshihen Ra’ahana, Ma’ale Adumim, Karmiel dhe Eilat.

- Ekzistojnë 39 njësi mjedisore lokale në Izrael, përfshi shoqatën e qyteteve për mjedisin dhe njësitë e sektorit Arab.
- RQS të Izraelit përfshin 43 anëtarë, prej të cilëve 34 janë autoritete lokale, katër janë ministri qeveritare dhe 5 institucione. 41% e popullsisë së Izraelit jeton në Qytete të Shëndetshme.
- Ekzistojnë tre lloje autoritetesh lokale në Izrael: bashkitë me popullsi mbi 20,000; këshillat lokale që menaxhojnë qytete me popullsi midis 2,000 dhe 20,000 dhe këshillat rajonale që mbajnë përgjegjësi për disa fshatra të grupuara brenda një rrezeje të caktuar.

#### **5.4. BASHKËPUNIMI MIDIS AUTORITETEVE LOKALE MJEDISORE DHE ATYRE TË QEVERISJES VENDORE**

##### **5.4.1. SHMANGIA E KONFLIKTEVE GJYQËSORE NDËRMJET AUTORITETEVE LOKALE MJEDISORE**

###### **DHE AUTORITETEVE TË QEVERISJES VENDORE**

Të gjitha studimet urbanistike, master-planet lokale, rajonale dhe kombëtare marrin paraprakisht në fazën e miratimit nga KRRT përkatëse të komunave, bashkive, qarqeve miratim ose pëlqim mjedisor nga autoriteti lokal mjedisor (ARM).

Në zbatim të Ligjit Nr.8453, datë 4.02.1999, "Për urbanistikën", të ndryshuar, përveç Bashkisë Tiranë, ku anëtar i KRRT është kryetari i Agjencisë Rajonale të Mjedisit të Qarkut Tiranë, në KRRT e bashkive të tjera dhe të qarqeve është anëtar një inspektor i mjedisit.

Gjatë praktikës së përditshme është konstatuar se Organet e Qeverisjes Vendore gjatë fazës së realizimit të projekteve të përmendura më sipër nuk kanë zbatuar legjislacionin mjedisor.

Edhe pse këto organe kryejnë dhe projektimin dhe janë investitorë, në zbatim të ligjit për prokurimin publik dhe akteve nënligjore këta persona juridikë kontraktajnë me firma zbatuese, të cilat kanë detyrimin e zbatimit të projektit me cilësi dhe në afat. Këto



firma, për vetë detyrimin që kanë, nuk mund të aplikojnë për leje apo autorizim mjedisor për objektin e kontratës së tyre pasi kjo do t'i penalizonte ato për tejkallim të afatit të dorëzimit të veprës.

Është detyrim ligjor i Organeve të Qeverisjes Vendore të aplikojnë pranë Agjencive Rajonale të Mjedisit për t'u pajisur me leje apo autorizim mjedisor. Firmat fituese do të zbatojnë kondicionet e vendosura në lejet apo autorizimet mjedisore përkatëse që merren në emër të njësisë së qeverisjes vendore në kuptim të nenit 42 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit.

#### **5.4.2. FORCIMI I ZBATIMIT TË LEGJISLACIONIT MJEDISOR: ZBATIMI I VENDIMEVE TË AUTORITETEVE LOKALE MJEDISORE NGA ANA E AUTORITETEVE TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE**

Nga praktika tre-vjeçare e funksionimit të Inspektoratit të Mjedisit është konstatuar se Autoritetet e Njësive të Qeverisjes Vendore nuk kanë zbatuar legjislacionin mjedisor në ekzekutimin e vjeljes së gjobës pas delegimit të kësaj kompetence me aktin përkatës këtyre njësive, pasi subjektet e dënuara nuk e kanë paguar vullnetarisht gjobën dhe u është parashkruar e drejta e ankimit.

Në zbatim të nenit 19 të Ligjit nr.7697, datë 7.04.1993, "Për kundravajtjet administrative", të ndryshuar, Autoritetet e Njësive të Qeverisjes Vendore janë të detyruara të nxjerrin titujt ekzekutivë për vjeljen e gjobave të vendosura nga organet shtetërore e, në këtë rast, të gjobave të vendosura nga Inspektorati i Mjedisit ndaj subjekteve, të cilat kryejnë veprimtari me ndikim në mjedis, brenda juridiksionit administrativ të këtyre njësive dhe që kanë kryer kundravajtje administrative të përcaktuara në legjislacionin mjedisor. Fondet e nxjerra nga gjobat duhet të përdoren nga këto njësi në kuptim të nenit 87 të ligjit për mbrojtjen e mjedisit

## **6 Shtojca**

---

### **6.1. EKSTRAKTE NGA LIGJET E MJEDISIT ME INFORMACIONE SPECIFIKE PËR INSPEKTORËT E MJEDISIT**

#### **6.1.1. LIGJI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT (LMM) NR. 8934, DATË 05.09.2002**

##### **PËRDORIMI DHE MBROJTJA E ELEMENTËVE TË MJEDISIT**

Në Republikën e Shqipërisë ndalohet importimi i lëndëve dhe mbetjeve të rrezikshme, i mbetjeve dhe mbeturinave të tjera, me qëllim ruajtjeje, depozitimi ose asgjësimi.

Në zbatim të ligjit është miratuar **VKM nr.835, datë 28.12.2005**, “Për miratimin e listës së mbetjeve të rrezikshme, mbetjeve dhe mbeturinave të tjera, që ndalohen të importohen, me qëllim ruajtjeje, depozitimi dhe asgjësimi”.

##### **PROCESI VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS (VNM)**

Në një kapitull të veçantë trajtohet VNM i cili në vija të përgjithshme përcakton detyrimin e subjekteve publike dhe private për hartimin e raportit të VNM për veprimtari që ushtrohen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Dokumentacioni përmban: përshkrimin e projektit, të dhëna për zonën, projektin teknik, përshkrimin e masave për të shmangur, pakësuar dhe rehabilituar pasojat negative në mjedis, të dhënat e nevojshme për identifikimin dhe matjen e ndikimeve që mund të kenë ndaj mjedisit, variante të ndryshme, të dhëna të tjera të kërkuara nga organi përgjegjës.

Vlerësimet të ndikimit në mjedis i nënshtrohen edhe politikave, strategjitë dhe planet e zhvillimit të sektorëve ekonomikë. Po ashtu projektet e sigurisë kombëtare janë objekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis ose të vlerësimit strategjik mjedisor.

Organi përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që lidhen me procedurat e VNM është Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU).

### **LEJA MJEDISORE**

Veprimtaritë e ndryshme ekonomiko-sociale me ndikim në mjedis janë të detyruara të pajisen me leje mjedisore. Kërkesa për lejen mjedisore është e përcaktuar në kapitullin V të LMM.

Në ligj përcaktohet detyrimi për marrjen e lejes mjedisore për të gjitha subjektet publike e private që shfrytëzojnë pasuritë natyrore, zotërojnë impiante, veprimtaria e të cilave ndikon në mjedis.

Për zotërimin e lejes mjedisore subjektet duhet të paraqesin kërkesën dhe dokumentacionin përkatës. Miratimi i kërkesës bëhet me dhënien e:

- a) Deklaratës mjedisore;
- b) Lejes mjedisore;
- c) Pëlqimit ose autorizimit mjedisor.

Në kuadër të decentralizimit të kompetencave dhe krijimit të lehtësirave për subjektet ekonomike, Pëlqimi dhe Autorizimi Mjedisor iu është deleguar Agjencive Rajonale të Mjedisit në qarqe.

### **PARANDALIMI DHE KUFIZIMI I NDOTJES SË MJEDISIT**

Ligji parashikon vendosjen e normave mjedisore, për të parandaluar dhe kontrolluar në përgjithësi ndotjen dhe dëmtimin e mjedisit:

1. për cilësinë e mjedisit dhe shkarkimet në mjedis;

2. norma provizore që aplikohen për objektet ekzistuese që shkarkojnë lëndë ndotëse në mjedis.

Në zbatim të ligjit janë miratuar:

1. VKM nr. 248, datë 24.04.2003, “Për miratimin e normave të përkohshme të shkarkimeve në ajër dhe zbatimin e tyre”.

2. VKM nr. 435, datë 12.09.2002, “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”.

3. VKM nr.177, datë 31.03.2005, “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.

### **MONITORIMI DHE INFORMIMI**

Subjektet publike dhe private janë të detyruara të dorëzojnë pranë Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, ARM-ve dhe Organeve të Qeverisjes Vendore të dhënat e monitorimit.

Organet shtetërore i bëjnë publike këto të dhëna nëpërmjet medias. MMPAU krijon Sistemin Kombëtar të të dhënave mjedisore dhe publikon çdo dy vjet Raportin për Gjendjen e Mjedisit.

Në zbatim të ligjit është miratuar VKM nr.103, datë 31.03.2002, “Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë”.

### **KONTROLI MJEDISOR**

Kapitulli i kontrollit mjedisor përcakton Inspektoriatin e Mjedisit, punonjësit e caktuar nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, si dhe ARM, si organe që ushtrojnë kontrollin mbi gjendjen e mjedisit.

Agjencitë Rajonale të Mjedisit:

1. Agjencitë rajonale të mjedisit janë organe të specializuara për mbrojtjen e mjedisit, të cilat organizohen e veprojnë në nivel qarku.

2. Në zbatim të detyrimeve ligjore, Agjencitë Rajonale të Mjedisit:

a) realizojnë zbatimin e ligjshmërisë për mbrojtjen e mjedisit në nivel vendor;

b) ndihmojnë organet e pushtetit vendor për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit që kanë në juridiksion, bashkëpunojnë për hartimin dhe zbatimin e planeve vendore të veprimit për mjedisin;

c) nxisin përdorimin e teknologjive të pastra dhe futjen e sistemeve të administrimit mjedisor;

ç) marrin pjesë në procesin e miratimit të lejes dhe të deklaratës mjedisore, duke përmbushur detyrat që përcakton Ministri i Mjedisit me udhëzim të veçantë. Japin pëlqimin dhe autorizimin mjedisor për veprimtari vendore;

d) hartojnë dhe paraqesin për miratim në Këshillin e Qarkut raportin dyvjeçar të gjendjes së mjedisit të qarkut. Pas miratimit, ky raport i bëhet i ditur publikut nëpërmjet mediave të shkruara dhe elektronike;

dh) ndër marrin veprimtari ndërgjegjësuese për mjedisin, bashkëpunojnë me bashkësitë, me organizatat jofitimprurëse mjedisore dhe profesionale të biznesit.

## INSPEKTORATI I MJEDISIT

### **Inspektorati i Mjedisit:**

a) ushtron kontroll të vazhdueshëm mbi mjedisin dhe ndaj veprimtarive ndotëse, për të siguruar mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet zbatimit të legjislacionit mjedisor dhe kërkesave të vëna në lejen dhe në deklaratën mjedisore. Kontrollat kryhen nga grupe inspektorësh ose nga një inspektor i vetëm;

b) kërkon pjesëmarrjen e organeve të qeverisjes vendore, të përfaqësuesve të bashkisë, të organizatave jofitimprurëse mjedisore dhe të mediave në kontrollet mbi veprimtaritë ndotëse;

- c) krijon dosjen mjedisore për çdo veprimtari të pajisur me leje mjedisore.
- d) ndihmon personat fizikë e juridikë për të realizuar vetëmonitorimin, verifikimin dhe zbatimin e sistemeve të integruara të administrimit dhe kontrollon zbatimin e tyre;
- e) urdhëron masa të detyrueshme për zbatim për përmirësimin e gjendjes së mjedisit, për pakësimin e ndotjes dhe të dëmtimit të mjedisit;
- f) vë në dijeni rregullisht pushtetin vendor për gjendjen e mjedisit, për veprimtaritë, projektet dhe instalimet e miratuara, sipas kërkesave të këtij ligji;
- g) kontrollon regjistrat e ndotësve, rregulloret e brendshme, teknike e teknologjike dhe dokumentet e tjera që lidhen me veprimtarinë dhe rrezikun e ndotjes;
- h) vendos sanksione, sipas këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore që mbrojnë përbërës të veçantë të mjedisit;
- i) bën publike rezultatet për çdo kontroll të ushtruar.

Veprimtaria kontrolluese e Inspektoratit të Mjedisit pasqyrohet në dokumente standarde të miratuara nga Ministri i Mjedisit.

Inspektoratet e tjera shtetërore dhe Inspektorati i Mjedisit Urban ushtrojnë kontroll për gjendjen e përbërësve të veçantë të mjedisit.

### **DETYRAT E ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE**

Organet e qeverisjes vendore përfaqësojnë strukturën më të rëndësishme shtetërore për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit, që kanë në juridiksion, duke zbatuar përgjegjësitë, të drejtat e detyrat që u jep Ligji nr.8652, datë 31.07.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore". Në mbrojtje të mjedisit, ato kanë për detyrë:

- a) të realizojnë zbatimin e ligjeve për mbrojtjen e mjedisit;
- b) të hartojnë plane vendore për mbrojtjen e mjedisit dhe planet e rregullimit të territorit;

- c) të bëjnë publike programet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit;
- d) të njoftojnë publikun për gjendjen e mjedisit dhe për veprimtaritë vendore, subjekte të vlerësimit të ndikimit ndaj mjedisit;
- e) të nxisin e të mbështesin veprimtaritë e organizatave jofitimprurëse për mjedisin, duke tërhequr mendimin e tyre në vendim-marrjet për mjedisin;
- f) të përcaktojnë vendet e grumbullimit e të përpunimit të mbeturinave prodhuese dhe jetësore, në përputhje me kriteret mjedisore dhe planet e zhvillimit;
- g) të organizojnë depozitimin e mbetjeve dhe të lëndëve të rrezikshme dhe ruajtjen e zonave të gjelbra në qendrat qytetëse dhe rreth tyre;
- h) të administrojnë mbeturinat qytetëse, impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura dhe të mbeturinave të ngurta;
- i) të disiplinojnë transportin dhe ndërtimet në mjediset qytetëse.

### **DETYRAT E ORGANEVE SHETETËRORE PËR MJEDISIN**

Organet shtetërore kryejnë detyrat për mbrojtjen e mjedisit në bazë të përcaktimit të përgjegjësive dhe ndarjes së qartë të tyre ndërmjet organeve qendrore dhe vendore, duke zgjeruar në vazhdimësi detyrat e organeve të qeverisjes vendore.

#### **6.1.2. LIGJI NR. 8990, DATE 23.01.2003,**

#### **“PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS”**

### **VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS**

Procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis i nënshtrohen të gjitha projektet dhe veprimtaritë, që jepen në shtojcat e këtij ligji, përpara miratimit të tyre nga organet përkatëse.

Projektet dhe veprimtaritë i nënshtrohen dy niveleve të shqyrtimit për vlerësimin e këtij ndikimi:

- a) procesit të thelluar të ndikimit në mjedis;
- b) procesit të përmbledhur të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Raportet e vlerësimit të ndikimit në mjedis duhet të përgatiten nga persona fizikë ose juridikë të licencuar, të cilët janë përgjegjës për saktësinë e të dhënave dhe rekomandimeve të bëra.

**VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR (VSM)** kërkohet për:

- a) strategjitë, planet e veprimit për sektorët e zhvillimit ekonomik dhe menaxhimin e mbetjeve.
- b) planet kombëtare dhe rajonale të rregullimit të territorit për qendrat dhe zonat urbane dhe rurale, zonat industriale, zonën bregdetare, zonat e mbrojtura.

**VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR I NËNSHTROHEN:**

- a) strategjitë e planet e veprimit për energjetikën, minierat, industrinë, transportin, bujqësinë, pyjet, për administrimin e burimeve natyrore dhe të pasurive minerale dhe për administrimin e mbeturinave;
- b) planet kombëtare dhe rajonale të rregullimit të territorit për qendrat e zonat urbane dhe rurale, për zonat industriale, për zonën bregdetare, për zonat turistike, për zonat e mbrojtura dhe zonat me ndjeshmëri të lartë ndaj ndotjes dhe dëmtimit.



**6.1.3. LIGJI NR. 9010, DATE 13.02.2003, “PËR ADMINISTRIMIN  
MJEDISOR TË MBETJEVE TË NGURTA”**

**DETYRAT E ORGANEVE SHETËRORE:**

1. MMPAU në bashkëpunim me ARM dhe Inspektoratin e Mjedisit organizojnë punën për funksionimin e procesit të administrimit mjedisor të mbetjeve dhe kontrollojnë zbatimin e tij në të gjitha nivelet;
2. Organet shtetërore, qendrore e vendore, në bashkëpunim me MMPAU kanë për detyrë:
  - a. hartimin e planeve kombëtare dhe lokale për administrimin mjedisor të përcaktimit mbetjeve;
  - b. hartimin e metodologjisë për trajtimin mjedisor të mbetjeve, në përputhje me llojin e natyrën e tyre;
  - c. sigurimin dhe përdorimin e efektshëm të mjeteve të nevojshme financiare;
  - d. kontrollin e vazhdueshëm mbi veprimtaritë që krijojnë mbetje, si dhe mbi ato që angazhohen në transportimin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin e tyre në fushat e sektorët që mbulojnë.

**PARANDALIMI I NDOTJES NGA MBETJET E NGURTA:**

Ndër veprimet e ndaluara sipas këtij ligji do të veçonim:

- Braktisjen
- Depozitimin/përpunimin në vende të pamiratuara nga organet përgjegjëse;
- Importimin e mbetjeve për qëllime ruajtjeje, depozitimi dhe asgjësimi;
- Administrimi i mbetjeve nga subjekte të palicensuara;
- Djegia në natyrë, përfshirë vetëdjegien.

### **TRAJTIMI I MBETJEVE SIPAS LLOJIT:**

Në zbatim të këtij ligji, gruposja e mbetjeve është etapa e fundit, së cilës i nënshtrohen të gjitha mbetjet. Përfshihen nga gruposja:

- Mbetjet e lëngëta
- Mbetjet eksplozive dhe oksiduese
- Mbetjet e përflakshme
- Mbetjet spitalore dhe infektive
- Gomat e përdorura të automjeteve

Në zbatim të ligjit është miratuar **VKM nr. 99, datë 18.02.2005, “Për miratimin e Katalogut Shqiptar të Mbetjeve”**.

### **LEJA MJEDISORE:**

Personat fizikë dhe juridikë që menaxhojnë mbetjet duhet të pajisen me leje mjedisore.

### **MONITORIMI I ADMINISTRIMIT TË MBETJEVE:**

Monitorimi i mbetjeve bëhet bazuar në Programin Kombëtar të Monitorimit dhe përfshin të gjitha fazat e procesit të administrimit të tyre.

Personat fizikë dhe juridikë, të cilët krijojnë ose administrojnë mbetje, janë të detyruar të kryejnë monitorimin e tyre dhe të publikojnë rezultatet.

Të drejtën e kontrollit për veprimtaritë që lidhen me administrimin e mbetjeve e ka IM, organi që ka licencuar veprimtarinë, Inspektorati Sanitar Shtetëror dhe Inspektorati Mjedisit Urban. Këto dy të fundit kontrollojnë administrimin e mbetjeve në të gjitha fazat.

### **SANKSIONET:**

Për rastet kur shkeljet e dispozitave të këtij ligji përbëjnë vepër penale IM bën kallëzim për ndjekje penale. Për një kategori shkeljesh të dispozitave të këtij ligji që nuk përbëjnë vepër penale, trajtohen si kundravajtje administrative.

#### **6.1.4. LIGJI NR. 9115, DATE 24.07.2003,**

##### **“PËR TRAJTIMIN MJEDISOR TË UJËRAVE TË NDOTURA”**

Në nenin 4 përcaktohen detyrat e organeve shtetërore sipas këtij ligji, të cilat konsistojnë:

1. MM, ARM dhe IM, krahas organeve të tjera të ngarkuara me ligj për administrimin e rezervave ujore, ndihmojnë në funksionimin e procesit të trajtimit të ujërave të ndotura dhe kontrollojnë zbatimin e tij.

2. Organet shtetërore qendrore dhe vendore, secila në linjën e vet, bashkëpunojnë me MMPAU për:

a) Përcaktimin e teknikave, teknologjive dhe metodave më të mira të mundshme për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura, në përputhje me llojin dhe natyrën e tyre;

b) Hartimin e planeve për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura në mënyrë të integruar, si pjesë e planeve të menaxhimit të pellgjeve ujëmbledhës përkatës;

c) Krijimin e kuadrit ligjor bashkëkohor, për trajtimin e ujërave të ndotura dhe të përdorura;

d) Përsosjen e rrjetit institucional përgjegjës;

e) Sigurimin dhe përdorimin e frytshëm të mjeteve të nevojshme financiare;

f) Kontrollin e vazhdueshëm të veprimtarive që shkaktojnë ndotje të ujërave, si dhe subjekteve që angazhohen në pastrimin e tyre.

#### **PARANDALIMI I NDOTJES SË UJËRAVE DHE PAKËSIMI I UJËRAVE TË NDOTURA.**

Në synimet e trajtimit mjedisor të ujërave të ndotura bëjnë pjesë:

- pakësimi i sasisë së ujërave të ndotura që gjenerohen nga veprimtaritë prodhuese dhe shkalla e ndotjes së këtyre ujërave;
- nëpërmjet përdorimit të teknikave dhe teknologjive më të mira;
- shkurtimin e kohës së ekspozimit të tyre në mjedis;
- trajtimin paraprak për të lehtësuar trajtimet e mëtejshme;
- si dhe pastrimin e tyre sa më pranë burimit që i formon ato.

Për plotësimin e detyrimeve përkatëse subjektet në çdo rast duhet të hartojnë programe masash teknike, teknologjike dhe organizative, të cilat kontrollohen nga IM, organi që ka licencuar veprimtarinë e tyre, si dhe nga strukturat e organeve të qeverisjes vendore.

Personat fizikë dhe juridikë që trajtojnë ujërat e ndotura janë të detyruar të përdorin teknika të përshtatshme dhe ujërat e shkarkimit të plotësojnë kërkesat e standardeve për këtë qëllim. Ata janë përgjegjës për dëmtimet e shkaktuara në shëndetin e njeriut dhe mjedisin rrethues.

### **TRAJTIMI I UJËRAVE TË NDOTURA SIPAS LLOJIT**

Në trajtimin e ujërave të ndotura përfshihen ujërat e ndotura industriale, nga objekte të veçanta ose zona industriale dhe ujërat e ndotura urbane. Këtu, përcaktohen detyrimet e subjekteve që shkarkojnë ujëra të ndotura nga veprimtari industriale, për trajtimin paraprak të tyre dhe atë përfundimtar, në përputhje me specifikat dhe tipet e industrisë.

Në zonat industriale ndërtohen impiante pastrimi të ujërave të ndotura, në varësi të kapaciteteve dhe specifikave që kanë përbërjet e ujërave të ndotura në zonën industriale.

Trajtimi i ujërave të ndotura urbane konsiston në pastrimin mjedisor paraprak, i cili përfshin rrjetin e kanalizimeve në zonat urbane dhe rurale, trajtimin e tyre të ndarë nga shkarkimet e tjera të lëngëta, ndërtimin dhe funksionimin e impiantit të trajtimit të tyre para shkarkimit në ujërat sipërfaqësore, si dhe shkallën e trajtimit të tyre, e cila duhet të jetë në përputhje me veçoritë e mjedisit pritës.

### **LEJA MJEDISORE**

Leja mjedisore aplikohet për subjektet që krijojnë ujëra të ndotura dhe për ato që pastrojnë ujërat e ndotura. Në rastin e parë subjekti duhet, ndër të tjera, të respektojë normat e shkarkimeve të lëngëta, mbajtjen e regjistrave, kryerjen e monitorimit dhe publikimin e rezultateve.

Për subjektet që pastrojnë ujërat e ndotura kërkohet: përcaktimi i vendit të ndërtimit të impiantit të pastrimit sipas kërkesave dhe kushteve të caktuara, lloji i impiantit apo impianteve që do të përdoren, mjedisi pritës dhe regjimi i shkarkimit në të, trajtimi mjedisor i llumrave që rezultojnë nga impianti i pastrimit, mbajtja e regjistrave, monitorimi dhe publikimi i rezultateve.

### **MONITORIMI**

Të gjitha subjektet që shkarkojnë ujëra të ndotura si dhe ato që pastrojnë ujërat e ndotura, organizojnë monitorimin e veprimtarive të tyre, duke i mbuluar vetë shpenzimet për këtë qëllim. Monitorimi i realizohet në të gjitha fazat e trajtimit të ujërave të ndotura, përfshirë edhe mjedisin pritës.

### **KONTROLLI**

Për kontrollin e respektimit të rregullave dhe të kërkesave për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura, si dhe të normave të shkarkimeve të lëngët, sipas nenit 21 të Ligjit, ngarkohet IM, Inspektorati Sanitar Shtetëror dhe Inspektoratet Bashkiake.

### **VEPRIMET E NDALUARA**

Në veprimet e ndaluara në territorin e RSH përfshihen shkarkimet përtej normave të lejuara, trajtimi i ujërave nga persona të palicënsuar, përdorimi i ujërave të ndotura për qëllime të tjera, shkarkimi i tyre në ujërat sipërfaqësorë etj.

Këto veprime si dhe moskryerja e monitorimit, mungesa e regjistrave dhe mosdhënia dhe mospublikimi i informacionit, përbëjnë kundravajtje administrative, për të cilat IM vendos gjoba nga 100 000 deri në 1 000 000 lekë. Kur shkeljet e këtij ligji përbëjnë vepër penale, sipas kapitullit “Vepra penale kundër mjedisit” të Kodit Penal, IM bën kallëzimin për ndjekje penale.

#### **6.1.5. LIGJI NR. 9108, DATE 17.07.2003,**

#### **“PËR SUBSTANCAT DHE PREPARATET KIMIKE”**

Sipas këtij ligji substancat dhe preparatet kimike klasifikohen në:

- Eksplozive
- Oksiduese
- Ekstremisht të ndezshme
- Shumë të ndezshme
- Të ndezshme , me pikë flakërimi 21-51°C.
- Shumë helmuese
- Të dëmshme për shëndetin
- Korrozive
- Irrituese
- Sensibilizuese
- Kancerogjene
- Mutagjene
- Dëmtuese për riprodhim
- Të rrezikshme për mjedisin.

Vetitë e rrezikshme të substancave dhe preparateve, sipas këtij ligji, testohen vetëm nga persona juridikë ose fizikë, të autorizuar, të cilët janë të pajisur me certifikatë si laborator i akredituar për këtë qëllim.

**6.1.6. LIGJI NR. 8905, DATË 06.06.2002,**  
**“PËR MBROJTJEN E MJEDSIT DETAR NGA NDOTJA DHE**  
**DËMTIMET”**

**NË MJEDISIN DETAR NDALOHE:**

1. hedhja e lëndëve dhe e mbetjeve të rrezikshme, helmuese e plasëse;
2. hedhja e substancave dhe e lëndëve të përcaktuara në Aneksin I, që i bashkëlidhet këtij ligji;
3. derdhja e hidrokarbureve dhe e ujërave të ndotura;
4. hedhja e lëndëve dhe e materialeve të ngurta, të çfarëdo natyre dhe lloji, me përjashtim të mjeteve e pajisjeve të peshkimit dhe të lëndëve e mjeteve të nevojshme për ndërtimin e porteve, pontileve e konstruksioneve të tjera, sipas projekteve të miratuara nga Ministria e Mjedisit dhe në kushtet e përcaktuara prej saj;
5. hedhja e mbeturinave dhe e çdo lloj lënde nga anijet, platformat, instalimet dhe nga bregdeti;
6. transportimi i lëndëve dhe i mbetjeve të rrezikshme;
7. fundosja e anijeve, e ngarkesave dhe e mallrave të çdo lloji e tipi;
8. fundosja dhe braktisja e çdo lloj instalimi, që ka shërbyer për veprimtari të ndryshme;
9. ndërtimi dhe vënia në funksionim e pajisjeve që lëshojnë rrezatim jonizues;
10. djegia e lëndëve dhe e materialeve të çdo lloji;
11. hyrja në porte me ballaste të papastra e mjeteve detare të çfarëdo lloji, tipi e tonazhi.

Largimi i mbeturinave dhe i hidrokarbureve të përdorura, që rrjedhin nga kryerja e veprimtarive në mjedisin detar, bëhet nga persona fizikë e juridikë të specializuar për pastrim, të pajisur me leje mjedisore dhe që përdorin teknologjitë më të mira të mundshme për pastrim.

Personat juridikë e fizikë, që ushtrojnë veprimtari në mjedisin detar, si dhe anijet, para hyrjes në port, dorëzojnë mbeturinat dhe hidrokarburet e përdorura te subjekti pastrues i licencuar.

### **NJOFTIMI I NDOTJES**

Çdo person ka detyrimin ligjor për të njoftuar kapitanerinë e portit ose organin shtetëror më të afërt, për konstatimin e ndotjes së mjedisit detar.

Lidhur me sa më sipër kapitaneria kryen verifikimin e njoftimit dhe vë në dijeni Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit, MMPAU, si dhe qeverisjen vendore në territorin, ku ka ndodhur ndotja.

### **PASTRIMI I NDOTJES**

Në nenin 14 përcaktohet përgjegjësia dhe detyrimi i personit fizik ose juridik, që ka shkaktuar ndotjen e mjedisit detar, për pastrimin e zonën së ndotur, sjelljen e saj në gjendjen e mëparshme, si dhe shpërblimin e dëmit.

### **SANKSIONET**

Ndaj subjektit që ushtron veprimtari të ndaluara nga neni 6 i këtij ligji, kur këto veprimtari përbëjnë vepër penale, IM bën kallëzimin për ndjekje penale.



### **6.1.7. LIGJI NR. 9103, DATË 10.07.2003,**

#### **“PËR MBROJTJEN E LIQENEVE NDËRKUFITARE”.**

Për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare janë të detyruar të zbatojnë dispozitat e këtij ligji:

- personat fizikë e juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, që shfrytëzojnë pasuritë ujore, natyrore dhe biologjike të liqenit e të pellgut ujëmbledhës, ose ushtrojnë veprimtari të ndryshme në to;
- personat fizikë e juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, veprimtaritë e të cilëve janë të vendosura në pellgun ujëmbledhës dhe që me veprimtarinë e tyre mund t’u shkaktojnë dëmtime liqeneve.

#### **DETYRAT E ORGANEVE SHETËRORE**

Sipas nenit 5, ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave që, në bashkëpunim me organet shtetërore qendrore e vendore dhe me autoritetet e ujit, secili në linjën e vet, të organizojnë punën për mbrojtjen mjedisore të liqeneve ndërkufitare, të kontrollojnë zbatimin e kërkesave të këtij ligji dhe të marrin pjesë:

- |  |
|--|
| <ul style="list-style-type: none"><li>a) në hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit të liqeneve ndërkufitare;</li><li>b) në hartimin dhe zbatimin e programeve të veçanta të monitorimit;</li><li>c) në hartimin dhe zbatimin e planeve vendore për rehabilitimin e pjesëve të ndotura e të dëmtuara të liqeneve ndërkufitare;</li><li>d) në krijimin e kuadrit ligjor, bashkëkohor, për administrimin dhe mbrojtjen mjedisore të tyre;</li><li>e) në sigurimin dhe përdorimin e frytshëm të mjeteve të nevojshme financiare;</li><li>f) në kontrollin e vazhdueshëm për të siguruar ruajtjen e gjendjes natyrore të liqeneve ndërkufitare dhe të faunës e florës së tyre.</li></ul> |
|--|

### **VEPRIME TË NDALUARA**

Në liqenet ndërkufitare dhe pellgjet e tyre ujëmbledhëse janë të ndaluara:

- g) hedhjet ose depozitimet e lëndëve dhe të mbetjeve të rrezikshme;
- h) shkarkimet e ujërave të ndotura e të patrajuara urbane, industriale, bujqësore dhe të çdo veprimtarie njerëzore;
- i) depozitimet dhe hedhjet e mbetjeve të çdo lloji;
- j) ndërtimi e funksionimi pranë tyre i vend-depozitimeve të mbetjeve dhe i vend-grumbullimeve të minierave e degëve të industrisë përpunuese;
- k) betonimet në breg, që ndërpresin komunikimet e shumëfishta ndërmjet ujit dhe tokës;
- l) ndërtimi i godinave, i instalimeve dhe i çdo formacioni inxhinierik në breg dhe brenda zonës së ndaluar për ndërtime;
- m) marrja e rërës, e zhavorreve dhe e çdo materiali tjetër të brigjeve dhe të cektinave të liqeneve, siç përcaktohet në Ligjin nr.8093, datë 21.03.1996, "Për rezervat ujore";
- n) çelja e guroreve, ndërtimi i furrave të gëlqeres, instalimi i impianteve të asfalto-betonit pranë zonave urbane dhe në vende që dëmtojnë peizazhin e zonës;
- o) shfrytëzimi i ujit të liqeneve pa leje dhe jashtë kushteve të vëna në licencë;
- p) prerja e pakontrolluar e pemëve dhe e pyjeve;
- q) shfrytëzimi pa kriter i kullotave dhe djegia e tyre;
- r) ushtrimi i peshkimit dhe i gjuetisë jashtë sezoneve e kalendarëve përkatës dhe me metoda, mënyra dhe mjete të ndaluara me ligj;
- s) mbledhja e bimëve mjekësore, tarnifere dhe eterovajore me mënyra, metoda e në periudha të ndaluara;

- t) mbledhja e kërmijve, bretkosave, breshkave e reptilëve me mënyra, metoda dhe në periudha të ndaluara;
- u) kapja për qëllime tregtimi e peshqve, kafshëve dhe shpendëve të rralla dhe të rrezikuara;
- v) futja në liqen dhe në zonën ujëmbledhëse e gjallesave (peshq, kafshë, shpendë, bimë) të popullatave jovendase.

### **SANKSIONET**

Për zbatimin me rigorozitet të ligjit parashikohen edhe një numër sanksionesh, për shkeljen e të cilave, në rastin e veprave penale, IM dhe Administrata e Liqenit bëjnë kallëzim për ndjekje penale. Krahas gjobës IM mund të vendosë edhe për mbylljen e përkohshme ose të përhershme të veprimtarisë së subjektit që ka shkelur ligjin, bazuar në shkallën e ndotjes ose dëmtimit të shkaktuar.

### **6.1.8. LIGJI NR. 9385, DATË 04.05.2005,**

#### **“PËR PYJET DHE SHERBIMIN PYJOR”, I NDRYSHUAR**

### **HEQJA E SIPËRFAQEVE (TOKAVE) NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR**

Pjesë të fondit pyjor kombëtar, që kërkohen nga subjekte juridike ose fizike, apo nga organet e qeverisjes vendore, për t’u kthyer në truall, për ndërtimin e strukturave turistike, të qendrave të pushimit apo shëndetësore, për zgjerimin e vijës kufizuese të ndërtimit dhe të shtrirjes territoriale të periferisë së qytetit dhe të qendrave të banuara në zonat rurale, ose për qëllime të tjera publike, për rrugë automobilistike ose hekurudhore, për shpim dhe shfrytëzim të puseve të naftës e të gazit, për veprimtari minerare e gjeologjike, për aeroporte dhe struktura të telekomunikacionit, për qëllime të strukturave ushtarake e qendrave industriale, për gurore e karriera, hiqen nga fondi pyjor dhe nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve, si më poshtë:

- a) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe deri në

30 ha, me miratimin e Këshillit të Ministrave;

b) pyjet dhe tokat me bimësi pyjore, me sipërfaqe mbi 30 ha, me ligj të veçantë.

### **RUAJTJA E FONDIT PYJOR KOMBËTAR**

Republika e Shqipërisë zbaton parimet dhe normat e konventave, të marrëveshjeve e traktateve ndërkombëtare, në të cilat është palë, si dhe merr parasysh, njeh dhe respekton parimet dhe normat përgjithësisht të pranura të së drejtës ndërkombëtare për pyjet.

Ruajtja e pyjeve dhe e mjedisit pyjor nga ndotja dhe dëmtimi me lëndë të gazta, të lëngëta, të ngurta, radioaktive, lëndë dhe mbetje të rrezikshme, që krijohen ose shkarkohen nga objekte a veprimtari industriale, bujqësore, komunale, tregtare, shoqërore e kulturore, ushtarake, të transportit ose nga veprimtari të tjera, që cenojnë ekuilibrin e sistemeve ekologjike, natyrore ose dëmtojnë të mirat materiale dhe vlerat kulturore e historike, është e detyrueshme për të gjitha organet shtetërore, të pushtetit vendor dhe për personat fizikë a juridikë, vendas e të huaj.

Personat fizikë a juridikë, që kanë në pronësi, në administrim ose në përdorim pyje, grumbuj drurësh ose dru pyjorë, brenda ose jashtë fondit pyjor kombëtar, janë të detyruar të sigurojnë mbrojtjen e tyre.

Në rast se në fondin pyjor, ose në një pjesë pylli, dhe në shkurre bie zjarr, organet e shërbimit pyjor, organet e njësive të qeverisjes vendore, çdo subjekt shtetëror a privat, njësi apo repart ushtarak, shkollë, institucion publik e privat, si dhe çdo shtetas kanë detyrë të njoftojnë dhe të marrin pjesë për shuarjen e tij.

### **ADMINISTRIMI DHE ZHVILLIMI I FONDIT PYJOR NË PRONËSI TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE**

Administrimi dhe zhvillimi i pyjeve vendore apo i pjesëve të tyre, bëhen sipas planeve të mbarështimit dhe të dispozitave të këtij ligji.

Për një administrim të qëndrueshëm e shumëfunksional të fondit pyjor vendor, për rregullimin e përdorimit e të shfrytëzimit të pyjeve, të kullotave dhe të burimeve të tjera pyjore e jopyjore, për mbrojtjen nga zjarri, dëmtuesit etj., brenda territorit administrativ të njësive të qeverisjes vendore krijohen njësitë tekniko-administrative, në varësi të drejtpërdrejtë të organeve të qeverisjes vendore.

Strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Pyjor ndihmojnë, kontrollojnë, këshillojnë dhe sigurojnë mbështetjen teknike për këto njësi dhe për shoqatat e përdoruesve të pyjeve.

Organet e qeverisjes vendore kanë për detyrë të marrin masa dhe të planifikojnë fonde për investimet në pyjet, në territorin që ata mbulojnë, për përmirësimin dhe planifikimin e mbledhjes e të promovimit të pajisjeve të reja të përpunimit dhe të tregtimit të prodhimeve pyjore, si dhe për krijimin e sektorit të agro-pylltarisë.

Shteti mbështet nismat individuale a kolektive të njësive të qeverisjes vendore për shtimin e sipërfaqes së pyjeve, për ripyllëzimin e tokave të braktisura, të zhveshura, të shpyllëzuara dhe të gërryera, në pronësi të tyre, nëpërmjet sistemit të kredive me kushte lehtësuese.

Njësia e qeverisjes vendore, çdo vit, nga të ardhurat e realizuara planifikon fonde për ruajtjen, mirëmbajtjen, kryerjen e punimeve silvikulturore dhe përgjigjet për trajtimin shkencor të tyre. Vjelja e materialit drusor dhe e prodhimeve të tjera nga pyjet vendore bëhet në përputhje me këtë ligj.

## **6.2. DOSJA MJEDISORE PËR PROJEKTET E INFRASTRUKTURËS VENDORE**

Për t'u pajisur me autorizim mjedisor, propozuesi përgatit dhe dorëzon në ARM-në e qarkut ku do të ushtrojë veprimtarinë, dosjen me dokumente në përputhje me kërkesat e **VKM Nr. 249, datë 24.04.2003, "Për miratimin e dokumentacionit për leje mjedisore dhe të elementeve të lejes mjedisore"** dhe konkretisht:

a) KËRKESËN drejtuar ARM-së, të hartuar sipas formatit të përcaktuar në aneksin 3 të këtij udhëzimi.

b) FOTOKOPJE të vendimit të gjykatës, që e ka regjistruar propozuesin si person fizik ose juridik.

c) DOKUMENTET TEKNIKE, që përshkruajnë veprimtarinë që do të ushtrohet dhe vendin ku do të instalohet (projekti, skica, planimetria, foto etj.), të përgatitura nga ekspertë të licencuar.

d) RAPORTIN E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS të veprimtarisë, të hartuar nga specialistë të çertifikuar e të licencuar.

e) DOKUMENTE që vërtetojnë se subjekti ka diskutuar me komunitetin e OJF-të lokale dhe se këto janë dakord me zhvillimin e veprimtarisë.

f) PROGRAMIN E MONITORIMIT të veprimtarisë që do të ushtrohet.

Për t'u pajisur me pëlqim mjedisor, propozuesi përgatit dhe dorëzon në ARM-në e qarkut ku do të ushtrojë veprimtarinë:

a) KËRKESËN, drejtuar ARM-së për t'u pajisur me pëlqim mjedisor.

b) DOKUMENTET TEKNIKE, që përshkruajnë veprimtarinë që do të ushtrohet dhe vendin ku do të instalohet (projekti, plan vendosja e të tjera).

c) RAPORT TË SHKURTËR TË VLERËSIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS të veprimtarisë, ku të jenë të identifikuara ndikimet kryesore dhe masat e propozuara për minimizimin dhe eliminimin e tyre.

### 6.3. VEPRIMTARITË VENDORE QË PAJISEN ME AUTORIZIM MJEDISOR

Pikat 14, 15, dhe 16 janë për Strukturat Mjedisore të Organeve të Qeverisjes vendore.

1. Punishte e vogël prodhimi ëmbëlsirash;
2. Pikë shërbimi për automjete;
3. Distributor për mbushje gazi GLN, kapaciteti deri 5 m<sup>3</sup>;
4. Pikë për larje e pastrim mjetesh;
5. Pikë për shitje karburanti me pakicë deri 50 000 litra;
6. Sharrim i lëndës drusore, trupa (sharra dhe garda);
7. Shfrytëzim pyjesh;
8. Punishte përpunim druri, mobilieri, tapiceri deri 1 000 m<sup>3</sup>/vit;
9. Punishte e vogël përpunimi dhe ambalazhimi uji natyral mineral;
10. Punishte e vogël prodhimi lëngje frutash, pije freskuese;
11. Punishte e vogël prodhimi pije alkolike;
12. Furra të prodhimit të bukës;
13. Prodhim birre deri 100 000 litra/vit;
14. Kanalizime të ujërave të zeza dhe rehabilitime të tyre deri në 2 km;
15. Ujësullës dhe rehabilitime të tyre deri në 2 km;
16. Ndërtim dhe rikonstruksion rrugësh deri 2 km;
17. Prodhim konfeksione, trikotazhe;
18. Punishte për përpunim qumështi deri 10 kv/ditë;
19. Punishte për përpunim vaji luledielli;

20. Përpunim ulliri;
21. Thertore deri 5 kv/ditë;
22. Punishte përpunimi fruta perime;
23. Studio fotografike;
24. Prodhim gëlqereje (shuarja) deri 100 ton/vit;

#### **6.4 VEPRIMTARITË VENDORE QË PAJISEN ME PËLQIM MJEDISOR**

- 1) Objekte të veçanta banimi;
- 2) Objekte të veçanta social-kulturore:
  - a) Hotele;
  - b) Shkolla;
  - c) Kopshte;
  - d) Teatro;
  - e) Kinema;
- 3) Lokale shërbimi (bare, restorante, diskoteka e të tjera);
  - a) Farmaci;
  - b) Laboratorë;
- 4) Pika të vogla shërbimesh dhe tregtimi;



**6.5. URDHËR I PËRBASHKËT PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË  
BRENDSHME “TIP” TË POLICISË BASHKIAKE E TË KOMUNËS**

Plani i vendosjes së efektivave të policisë në shërbim

Nr	Vendi i vendosjes në shërbim	Koha e shërbimit	Nr.i personave në shërbim	Detyrat që do të kryhen lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik
1.	Spektori i shërbimit _____përfshin Rruga nr.1,2,3,4,5, ..... Stacioni urban 1,2,3,4,5 ..... Qendra e biznesit 1, 2, 3 ..... Kontrolli i mbylljes së lokaleve sipas orareve	16 orë (2x8)	8 (4x2)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- ruajtjen e qetësisë</li> <li>- mbrojtjen e mjedisit urban nga ndotja</li> <li>- të parandalojë hedhjen e mbeturinave jashtë vendeve të përcaktuara</li> <li>- të kontrollojë automjetet e firmave të ndërtimit nga dalja e kantierit, në rrugë dhe në destinacionin e lejuar të hedhjes</li> <li>- zbatimin e rregullave në parkimet e përkohshme të automjeteve</li> <li>- të mbikëqyrë lulishtet nga dëmtimet e mundshme</li> <li>-të kontrollojë lokalet, baret e diskotekat për orarin e tyre dhe nivelin e zhurmave</li> </ul>
2.				Verifikimi i ankesave të qytetarëve

## **6.6.LISTË REFERUESE BOTIMESH**

### **PËR ÇËSHTJE TË MJEDISIT**

- Raport për Gjendjen e Mjedisit, 1995-2002;
- Përmbledhje aktesh mjedisore kombëtare dhe ndërkombëtare (1, 2, 3);
- Përmbledhje e Legjislacionit Mjedisor Shqiptar;
- Vlerësimi shëndetësor i banorëve në zonat e ndotura industriale dhe urbane. Ndikimi i ndotjes së mjedisit në shëndetin e policëve të Trafikut Rrugor në Tiranë;
- Vlerësimi shëndetësor i banorëve në zonat e ndotura industriale dhe urbane. Ndikimi i ndotjes së mjedisit të punës në shëndetin e punëtorëve të Industrisë Metalurgjike në Elbasan;
- Vlerësimi shëndetësor i banorëve në zonat e ndotura industriale dhe urbane. Ndikimi i ndotjes së mjedisit në shëndetin e banorëve të zonës së Porto-Romanos;
- Një mjedis më i mirë për fëmijë të shëndetshëm;
- Manual i Inspektoriatit të Mjedisit;
- Buletini mjedisor;
- Raport për monitorimin e Ajrit, Ujërave dhe Zhurmës, 2005;
- Indikatorët Kombëtarë për monitorimin e mjedisit;
- Zonat e mbrojtura sipas rretheve dhe kategorive menaxhuese;
- Liqeni I Ohrit dhe Ujëmbledhësi I tij, Raport I Situates Mjedisore;
- Planet lokale të veprimit për mjedisin (Korçë, Pogradec).

Për më shumë, vizitoni Web - site e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave në adresën: [www.moe.gov.al](http://www.moe.gov.al) dhe

për aktet ligjore faqen Web të Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

#### **6.7. PËRCAKTIME TË TERMAVE KRYESORE NË FUSHEN E MJEDISIT**

- “Mjedis” është bashkësia e ndërveprimeve të përbërësve biotikë dhe jobiotikë, që nxisin dhe ushqejnë jetën e gjallë në tokë, duke përfshirë mjedisin biofizik natyror të ajrit, të tokës, të ujërave, larminë e ekosistemeve biologjike, shëndetin e njeriut, vlerat dhe trashëgimitë kulturore, shkencore, fetare e shoqërore.

- “Mbrojtja e mjedisit ” është veprimtaria që synon parandalimin dhe kufizimin e ndotjes, të degradimit të mjedisit, përtëritjen, ruajtjen dhe përmirësimin e tij.

- “Ndotja e mjedisit” është futja e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e lëndëve, vibracioneve, energjisë, nxehtësisë, rrezatimit, zhurmës e faktorëve biologjikë në ajër, në ujë e në tokë, të cilat mund të ndryshojnë cilësitë e mjedisit dhe të dëmtojnë cilësinë e jetës.

- “Dëmtimi i mjedisit” është prishja e karakteristikave fiziko-kimike dhe strukturore të ekosistemit natyror, ulja e prodhimit biologjik dhe shumëllojshmërisë së ekosistemeve natyrore dhe antropike, prishja e ekuilibrit ekologjik dhe cilësisë së jetës, të shkaktuara kryesisht nga ndotja e ujit, ajrit, tokës prej veprimtarive njerëzore ose fatkeqësive natyrore, si dhe nga mbishfrytëzimi i burimeve natyrore dhe minerare.

- “Shkarkimi në mjedis” është çlirimi dhe dalja në mjedis, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e lëndëve të gazta, të ngurta, të lëngëta, si dhe energjisë, vibracioneve e zhurmave, nga një ose disa burime të palëvizshme, në lëvizje ose të shpërndara.

- “Lëndë të rrezikshme” janë ato lëndë, prodhimi, transporti, ruajtja, përdorimi e shkarkimi i të cilave në mjedis, si rezultat i vetive të tyre, dëmtojnë ose mund të dëmtojnë shëndetin e njeriut, cilësitë e mjedisit, florën, faunën, biocenozat dhe biotopet.

- “Mbetje” janë lëndët, objektet ose pjesë të tyre, që përcaktohen nga autoriteti përgjegjës, të cilat nuk përdoren më ose që pronari do t'i largojë. Mbetjet vlerësohen si të tilla, për sa kohë që materialet e nxjerra prej tyre ose energjia e prodhuar nuk përfshihet në procesin e prodhimit.

- “Mbetje të rrezikshme” janë mbeturinat toksike gërryese, ngacmuese, shpërthyes, të përflakshme, kancerogjene, infektive dhe radioaktive, që kanë vetinë të prishin gjendjen natyrore të ujit, tokës dhe ajrit, me pasoja negative për shëndetin e njeriut dhe për ekosistemet natyrore.

- “Treguesi mjedisor” është një ndryshore që jep në mënyrë të përmbledhur dhe të thjeshtë të dhëna për një dukuri mjedisore, duke e bërë atë të perceptueshme nëpërmjet dhënies së një vlere numerike, matjes dhe komunikimit. Dukuritë mjedisore lidhen me cilësitë e mjedisit e të përbërësve të tij, shkarkimet në mjedis, ndotjen e mjedisit e dëmtimin e tij, biodiversitetin dhe shkallën e dëmtimit ose të ruajtjes së tij dhe masat e marra për mbrojtjen e mjedisit.

- “Monitorimi i mjedisit” është grumbullimi, vlerësimi dhe përgjithësimi i të dhënave mjedisore me anë të vëzhgimit, të vazhduar ose periodik, të një grupi treguesish mjedisorë, cilësorë dhe sasiorë, që karakterizojnë përbërësit e mjedisit dhe ndryshimet e tyre nga ndikimi i faktorëve natyrorë dhe njerëzorë.

- “Veprimtari që ndikon në mjedis” është çdo veprimtari ekonomike e shoqërore, që përdor mjedisin ose përbërës të tij ose që shkarkon në mjedis lëndë dhe energji, duke ndryshuar cilësitë e tij.

- “Ndikimi në mjedis” është çdo ndryshim i mjedisit fizik, përfshirë pasojat shëndetësore, ekonomike, shoqërore, estetike, natyrore dhe fizike.

- “Ndikimi ndërkufitar në mjedis” është çdo ndikim në një zonë, që ndodhet në juridiksionin e një vendi, ku veprimtaria zhvillohet plotësisht ose pjesërisht në një zonë në juridiksionin e një

vendi tjetër, ku nuk përfshihen dukuritë e ndikimit në mjedisin global (ndryshimet klimatike, ujërat ndërkombëtare, biodiversiteti, toka).

- “Vlerësimi i ndikimit në mjedis” është procesi që kryhet për të identifikuar, parashikuar, interpretuar, matur, komunikuar e parandaluar ndikimin e një projekti në mjedis, sipas disa varianteve të tij, me qëllim që të përzgjidhet varianti më i mirë për parandalimin dhe zbutjen e ndikimit negativ, para se projekti të miratohet dhe të zbatohet.

- “Vlerësimi strategjik mjedisor” është procesi i vlerësimit të ndikimeve të mundshme në mjedis të një politike, plani dhe programi.

- “Deklarata mjedisore” është dokumenti zyrtar i lëshuar nga Ministri i Mjedisit, pas shqyrtimit të kërkesës për miratimin e një projekti, plani ose programi të përcaktuar në shkronjën “a” të pikës 14 të këtij neni, që miraton ose jo kërkesën, duke e shoqëruar me kushte detyrues të zbatueshme për propozuesin dhe organet shtetërore përgjegjëse.

- “Leja mjedisore” është dokumenti zyrtar i lëshuar nga Ministria e Mjedisit, pas shqyrtimit dhe këshillimit me të gjitha palët e interesuara të kërkesës dhe dokumentacionit të saj shoqëruar, që miraton ushtrimin e çdo veprimtarie, që ka ndikim në mjedis, ku përcaktohen kushtet dhe rrethanat detyrues të zbatueshme, për të mos dëmtuar e ndotur mjedisin mbi normat e lejuara.

- “Normat e cilësisë së mjedisit” janë një grup kërkesash, që duhen plotësuar për një kohë të dhënë dhe në një pjesë të dhënë të mjedisit, për përmbajtjen e lëndëve ndotëse, në disa pika të veçanta të ajrit, ujërave dhe tokës, vlera e të cilave nuk duhet të kalojë vlerën kufi të lejuar.

- “Ndotja mbi normë e mjedisit” është tejkalimi i normave të cilësisë së mjedisit.

- “Norma e shkarkimeve në mjedis” është vlera më e madhe e lejuar e përmbajtjes së lëndëve ndotëse në shkarkimet për një periudhë kohe të dhënë. Normat e shkarkimeve zbatohen në pikat ku shkarkimet dalin nga instalimi pa u holluar.

- “Burime natyrore” janë elementet biotike dhe jobiotike, që përdoren ose që mund të përdoren nga njeriu për plotësimin e nevojave të tij.

- “Burime të përsëritshme” janë burimet natyrore, që përtërihen në mënyrë natyrore, ose që mund të përtërihen plotësisht ose pjesërisht me rrugë të tjera. Të gjitha burimet e tjera janë të papërsëritshme.

- “Dëmtimi historik i mjedisit” është ndotja me lëndë të rrezikshme dhe mbetje e zonave industriale dhe e rrethinave të tyre, e shkaktuar nga veprimtaritë e ndërmarrjeve, të cilat sot mund të jenë në gjendje pune, ose të mbyllura, të braktisura, të privatizuara ose të dhëna me koncesion dhe që vazhdojnë të kërcënojnë shëndetin dhe mjedisin.

- “Zhvillimi i qëndrueshëm” është zhvillimi që plotëson nevojat e së tashmes dhe të së ardhmes, pa shtrënguar ose prekur mundësitë dhe kapacitetet që edhe brezat e ardhshëm të plotësojnë nevojat e tyre.

- “Përdorimi i qëndrueshëm” i burimeve natyrore e minerare siguron plotësimin e nevojave të sotme, pa cenuar nevojat e brezave të ardhshëm për këto burime.

- “Teknikat më të mira të mundshme” përfaqësojnë fazën më të përparuar dhe me nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, të zhvillimit të një veprimtarie dhe që janë plotësisht të zbatueshme nga pikëpamja praktike dhe ekonomike.

- “Parimi i kujdesit” është marrja e vendimeve dhe e veprimeve të nevojshme për të pakësuar rrezikun mjedisor, për të parandaluar dhe pakësuar në kohën e duhur çdo dëmtim të ardhshëm të mjedisit.

- “Parimi i parandalimit” është përzgjedhja dhe miratimi i variantit më të mirë, që në fazën fillestare të vendim-marrjes, për të shmangur ndikimet e dëmshme të një veprimtarie në mjedis.

- “Parimi i riaftësimit” është domosdoshmëria për të riparuar dëmet mjedisore të shkaktuara nga vetë personat fizikë e juridikë dhe për të përtëritur dhe riaftësuar mjedisin e dëmtuar.
  - Parimi “Ndotësi paguan” nënkupton koston që paguan ndotësi për përmirësimin e një mjedisi të ndotur dhe për kthimin e tij në një gjendje të pranueshme. Kjo pasqyrohet në koston e prodhimit, të konsumit të mallrave dhe të shërbimeve që shkaktojnë ndotjen.
  - “Vlerësimi mjedisor” është rivlerësimi periodik i administrimit të mjedisit dhe mbrojtjes së tij, që bëjnë personat fizikë e juridikë për instalime ose veprimtari të pajisura me leje mjedisore.
  - “Sistemi i administrimit mjedisor” përmbledh kuadrin institucional, politikat, planet e veprimit dhe masat tekniko-administrative për mbrojtjen e mjedisit, i çertifikuar nga organizmat ndërkombëtarë ISO dhe EMAS.
-